



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.41 datë 04.06.2018

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”.

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 04.06.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi aktin rregullator me ndryshimet, shtesat dhe përmirësimet si vijon:

Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar,

KD mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr. 260 datë 14.12.2017, i përbërë si më poshtë:

- Relacioni mbi komentet e sipërmarrësve dhe qëndrimi i AKEP për disa ndryshime në Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;
- Projekt Vendimi për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të Rregullores nr. 2;

- Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”,

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8 (*shkronjat k, p dhe s*), neni 110, 114 e 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar;
3. Neni 8 i Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Relacioni mbi komentet e sipërmarrësve dhe qëndrimi i AKEP për disa ndryshime në Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar;
2. Projekt Vendimi për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 2;
3. Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me VKD Nr.2 datë 12.01.2018 miratoi për këshillim publik dokumentin mbi “Për disa ndryshime në Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar.
2. Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të internetit të AKEP dhe periudha e këshillimit publik ishte deri në datën 28.02.2018. Në përfundim të afatit të këshillimit publik, në adresë të AKEP kanë dërguar komente disa palë të interesuara.
3. Në zbatim të pikës 3 të nenit 110 të Ligjit Nr. 9918 date 19.05.2018 i ndryshuar, me kërkesë të disa Regjistruarëve të domaineve .al dhe nëndomaineve si palë të interesuara, në datën 11.04.2018 AKEP realizoi edhe një seancë dëgjimore, për të parashtruar mendimin për dokumentet rregullatore të propozuara.
4. Komentet e sipërmarrësve gjatë periudhës së konsultimit publik dhe gjatë seances

- dëgjimore, janë përqëndruar kryesisht në propozimet që ka bërë AKEP për ndryshimet në Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 të ndryshuar. Grupi i Punës pasi ka shqyrtuar komentet e palëve të interesuara, ka përgatitur dokumentacionin final për miratim në Këshillin Drejtues të AKEP, të ndryshimeve në Rregulloren nr.2, përfshirë dokumentat:
- a. “Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për disa ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”.
 - b. “Disa ndryshime të Rregullores nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar.
5. Dokumenti “Disa ndryshime të Rregullores nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”, i përgatitur nga Grupi i Punës, pas këshillimit publik dhe shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara, është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me funksionet e AKEP.
 6. AKEP, në zbatim të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, si dhe duke marrë në konsideratë shqetësimet dhe ankesat e paraqitura në AKEP, nga kërkues dhe përdorues të ndryshëm në lidhje me domainet .al dhe nëndomaineve, çmon si të rëndësishme disa ndryshime në Rregullore nr. 2, datë 21.02.2008, e ndryshuar, sipas çështjeve të trajtuara në konsultimin publik.
 7. AKEP gjatë procesit të hartimit të këtyre akteve, përveç të tjerash, ka mbajtur në konsideratë edhe rregulla të ICANN (Internet Corporation for Assigned Names and Numbers) dhe WIPO (World Intellectual Property Organisation), duke u përpjekur të përmbushë mirëfunksionimin e procedurave për veprimet me domainet .al dhe nëndomainet.
 8. Me ndryshimet në Rregulloren nr. 2 datë 19.05.2008 të ndryshuar, AKEP përmirëson kushtet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje në lidhje me afatet e veprimeve me domainet, afatet e përdorimit të domaineve .al dhe nëndomaineve, shmangien e praktikave abuzuese e lidhur kjo edhe me numrin e domaineve, të drejta dhe detyrime të Regjistruarëve të domaineve .al dhe nëndomaineve, rritjen e transparencës për publikun të rregullave të AKEP për domainet .al dhe nëndomainet, përmirësimin dhe sistemimin e informacionit për domainet .al në faqet web të Regjistruarëve dhe në faqen web të AKEP, miratimin e listës së domaineve të rezervura dhe domaineve të ndaluara, etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi me qëllim që ndryshimet në këtë akt rregullator të kontribuojnë në rritjen e transparencës ndaj publikut të rregullave të AKEP për domainet .al dhe nëndomainet, regjistrimin e domaineve .al dhe nëndomaineve në afate të shkurtra dhe të përcaktuara qartë, vendosjen e disa kushteve të nevojshme në Rregulloren Nr. 2 për mbarëvajtjen e procesit të veprimeve me domainet .al dhe nëndomainet, njohjen dhe implementimin në Rregulloren Nr. 2 të drejtës së poseduesit të domain .al dhe nëndomaineve për transferimin e domainit nga një

Regjistrues tek një tjetër Regjistrues, miratimin e listës së domaineve të rezervura dhe domaineve të ndaluara, e të tjera, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuara në shkronjat k, p dhe s të nenit 8, nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentet:
 - a. “Disa shtesa dhe ndryshime të Rregullores nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar;
 - b. Listë e emrave të rezervuar;
 - c. Listë e emrave të ndaluar.
 - d. “Qëndrimi i AKEP dhe komentet e palëve të interesuara mbi disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;
2. Ky Vendim dhe dokumentet e miratuara në pikën 1 më sipër të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP www.akep.al.
3. Efektet e zbatimit të këtij vendimi, akteve rregullatore të miratura me këtë vendim, fillojnë nga **data 1 shtator 2018**.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETARI

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Edlira Dvodrani**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

QËNDRIMET E AKEP MBI ÇËSHTJET E KËSHILLIMIT PUBLIK

“Për disa ndryshime në Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nën domain-et .gov, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, të ndryshuar”.

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin e Nr. 25 datë 15.12.2017 “Për marrjen e disa masave mbi shqetësimet lidhur me emrat nën domainet .al”, ka vendosur:

1. Rishikimin e Rregullores Nr. 02, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nën domain-et .gov, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, të ndryshuar.
2. Parashikimi në Rregulloren nr. 02/2008 të një periudhe tjetër kalimtare (Sunrise period) për t’iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domaini nën .al, emra me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer , në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Pezullimin e të gjitha veprimeve të parashikuara për tu kryer nga AKEP dhe regjistruesve, për regjistrimin e emrave të domain nën .al që janë emra të njohur që ushtrojnë veprimtari sipas regjistrimit të kryer në QKB, zyra, institucione apo autoritete që janë kompetente të kryejnë regjistrime emrash, markash, patentash e çdo të drejte tjetër të pronësisë industriale apo më tej.
4. Inspektimin e veprimtarisë së regjistruesve për të kontrolluar zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Rregulloren nr. 02/2008 dhe akteve në fuqi.
5. Vendimi të publikohet në faqen elektronike të AKEP www.akep.al.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet grupi i punës sipas Urdhër Nr. 260, datë 14.12.2017 dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit Broadband.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë:

- shqetësimet dhe ankesat e paraqitura në AKEP, nga kërkues dhe përdorues të ndryshëm në lidhje me domainet .al dhe nëndomaineve;
- rregulla të ICANN (Internet Corporation for Assigned Names and Numbers) dhe WIPO (World Intellectual Property Organisation);
- kushtet dhe përcaktimet e Rregullores Nr.2 të ndryshuar, në lidhje me afatet e veprimeve me domainet, afatet e përdorimit të domaineve .al dhe nëndomaineve, afatet e Akreditimit të Regjistruesve, të drejta dhe detyrime të përdoruesve të domaineve .al dhe nëndomaineve, rritjen e transparencës nga Regjistruesit të rregullave të AKEP domainet .al dhe nëndomainet, përmirësimin dhe sistemimin e informacionit për domainet .al në faqen web të AKEP, si dhe shqyrtimin e mundësisë për trajtimin fillimisht në AKEP të mosmarrveshjeve për domainet .al dhe nëndomainet, etj.

- Materialin e Grupit të Punës të ngjitur sipas Urdhërit Nr. 260 datë 14.12.2017.

AKEP shtroi për konsultim publik tematikat e mëposhtme:

1. Informacioni i publikuar në faqen web të AKEP në lidhje me domainet .al dhe nëndomainet.
2. Veprime që kryhen nga AKEP dhe Regjistruesit për regjistrimin e domaineve .al dhe nëndomaineve nën .al dhe veprimet e tjera në lidhje me domainet .al dhe nëndomainet.
3. Faqet web të regjistruesve në lidhje me informacionin e publikuar dhe mënyrën e kërkimit për domain .al dhe nëndomainet.
4. Regjistrimi i Regjistruesve të Akredituar nga AKEP, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).
5. Përditësimi i listës së emrave të ndaluar dhe listës së emrave të rezervuar duke rritur bashkëpunimin me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave, Organet e pushtetit vendor, Institucionet e sistemit gjyqësor, institucione të tjera të përcaktuara me ligj ose akte nënligjore, si dhe çdo institucion ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë aderon.
6. Parashikimi në Rregulloren nr. 02/2008 të një periudhe tjetër kalimtare (Sunrise period) për t'iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domaini nën .al, emra me të cilët njihen për shkak të veprimitarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Shqyrtimi i mundësisë për trajtimin nga AKEP të mosmarrveshjeve që lindin në lidhje me regjistrimin, modifikimin, kalimin e pronësisë dhe çregjistrimin/mbylljen e domaineve nën .al.
8. Shqyrtimi i afateve për regjistrimin e domaineve nën .al, nga AKEP dhe nga Regjistruesit, shqyrtimi i afatit të përdorimit të domaineve si dhe afatit të vendosjes në punë/përdorim të një domaini .al dhe nëndomaineve.
9. Shqyrtimi i afatit të Akreditimeve nga AKEP dhe përfundimit të Akreditimeve të Regjistruesve.
10. Shqyrtimi i pagesave që kryhen për regjistrimin e domaineve nën .al.

Deri në përfundim të konsultimit publik, kanë paraqitur në AKEP komente, qëndrime dhe propozime:

- Regjistruesi Albtelecom sh.a
- Regjistruesi Keminet shpk
- Regjistruesi Webhost shpk
- Regjistruesi Shqiperiacom shpk
- Regjistruesi Fatos Dega-person fizik (i njohur si Studio Driar)
- Regjistruesi Ergentian Sota-person fizik (i njohur si Eder Host)
- Shoqëria Telekom Albania sh.a

Në zbatim të pikës 3 të nenit 110 të Ligjit Nr. 9918 date 19.05.2018 i ndryshuar, me kerkese te disa Regjistruesve te domaineve .al dhe nendomaineve si palë të interesuara, në datën 11.04.2018 AKEP realizoi një seancë dëgjimore, për të parashtruar mendimin për dokumentet rregullatore të propozuaranë të cilin morën pjesë përfaqësues të Albtelecom, Keminet, Webhost dhe Z. Fatos Dega.

Qëndrimet dhe komentet e tyre ishin pak a shumë të njëjta me qëndrimet e shprehura me shkrim por pati dakortësi me AKEP për disa nga çështjet e shtruara në konsultimin publik.

Çështjet e trajtuara në konsultimin publik dhe komentet/qendrimet/propozimet e paraqitura:

Çështja e parë: Informacioni i publikuar në faqen web të AKEP në lidhje me domainet .al.

Në faqen e AKEP www.akep.al gjendet infomacioni sa më poshtë:

- a. Rregullorja Nr. 2 datë 21.02.2008 për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al, e ndryshuar.
- b. Së bashku me Rregulloren Nr. 2 të ndryshuar, gjenden 3 dokumente të WIPO në gjuhën Angleze, të titulluara:
 - WIPO Supplemental Rules for Domain Name Dispute Resolution Policy for Albania.
 - Domain name dispute resolution policy for Albania.
 - Rules for domain name dispute resolution policy for Albania.
- c. Listë e emrave të ndaluar dhe Listë e emrave të rezervuar të cilat gjenden në Rregulloren Nr. 2 të ndryshuar, në Aneksin Nr. 2 të saj.
- d. Regjistri i Regjistruesve, faqet web të tyre dhe kontakte të tyre.
- e. Formularët për Regjistrim, modifikim teknik, rinovim të dhënash, rinovimi kontakt pagese, transferim dhe mbyllje domaini.
- f. Mundësia e kërkimit për domain name dhe një informacion i shkurtër për karakteret dhe sintaksën.

AKEP kërkoi mendimin e të interesuarve, për:

- **Mundësia e kërkimit për domain nën .al, të jetë përherë e disponueshme dhe funksionale, në faqen web të AKEP, të jetë në gjuhën Shqipe si dhe të përmbajë linkun e Rregullores së AKEP për domainet .al, të përmbajë listën e emrave të ndaluar dhe rezervuar.**

Qendrim nr. 1:

Kompania jonë mirëkupton dhe mirëpret sugjerimet e AKEP të cilat synojnë nga njëra anë nxitjen e përdorimit të këtij shërbimi dhe rritjen e fleksibilitetit dhe sigurisë së ofritit të këtij shërbimi nga Regjistruesit e konfirmuar nga AKEP. Kërkimi i Domain-eve në vetvete kryhet në AKEP. AKEP është owner i këtij procesi dhe regjistruesit janë praktikisht vetëm nderfaqja që lidh të interesuarit me platformën e AKEP. Prandaj, kjo kompani nuk ka kundërshtim që mundësia e kërkimit për domain nën .al të jetë e disponueshme dhe funksionale në faqen e AKEP ashtu si çdo Regjistrar tjetër. Gjithsesi, kjo kompani mendon se AKEP nuk duhet të ushtrojë edhe veprimtarinë e databazës qendrore të domaineve (Central Database) edhe të Regjistrarit, pasi ka konflikt interesi në ushtrimin e këtyre dy funksioneve.

Qëndrimet e tjera:

Janë të dobishme dhe i shërbejnë pozitivisht ndryshimeve për përmirësimin e procesit të regjistrimit të domain-eve .al, shtimi i informacionve të publikuara në faqen web te AKEP në lidhje me domainet .al dhe nëndomainet;

Qëndrimi i AKEP:

AKEP mirëpret dakortësinë e Regjistruësve të domaineve në .al, për këtë çështje. Lidhur me rolin e AKEP-it edhe si administrues i databazës qendrore dhe si Regjistruës, AKEP sqaron që administrimi i domainit .al është detyrim ligjor për AKEP siç përcaktohet në pikën k) të nenit 8, të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”. AKEP si administrator domainit .al ka dy role, atë të administrimit të databazës së ccTLD .al, dhe si regjistruës domainesh nën .al. Ndërkohë që administrimi i databazës ccTLD .al është një proces tërësisht teknik, regjistrimi i domaineve .al është procedural. Për sa kohë ekziston detyrimi ligjor për AKEP, roli i AKEP do të vazhdojë të jetë edhe administrimi teknik i databazës së ccTLD .al edhe keryrja e procesit të regjistrimit të domaineve .al.

Sa më sipër, në nenin 18 të Rregullores Nr.2, shtohet pika 18.3 me këtë përmbajtje:

18.3 Mundësia e kërkimit në kohë reale për domain nën .al, të jetë përherë e disponueshme dhe funksionale, në faqen web të AKEP dhe Regjistruësve, të jetë të paktën në gjuhën Shqipe si dhe ai seksion të përmbajë linkun e Rregullores së AKEP për domainet .al, të përmbajë listën e emrave të ndaluar dhe rezervuar dhe cdo informacion të kërkuar nga kjo rregullore.

- **Të vendoset linku i faqes web së zyrës së regjistrimit të markave dhe patentave, meqënëse aty ekziston një database online e markave dhe patentave të regjistruara.**

Qëndrim nr. 1:

Ky duhet të jetë një proces automatik i cili të ndalon të marrësh një domain nëse korrespondon me një emër të listes. Regjistruës 1 mendon se vendosja e linkut të faqes ëeb të zyrës së regjistrimit të markave dhe patentave do të sillte një vlerë të shtuar në procesin e regjistrimit të një domaini të ri. Por, në mënyrë që kjo të shërbejë vërtet si një vlerë e shtuar dhe jo si një pengesë në procesin e regjistrimit, është e domosdoshme që AKEP të ketë një lidhje logjike me këtë bazë të dhënash ku kërkimi për një domain të ri të kryhet në mënyrë automatike gjatë procesit të aplikimit dhe regjistrimit, i cili të ndalon të marrësh një domain nëse korrespondon me një emër të listës. Kjo për shkak se vetë faqja zyrtare e zyrës së regjistrimit të markave dhe patentave cilëson në faqen e saj se të dhënat e marra nga faqja nuk mund të përdoren për qëllime zyrtare. Për më tepër, nuk ka asnjë garanci që kërkimi nga faqja e zyrës së regjistrimit të markave dhe patentave jep rezultate të sakta. Kjo lloj pasigurie dhe jo zyrtarizimi në funksionalitetin e faqes së zyrës së regjistrimit të markave dhe patentave do të demtonin rëndë procesin e regjistrimit të domain nën .al dhe më kryesorja do të shndërrohej në burim konfliktesh e mosmarreveshjesh mes përdoruesit, poseduesit të markes apo patentës së regjistruar dhe Regjistrarit në vetvete. Prandaj, që ky proces të përmirësohet ashtu siç kërkohet të përcaktohet me këtë rregullore duhet patjetër që ky proces të jetë automatik.

Gjithashtu edhe në takimin e datës 11 prill 2018 mes AKEP dhe disa perfaqësuesve të Regjistruësve të domaineve .al, u shpreh qëndrimi që kontrolli i emrave të markave dhe patentave të regjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale (DPPI), të jetë automatik për të mos pasur problem me emërtimin e saktë të markës/patentës gjatë verifikimit për një domain që kërkon të regjistrohet.

Qëndrimi i AKEP:

Në faqen web www.dppm.gov.al gjendet i publikuar regjistri i markave dhe patentave. Megjithatë në faqen web të DPPI thuhet se informacioni i regjistrave online është vetëm

orientues, vërehet se ky regjister është aktiv dhe jep informacion për marka dhe patenta të regjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale (DPPI) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. AKEP gjykon se vendosja e linkut të faqes web të DPPI do ti ndihmonte regjistruarit të orientohen përpara regjistrimit të një domain nëse është ose jo një markë/patentë/dizenjo industriale e regjistruar, ndërkohë AKEP do të kërkojë bashkëpunimin me DPPI për mundësinë e aksesit në databazat e markave dhe patentave për të realizuar një proces kërkimi automatik. Deri në sigurimin e një procesi të tillë automatik, AKEP mendon se kërkimi në faqen web të DPPI të një emri marke/patente/dizenjo industriale, duhet të kryhet nga vetë kërkuesi i domain .al dhe të sigurojë që ka bërë kërkimin, duke nënshkruar/pranuar formularin e regjistrimit/rinovimit/modifikimit/transferimit të domain .al në të cilën do të vendoset shënimi përkatës nga AKEP.

Sa më sipër, në pikën 3 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruarit” të Aneksit 1 të Rregullores Nr.2, të ndryshuar shtohet pika n) si më poshtë:

n) Regjistruarit do të mbajnë të publikuar në faqen e tyre web, linkun e faqes web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që mundëson kërkimin për marka/patenta/dizenjo industriale të regjistruara dhe poshtë këtij linku të vendosin njoftimin: *“Përpara kërkimit dhe regjistrimit të një domain “.al” duhet të bëni kërkim në faqen web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) në mënyrë që emri i domainit që kërkoni, të mos jetë markë/patentë/dizenjo industriale e regjistruar nga kjo drejtori. Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkojnë saktësisht me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar.*

Meqënëse edhe AKEP është regjistruar i domaineve .al, në pikën 19.3 të nenit 19, të Rregullores Nr.2 të ndryshuar, shtohet pika f):

f) AKEP në faqen e tij web, seksioni i domain .al, do të mbajë të publikuar linkun e faqes web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që mundëson kërkimin për marka/patenta/dizenjo industriale të regjistruara. Poshtë këtij linku AKEP vendos shënimin *“Përpara kërkimit dhe regjistrimit të një domain “.al” duhet të bëni kërkim në faqen web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) në mënyrë që emri i domainit që kërkoni, të mos jetë markë/patentë/dizenjo industriale e regjistruar nga kjo drejtori. Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkojnë saktësisht me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar.*

- Në seksionin Anglisht të faqes web të AKEP gjuha e përdorur të jetë në Anglisht si dhe Rregullorja e AKEP për domainet nën .al, së bashku me listat e emrave të ndaluar dhe rezervuar, të përkthehen në gjuhën Angleze.

Propozimet për riformuluar pikën 19.3 të nenit 19, të Rregullores Nr.2, si më poshtë:

Pika 19.3:

Ishte:

Autoriteti Përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Rregullore, përgatit dhe publikon në faqen e Internetit www.akep.al, *listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar*”.

Të bëhet:

Autoriteti Përgjegjës (AKEP), në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Rregullore, përgatit dhe publikon në faqen e Internetit www.akep.al:

- a. Rregulloren për regjistrimin dhe administrimin e domaineve .al dhe çdo modifikim, ndryshim apo përditësim të saj, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP. Kjo Rregullore do të shoqërohet me dokumentacionin e WIPO (World Intellectual Property Organisation) të përkthyer në gjuhën Shqipe, si dhe linkun e faqes ëeb te EİPO.
- b. Regjistrin e Regjistruësve të domaineve .al dhe nëndomaineve dhe të dhënat e tyre të kontaktit, sic përcaktohen në Rregullore.
- c. Formularët përkatës të veprimeve me domainet .al dhe nëndomainet, sipas përcaktimeve në Rregullore.
- d. Mundësinë për kërkim domaine .al dhe nëndomainet, në një seksion të veçante dhe të dukshëm që në faqen e parë te www.akep.al i cili do të jetë përherë i disponueshëm dhe funksional.
- e. Ky seksion do të përmbajë gjithashtu:
 - e1. një link që hap Rregulloren e AKEP për regjistrimin dhe administrimin e domaineve .al,
 - e2. *listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar*.
 - e3. linkun e faqes web zyrtare DPPI, seksioni i databazës online të markave dhe patentave të regjistruara.
 - e4. informacion i shkurtër për karakteret dhe sintaksën.
 - e5. një shënim për këshillim me dokumentacionin e WIPO (World Intellectual Property Organisation) të ofruar nga AKEP së bashku me Rregulloren e administrimit të emrave të domaineve .al, si dhe me faqen web www.wipo.int.
- f. AKEP në faqen e tij web, seksioni i domain .al, do të mbajë të publikuar linkun e faqes web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që mundëson kërkimin për marka/pateta/dizenjo industriale të regjistruara. Poshtë këtij linku AKEP vendos shënimin *“Përpara kërkimit dhe regjistrimit të një domain “.al” duhet të bëni kërkim në faqen web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) në mënyrë që emri i domainit që kërkoni, të mos jetë markë/patente/dizenjo industriale e regjistruar nga kjo drejtori. Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkrijnë saktësisht me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar*.
- g. Në versionin Anglisht të faqes web të AKEP www.akep.al, seksioni i domain .al, detyrimet e pikave a, b, c, d, e, f, publikohen edhe në gjuhën Angleze.

Qëndrim nr. 1:

Regjistruës 1 nuk ka kundërshtime në lidhje me sugjerimin e AKEP për ofrimin e mundësinë e kërkimit të një domaini në faqen e tyre.

Qëndrim nr. 2:

Kompania jonë është dakort me riformulimin e propozuar nga AKEP për pikën 19.3 të nenit 19 të Rregullores nr.2, në të cilën parashikohet informacioni që do të publikohet në faqen e AKEP sipas pikave (a) - {f} të propozuara, dhe në veçanti pika (e3) lidhur me linkun e faqes ëeb të zyrës së regjistrimit të markave dhe patentave, seksioni i databazës online të markave dhe patentave të regjistruara.

Qëndrime nr. 2, 3, 4 dhe 5:

Mbështesin propozimin e AKEP për të pasuruar faqen e tij me informacione dhe shërbime shtesë për domain-et .al dhe informimi i shërben procesit të ndërgjegjësimit të shtetasve shqiptarë dhe kompanive dhe organizatave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në shqipëri për përdorimin e domainit .al. Inkurajojnë AKEP që në këtë proces të përfshinte sa më shumë aktorë privatë dhe shtetërore. Kështu përveç për pasurimin e faqes së tij do të propozonim që AKEP:

1. Të nxiste Qendren Kombëtare të Biznesit që në sportelet e saj të vinte në dispozicion të bizneseve "Flyers" me informacione mbi domainin .al dhe përfitimet e përdorimit të tij.
2. Të njejtin "Flyer" AKEP mund të vinte në dispozicion të bizneseve edhe në zyrat e shërbimit të tatimpaguesve apo zyrën e regjistrimit të markave dhe patentave.
3. Në kuadër të rritjes së përdorimit të domain-it .al, AKEP në bashkëpunim me agjencitë përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendin Shqipërisë mund të nxisin të gjithat institucionet dhe ndërmarrjet publike për pajisjen me domain-e .al.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP mirëpret dakortësinë dhe propozimet e regjistruesve të sipërcituar dhe do tu kërkojë institucioneve përkatëse bashkëpunim për referim regjistrimi domaini .al në momentin e kontaktit të pare të të interesuarve me këto institucione.

Sa më sipër, në pikën 19.3 të nenit 19, të Rregullores Nr.2 të ndryshuar, shtohet pika sipas përmbajtjes së pikës f) më sipër.

Çështja e dytë: Shqyrtimi i veprimeve që kryhen nga AKEP dhe Regjistruesit në lidhje me domainet .al dhe nëndomainet nën .al.

- a. Në nenin 8, pika k) të Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet që:

AKEP administron domain cc.TLD.al, nëndomanet e tij , si edhe ENUM;

- b. Në pikën 1.1, të Nenit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, përcaktohet që:

AKEP sipas Ligjit nr.9918 datë 19.05.2009 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", **do të bëjë regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën ".al"** dhe nën domain-et ".gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al", si dhe mbikqyrjen e zbatimit të Rregullores nga subjektet e autorizuar prej tij për të bërë regjistrime të këtyre domaineve dhe nën domaineve.

- c. Në pikën 1.20, të Nenit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, përcaktohet që:

“Regjistrues” janë subjektet e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës (AKEP) për të bërë regjistrimin e domaineve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Aneks nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt. 21.02.2008;

d. Në nenin 21 “Regjistrimi i emrit të domainit” të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, pika 21.1, përcaktohet:

Regjistrimi i emrit të domain-it kryhet nëpërmjet Regjistruesve;

e. Në nenin 22 “Kriteret e regjistrimit” të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, përcaktohet:

22.1 Regjistrimi i emrit të domain-it sipas kësaj Rregulloreje do të bëhet në bazë të parimit “kush aplikon i pari shërbehet i pari” (first come – first served), me të cilin nënkuptohet selektimi/ përzgjedhja nga ana e Autoritetit Përgjegjës (AKEP) sipas kohës së depozitimit të aplikimit të vlefshëm.

22.2 Aktivizimi i emrave të domain-eve, kryhet pasi është bërë shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me Rregulloren.

f. Në aneksin 1, pika 2 të Rregullores Nr. 2 përcaktohen disa kushte që Regjistruesi duhet të plotësojë për të marrë të drejtën e regjistrimit të domain-eve në zonën .al nga Autoriteti Përgjegjës.

Ndërsa duke filluar nga pika 3 e Aneksit 1 dhe në vijim: “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit”, përmendet shpesh termi “Akreditim” por që në fakt nënkupton të drejtën që i jepet Regjistruesit për veprime me domainet .al (regjistrim, modifikim teknik, transferim, mbyllje, etj), nëpërmjet një procesi tërësisht teknik.

Duke vlerësuar se veprimet me domainet nën .al, janë tërësisht teknike dhe kryhen vetëm nëpërmjet sistemit të AKEP (ccTLD), dhe përderisa pika 2 e Aneksit 1, përcakton saktë që Regjistruesit kanë të drejtë të regjistrojnë domaine në zonën .al, AKEP gjykon se termi “Akreditim” duhet të përshtatet në Rregullore në kontekstin e të drejtës së regjistrimit dhe veprimeve të tjera me domainet nën .al.

Gjithashtu, në pikën 4 e) të Aneksit 1 përcaktohet: “Bazuar në aplikimin sipas formularit të aplikimit, AKEP do të lëshojë një certifikatë regjistrimi për sipërmarrësin, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të aplikimit të plotë”.

Vërehet që bazuar në këtë pikë, AKEP nuk lëshon dokument me termin “Akreditim”.

Duke shqyrtuar sa më sipër:

AKEP propozoi sa më poshtë:

1. Pika 1.20, e nenit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, të ndryshohet:

“Regjistrues” janë AKEP dhe subjektet e Regjistruara në Autoritetin Përgjegjës (AKEP) për të bërë regjistrimin e domaineve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Aneks nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt. 21.02.2008, e ndryshuar.

Qëndrim nr. 1:

Kompania jonë është dakort me këtë pikë.

Nuk u paraqitën komente specifike nga regjitruesit e tjerë për këtë pikë. I vetmi qëndrim që përkon me këtë pikë janë komentet e sipërcituara që AKEP të mos regjistrojë domaine .al.

Qëndrimi i AKEP:

Megenëse AKEP është i ngarkuar nga Ligji 9918 i ndryshuar, që të administrojë domainin .al, AKEP do të vazhdojë të regjistrojë domaine .al.

Sa me sipër, pika 1.20, e nenit 1 të Rregullores Nr. 2, të ndryshohet:

“Regjistrues” janë AKEP dhe subjektet e Regjistruara në Autoritetin Përgjegjës (AKEP) për të bërë regjistrimin e domaineve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Aneks nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2 dt. 21.02.2008, e ndryshuar.

2. Pika 21.1, e nenit 21 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar,

Ishte:

Regjistrimi i emrit të domain-it kryhet nëpërmjet Regjistruesve;

të bëhet:

Regjistrimi i emrit të domain-it kryhet nëpërmjet AKEP dhe Regjistruesve;

Qëndrim nr. 1:

Kompania jonë mendon se Regjistrimi i emrit të domain-it iniciohet nga Regjistruesit dhe aktivizohet/finalizohet nga AKEP. Teknikisht të gjithë domainet aktive ruhen në një databazë qëndrore, e administruar dhe manaxhuar nga AKEP. Ndonëse kërkesa e klientit për regjistrim domaini vjen tek ne (hardcopy apo përmes portalit), është AKEP ai që bën aprovimin apo refuzimin e regjistrimit, duke dhënë arsytimin përkatës në rastin e dytë. Në këtë aspekt finalizimi i procesit bëhet nga AKEP.

Qëndrim nr. 2:

Lidhur me ndryshimet e propozuara të Nenit 1, pika 1.1: Neni 21, pika 21.1: Neni 22, pika 22.2, Pika 4 e Aneksit 1; Neni 1, pika 1.20, kompania jonë nuk ka ndonjë objeksion për të bërë, duke qënë se AKEP, ashtu si dhe regjitruesit e tjerë të autorizuar prej tij, është i ligjeruar për të kryer gjitha veprimet me domainet .al dhe nën domainet nën .al. Ndaj dhe ndryshimet e pikave të këtyre neneve dhe riformulimit të pikës 4 të Aneksit 1 i gjykon si të përshtatshme.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP mirëpret dakortësinë e dy qëndrimeve të mësipërme dhe sqaron se që nga fillimi i regjistrimit të domaineve dhe nëndomaineve .al, AKEP ka regjistruar domaine .al dhe do të vazhdojë të regjistrojë domaine .al, prandaj ndryshimi konsiston në sqarimin në Rregullore që edhe AKEP regjistron domaine .al.

Sa më sipër, pika 21.1, e nenit 21 të Rregullores Nr. 2, ndryshohet si më poshtë:

21.1 Regjistrimi i emrit të domain-it kryhet nëpërmjet AKEP dhe Regjistruesve;

3. Pika 22.2, e nenit 22 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar,

Ishte:

Aktivizimi i emrave të domain-eve, kryhet pasi është bërë shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me Rregulloren.

të bëhet:

Aktivizimi i emrave të domain-eve, kryhet nga AKEP pasi është bërë shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me Rregulloren.

Qëndrim nr. 1:

Procesi i aktivizimit të domain-eve realizohet nga AKEP. Në këtë kuadër, kompania jonë nuk ka asnjë kundërshtim. Por, ky përcaktim thekson edhe njëherë se përgjegjësia dhe mundësia për verifikimin automatik paraprak dhe kontrollin e emrave dhe markave të regjistruara, apo për përdorimin e emrave të ndaluar duhet të garantohet nga AKEP . Në finale, është AKEP që garanton respektimin e Rregullores për regjistrimin e çdo domaini në vetvete.

Qëndrimi i AKEP:

Përgjigja është e njëjtë me përgjigjen e dhënë nga AKEP në pikën 1, faqe 4 të këtij dokumenti.

Pika 22.2, e nenit 22 të Rregullores Nr. 2 ndryshohet si më poshtë:

22.2 Aktivizimi i emrave të domain-eve, kryhet nga AKEP pasi është bërë shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me Rregulloren.

4. Termi “Akreditim” duhet të përshtatet në Rregulloren Nr. 2 në kontekstin e të drejtës së dhënë dhe të njohur nga AKEP për Regjistruesit për regjistrim të domaineve nën .al edhe nga Regjistruesit. Termi më i përshtatshëm që përputhet me përcaktimet e tjera në Rregullore është “regjistrim” ku në referencë me pikën 4 e) të Aneksit 1, procesi që kryen AKEP është regjistrim.

Qëndrim nr. 1:

Kompania jonë sugjeron që të riformulohet përshtatja si "proces regjistrimi" dhe jo "regjistrim"

Qëndrim nr. 2:

Termi "i akredituar" i jepet një organizmi të autorizuar dhe vlerëson kompetencën dhe aftësinë për të kryer detyra specifike.

Në administrimin e ccTLDve të ndryshme, termi është de-fakto për të gjithë entet e autorizuara për të kryer rregjistrime të domaineve nën ato zona dhe nënkupton kredenciale zyrtare për rregjistrimin e domaineve nën një zonë të caktuar. Në praktike termi “i akredituar” mbron (bën dallimin) rregjistrarët që kanë kredenciale pranë AKEP nga “rishites-it” të shumtë që ofrojnë dhe ata rregjistrim të domaineve .al. Tërheqja e termit “i akredituar” për rregjistrarët aktual do të pasqyrohet dhe në një dëm ekonomik indirekt. Theksojme se termi i “regjistrar i akredituar” është futur nga ICANN, që është rregullatori suprem në fushën e emrave të domeneve dhe përdoret nga të gjithë regjistrarët e domeneve në botë, qofshin gTLD apo ccTLD. Nuk shohim asnjë arsye të qënësishme që ne të veprojmë ndryshe. Në këtë kontakt ndryshimin e Pika 22.2, e nenit 22 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, e perceptojmë si tendencioze ndaj Rregjistrareve, pasi AKEP nuk ka argumentur arsyen përse kërkon heqjen e këtij termi.

Qëndrimi i AKEP:

Lidhur me qëndrimin 1, AKEP sqaron se bëhet fjalë për regjistrim të regjistruesve në AKEP, pra procesi i regjistrimit ka të njëjtin kuptim me termin regjistrim.

Lidhur me qëndrimin 2, AKEP sqaron që termi akreditim për regjistruesit e domaineve .al i përdorur më parë nga AKEP, në kuptimin e kësaj rregulloreje, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e regjistruesve të përcaktuara në këte rregullore, do të jetë i njëvlershëm me termin “regjistrim” sepse regjistruesit do të vazhdojnë të kenë të njetat të drejta dhe detyrime nga rregullorja e administrimit të domaineve nën .al.

Gjithashtu bazuar në pikën 4 e) të Aneksit 1 të Rregullores, procesi që kryen AKEP është regjistrim i Regjistruesve, prandaj ky është termi më i përshtatshëm që do të përdoret në këtë Rregullore. Gjithashtu edhe termi i Regjistrar në Rregulloren nr. 2, duhet të saktësohet me termin Regjistrues.

Sa më sipër, në Rregulloren Nr. 2:

- termi “I Akredituari” zëvendësohet me termin “I Regjistruari në AKEP për regjistrimin e domaineve nën .al”;
 - termi “Akreditim” zëvendësohet me termin “Regjistrim në AKEP për regjistrimin e domaineve nën .al”;
 - termi Çertifikata e Akreditimit zëvendësohet me termin “Çertifikata e Regjistrimit në AKEP për regjistrimin e domaineve nën .al”.
5. Pika 4 e) e Aneksit 1, të riformulohet: “Bazuar në aplikimin sipas formularit të aplikimit, AKEP do të lëshojë një konfirmim regjistrimi për subjektin aplikues, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të aplikimit të plotë”.

Nuk ka komente

Pika 4 e) e Aneksit 1, riformulohet: “Bazuar në aplikimin sipas formularit të aplikimit, AKEP do të lëshojë një konfirmim regjistrimi për subjektin aplikues, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të aplikimit të plotë”.

6. Pika 1.20 e nenit 1 “Përkufizime:

Ishte:

“regjistrues” – janë subjektet e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës për të bërë regjistrimin e domain-eve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në ANEKS nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt. 21.02.2008;

të bëhet:

“regjistrues” – janë subjektet e regjistruara në Autoritetin Përgjegjës për të bërë regjistrimin e domain-eve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Aneks nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2 dt. 21.02.2008 e ndryshuar;

Qëndrim nr. 1:

Qëndrimi është i njëjtë me propozimin e AKEP.

Qëndrim nr. 2:

Lidhur me ndryshimet e propozuara të Neni 1, pika 1.1; Neni 21, pika 21.1; Neni 22, pika 22.2; Pika 4 e Aneksit 1; Neni 1, pika 1.20, kompania jonë nuk ka ndonjë objeksion për të bërë, duke qenë se AKEP, ashtu si dhe regjistruesit e tjerë të autorizuar prej tij, është i ligjëruar për të kryer gjitha veprimet me domainet .al dhe nën domainet nën .al. Ndaj dhe ndryshimet e pikave të këtyre neneve dhe riformulimit të pikës 4 të Aneksit 1 i gjykon si të përshtatshme.

Qëndrim nr. 3, 4, 5:

Në Pikën 1.1, të Nenit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, të përcaktohet që: "Regjistrues" janë subjektet e akredituara nga Autoriteti Përgjegjës (AKEP) për të bërë regjistrimin e domeneve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Aneks nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt. 21.02.2008;

Neni: 1.20 " regjistrues" - janë subjektet e akredituara nga Regjistri për të bërë regjistrimin e domain-eve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në ANEKS nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt. 21.02.2008

Qëndrim nr.6:

Akreditimi është procesi i njohjes zyrtare të një statusi të veçantë që i jepet dikujt që vlerësohet i kualifikuar për të kryer një aktivitet të veçantë" (perkuftizim që mund të gjendet edhe në Internet). Termi “i akredituar” i jepet një regjistruesi, pasi është vlerësuar në bazë të testeve, se ka kompetencën dhe aftësinë teknike për të kryer detyrën e regjistrimit të domeneve. Ai dallon e mbron regjistruesit që e kanë fituar këtë status të dhënë nga Regjistri .al nga “rishitësit” e shumtë që ofrojnë regjistrim të domeneve .al, si palë të dyta, pa i nënshtruar ndonjë testi teknik nga Regjistri .al dhe pa i paguar AKEP-it pagesën vjetore si regjistrues, gjë që mund të sillte edhe dëm ekonomik për regjistruesit e akredituar. Theksojmë, se termi “regjistrar i akredituar” është futur nga ICANN, që është rregullatori suprem në fushën e emrave të domeneve, dhe përdoret nga të gjithë regjistrat e domeneve në

botë, qofshin gTLD apo ccTLD. Nuk ka arsye teknike që ne të veprojmë ndryshe, duke mos e përdorur atë.

Qëndrim nr. 7:

Dëshhirojmë të theksojmë se termi "i akredituar" i jepet një organizmi të autorizuar dhe vlerëson kompetencën dhe aftësinë për të kryer detyra specifike.

Në administrimin e ccTLDve të ndryshme, termi është de-fakto për të gjithë entet e autorizuara për të kryer rregjistrime të domaineve nën ato zona dhe nënkupton kredenciale zyrtare për rregjistrimin e domaineve nën një zonë të caktuar. Në praktikë termi "i akredituar" mbron (bën dallimin) rregjistrarët që kanë kredenciale pranë AKEP nga "rishitësit" të shumtë që ofrojnë dhe ata rregjistrim të domaineve .al. Tërheqja e termit "i akredituar" për rregjistrarët aktual do të pasqyrohet dhe në një dëm ekonomik indirekt. Theksojmë se termi i "regjistrar i akredituar" është futur nga ICANN, që është rregullatori suprem në fushën e emrave të domeneve, dhe përdoret nga të gjithë regjistrarët e domenëve në botë, qofshin gTLD apo ccTLD. Nuk shohim asnjë arsye të qënësishme që ne të veprojmë ndryshe. Në këtë kontakt ndryshimin e "Pika 22.2, e nenit 22 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar" e perceptojmë si tendencioze ndaj Rregjistrareve, pasi AKEP nuk ka argumentur arsyen përse kërkon heqjen e këtij termi.

Bazuar në argumentat e parashtruara më sipër, jemi të mendimit dhe sygjerojme që AKEP, ashtu sikundër homolget e tij në shtetet e zhvilluara perendimore, duhet:

1. Të mos jetë më në rolin e rregjistrarit për domain-et .al
2. Të konsolidojë rolin e tij rregullator për sistemin e rregjistrimit dhe administrimit të domain-eve .al.
3. Të rrisë kapacitetet dhe të përmirësojë infrastrukturen në funksion të automatizimit të proceseve të brëndshme gjatë rregjistrimit të domain-eve dhe procesimin e shpejtë të rregjistrimeve.
4. Të marrë një rol aktiv në organizimin dhe/ose koordinimin, me aktorë të tjerë privatë ose shtetërore, e fushatave të ndërgjegjësimit për shtetasit shqiptarë dhe kompanitë dhe organizatat që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri për rregjistrimin dhe përdorimin e domain-it .al.
5. Të kërkojë rritjen e cilësisë dhe shtimin e llojshmerisë së shërbimeve nga operatorët që ofrojnë shërbimin e rregjistrimit të domain-eve .al.
6. Të krijojë kushtet e përshtatshme për konkurrencë të drejtë dhe të monitorojë tregun e domain-eve me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Qëndrimi i AKEP:

Siç kemi theksuar më lart, "Regjistrim" është termi më i përshtatshëm i cili përcaktohet edhe në pikën 4 e) të Aneksit 1 të Rregullores nr. 2, ku procesi që kryen AKEP është regjistrim i Regjistruesve. Emërtimi "akreditim" është cilësuar në disa Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave, ku veçojmë Ligjin Nr. 114/2016 "Per akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit ne RSH" dhe VKM VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne RSH" nuk përmendet termi "akreditim" dhe AKEP gjykon se ky term nuk duhet të përdoret në Rregulloren nr. 2, për të shmangur keqkuptime me përcaktimet e ligjit 114/2016 pasi regjistrimi i domaineve nuk ka lidhje me aktivitetet të vlerësimit të konformitetit. Bazuar në ligjin nr. 9918, AKEP nuk gëzon të drejta për akreditimin e subjekteve. Termi "i akredituar" i përdorur nga ICANN, përdoret në kuptimin "i njohur"/"i pranuar".

Sa më sipër, pika 1.20 e nenit 1 “Përkufizime” ndryshohet si më poshtë:

“**regjistrues**” – janë subjektet e regjistruara në Autoritetin Përgjegjës për të bërë regjistrimin e domain-eve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruesve dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Anekset nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2 dt. 21.02.2008 e ndryshuar;

Çështja e tretë: Shqyrtimi i faqeve web të regjistruesve në lidhje me informacionin e publikuar dhe mënyrën e kërimit për domainin .al dhe nëndomainet.

- Në faqen web www.albtelecom.al të Regjistruesit Albtelecom sh.a, ekziston dhe funksionon mundësia e kërimit për domain name .al, (<https://hosting.albtelecom.al/store/cart.php?a=add&pid=14>) dhe çmimi i Albtelecom për regjistrimin e një domain name është 1400 leke/vit. Kjo faqe web është në gjuhën Shqipe.
- Në faqen www.host.al të Regjistruesit Shqiperiacom shpk, ekziston dhe funksionon mundësia e kërimit për domain name .al, (<https://www.host.al/clientarea/cart.php?a=add&domain=register&query=akep.al>) dhe çmimi i për regjistrimin e një domaini .al është 12.99 Euro/vit. Kjo faqe ëeb nuk është në gjuhën Shqipe.
- Në faqen www.webhost.al të Regjistruesit ëebhost shpk, ekziston dhe funksionon mundësia e kërimit për domain name .al, (<https://members.ëebhost.al/cart.php?a=add&domain=register&query=akep.al>) dhe çmimi për regjistrimin e një domaini .al është 12.99 Euro/vit. Kjo faqe ëeb nuk është në gjuhën Shqipe.
- Në faqen www.keminet.net të Regjistruesit Keminet shpk, nuk ekziston mundësia e kërimit për domain name .al por ka një njoftim që regjistrimi i domain .al kushton 12 Euro/vit. Gjithashtu në këtë faqe ëeb ka një link për kërkim domaini .al, i cili të kalon në një faqe ëeb ne gjuhen Angleze <https://www.iregister.al/cart.php?a=add&domain=register&query=akep.al> Në këtë faqe nuk ka asnjë të dhënë se kush është Regjistruesi i domainit .al dhe nuk është në gjuhën Shqipe. Domaini iregister.al është në pronësi të Keminet shpk. Regjistruesi Keminet shpk ka edhe domainin keminet.al i cili të dergon në faqen www.keminet.net.
- Në faqen www.albaniandomains.al të Regjistruesit Studio DRIAR (Fatos Dega – person fizik), ekziston dhe funksionon mundësia e kërimit për domain name .al, (<https://albaniandomains.al/ëhmcs/cart.php?a=add&domain=register¤cy=1>). Në këtë faqe ëeb nuk jepet çmimi për regjistrimin e një domain .al. Kjo faqe web është në gjuhën Shqipe.
- Në faqen www.digicom.al të Regjistruesit Digicom shpk nuk ekziston mundësia e kërimit për domain name .al por ka një shënim që do të jetë e mundur së shpejti. Gjithshtu ekziston informacion mbi regjistrimin e domaineve .al, ekziston linku ku gjendet Rregullorja e AKEP për domainet si dhe sqarimet përkatëse. Faqja ëeb është në gjuhën Shqipe. Çmimi për regjistrim domaini është 29.99 Euro/vit.

- Në faqen www.ederhost.com të Regjistruesit Eder HOST (Ergentian Sota – person fizik) ekziston dhe funksionon mundësia e kërkimit për domain name .al. Çmimi për një domain .al është 1.99 Euro/vit. Kjo faqew nuk është në gjuhën Shqipe.

Tabela përmbledhëse e çmimeve të regjistruesve për regjistrim domainesh .al:

Regjistruesi	Çmimi i ofruar
Albtelecom sh.a	1400 Leke/Vit
Shqiperiacom shpk	12.99 Euro/Vit
Ëebhost shpk	12.99 Euro/Vit
Keminet shpk	12 Euro/Vit
Studio DRIAR (Fatos Dega – person fizik)	Nuk ka çmim të publikuar
Digicom shpk	29.99 Euro/Vit
EDER HOST (Ergentian Sota – person fizik)	1.99 Euro/Vit

AKEP vërejtje qe:

- Në faqet web të regjistruesve (përveç Digicom shpk), nuk ekzistonte Rregullorja Nr.2 e AKEP e ndryshuar për rregullat e regjistrimit/modifikimit/ transferimit/çregjistrimit etj të domain .al dhe nëndomaineve, të miratura nga AKEP dhe as Linku që të lidh me këtë rregullore të AKEP.
- Ne faqet web të regjistruesve (përveç Digicom shpk), nuk ekzistonte lista e domaineve të ndaluara dhe rezervuara apo url që e lidh me këto lista.

Sa më sipër, AKEP kërkoi mendimin e te interesuarve për propozimet e mëposhtme:

- Në pikën 3 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit” të Aneksit 1 të Rregullores Nr 2 të ndryshuar, të shtohen këto kritere për Regjistruesit:
 - Regjistruesi duhet të disponojë faqen ëeb të tij me domain .al ose nëndomain .al, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP. Kjo faqe duhet të jetë aktive dhe funksionale përgjatë gjithë kohës së regjistrimit ne AKEP të Regjistruesit.
 - Regjistruesi duhet të ketë faqen ëeb aktive edhe në gjuhën Shqipe, veçanërisht seksionin e faqes web të tij për domainet .al.
 - Regjistruesi duhet të ofrojë mundësinë e kërkimit për domain .al dhe nëndomaine, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP. Kërkimi do të jetë automatik në sistemin e ccTLD .al dhe realizohet teknikisht vetëm sipas udhëzimeve të AKEP. Kërkimi nuk do ti ofrohet nga Regjistruesi ndonjë pale tjetër për përdorim.
 - Regjistruesi do të mbajë të publikuar dhe të përditësuar, gjatë gjithë kohës së regjistrimit në AKEP, Rregulloren e AKEP në fuqi për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve .al dhe nëndomaineve.

- e. Regjistruesi do të mbajë të publikuar dhe të përditësuar, gjatë gjithë kohës së regjistrimit në AKEP, listën e emrave të ndaluar dhe listën e emrave të rezervuar, siç është miratuar nga AKEP.
- f. Regjistruesi të vendosë një shënim në faqen web që është i regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe që zbaton detyrimet dhe përcaktimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.
- g. Mospërmbushja e secilit prej detyrimeve të mësipërme, çon fillimisht në parajamërimin e Regjistruesit nga AKEP dhe në rast përsëritje, përbën shkak për revokimin e regjistrimit në AKEP.

Qëndrim 1:

Kompania jonë gjykon që propozimi i AKEP për të shtuar disa kritere lidhur me detyrimet e regjistruesve është i nevojshëm në mënyrë që një regjistrues të përmbushë me përgjegjësi të gjitha detyrimet e tij të përcaktuara nga AKEP. Është shumë e rëndësishme që një Regjistrues të disponojë dhe garantojë nga ana teknike gjatë gjithë kohës që ushtron aktivitetin, që faqja e tij ëeb të jetë funksionale dhe vazhdimisht e përditësuar, dhe të ofrojë opsionin e kërkimit për domain .al apo nëndomainet ashtu siç ofrohet një mundësi e tillë dhe në faqen zyrtare të AKEP-it. Gjithashtu, dhe ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave është një aspekt shumë i rëndësishëm për t'u zbatuar në mënyrë detyruese nga ana e një regjistruesi dhe si e tillë të gjithë regjistruesit duhet të jenë të regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe diçka e tillë të jetë e evidentuar qartë në faqen e tij zyrtare web.

Qëndrimet 2, 3, 4 dhe 5:

Përshendetin dhe mirepreesin sugjerimet nën pikën 3.b për pasurimin e faqeve ku ofrohet shërbimi i regjistrimit të domaine-eve.al me informacione shtesë.

Në pikën 3.c kërkohet që regjistruesi të mos i ofrojë në përdorim ndonjë pale të tretë kërkimin automatik për domainet e lira. Ky grup regjistruesish mendon se formulimi i kësaj pike është i paqartë mbi qëllimin e autoritetit rregullator. N.q.s. qëllimi është që regjistruesi të mos i japë akses direkt palëve të treta në, atëherë këtë gjë e shohim si të arsyeshme dhe e mbështesim, pasi i shërben sigurisë së sistemit. Në asnjë rast tjetër përveç atij të përmenduar më sipër, nuk ka kuptim kufizimi i pikës 3.c.

Ky grup regjistruesish e shikon si të domosdoshme sqarimin nga AKEP të kësaj pike. Për më tepër në lidhje me kërkimin e domain-ve, sugjerojmë që WHOIS mbi domainet .al që është jo aktiv, të aktivizohet duke mbajtur informacione bazë si datën e regjistrimit dhe datën e skadimit të një domaini. Si shembull mund të merret WHOIS i Sllovenisë që përmban vetëm të dhënat teknike, pa të dhëna privatësie në whois.

Sipas këtij grup regjistruesish, botimi i listës me emrat e ndaluar për regjistrimin është dosmodoshmëri dhe mbështesim AKEP në një gjë të tillë. Edhe pse në rregulloren aktuale përmendet kjo listë, që nga miratimi i saj e deri më sot kjo liste nuk ka qenë asnjehere e publikuar. Në lidhje me listën e emrave të ndaluar propozimi i këtij grup regjistruesish jepet me poshte:

Lista e emrave të ndaluar, përveç publikimit online, të implementohet në sistemin e administrimit të domaineve të AKEP. Kjo do të përmirësonte me tej procesin e regjistrimit të domaineve pasi aktualisht klientet tanë njoftohen për mos disponueshmërinë e emrit të domainit vetëm pasi kanë bërë pagesën dhe kanë dërguar kërkesën për regjistrim në AKEP. Kjo procedurë, përveç faktit që nuk është transparente krijon edhe kosto financiare shtesë për regjistruesit, pasi në rastin e refuzimit të emrit ne jemi të detyruar ti kthejmë pagesën mbrapsht klientit.

Lista e emrave të ndaluar duhet të ketë një afat miratimi dhe publikimi. Sugjerojmë që në rregullore të përcaktohet afati përfundimtar i shpalljes së kësaj liste. Pas këtij afati nqs lista akoma nuk është shpallur ëteherë të mos ketë refuzim të regjistrimit të domaineve për shkak të emrave të ndaluar. Afatin për shpalljen e kësaj liste ta përcaktojë vetë AKEP në varësi të mundësive që ka dhe aktorëve që përfshihen. Megjithatë sugjerojmë që ky afat të mos jetë më shumë se 6-muaj nga hyrja në fuqi e rregullores së re.

Për arsye të ndryshme mund të ndodhë që lista me emrat e ndaluar të ndryshojë duke shtuar emra të rinj. Jemi të mendimit që AKEP në rregullore duhet të përcaktojë edhe procedurën e përditësimit të listës, gjithmonë duke ndjekur parimin e mos prapaveprimit, dmth emri i një domaini tashmë i regjistruar nuk mund të futet në listën e emrave të ndaluar për aq kohë sa ai domain është aktiv.

Përsa i përket seksionit 3.g: Mospërbushja e detyrimeve të mësipërme, çon në revokimin e regjistrimit nga AKEP:

- Së pari duhet të saktësohet se revokimi bëhet kur nuk përmbushen të gjitha kushtet apo qoftë edhe njëri prej tyre, pasi formulimi i AKEP le të kuptohet se kjo ndodh kur nuk përmbushen të gjitha detyrimet e mësipërme dhe jo në rastin kur nuk përmbushet qoftë edhe një prej tyre.
- Së dyti mendojmë se masa e revokimit të regjistrarit të akredituar nuk mund të bëhet e menjëhershme por e përshkallëzuar. Marrja e një mase revokimi të menjëhershme bie në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 9918, pjesa për kundravajtjet administrative dhe gjobat si dhe me procedurat e Regjistrimit të sipërmarrësve. Për këtë arsye mendojmë që AKEP duhet të shtojë në rregullore edhe masat administrative që merren në rast se nuk përmbushen kërkesat e popozuara në këtë propozim.

Në përfundim ky grup regjistruesish mendon që:

1. Në pikën 3 "Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit" të Aneksit 1 të Rregullores Nr 2 të ndryshuar, pika c) e propozuar nga AKEP të riformulohet në:

c. Regjistruesi duhet të ofrojë mundësinë e kërimit për domain .al dhe nëndomaine, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP. Kërkimi do të jetë automatik në sistemin e ccTLD .al dhe realizohet teknikisht vetëm sipas udhëzimeve të AKEP. Funkzioni i kërimit direkt në sistemin e ccTLD .al në AKEP, nëpërmjet API-ve të dhëna nga AKEP, nuk do të ofrohet nga Regjistruesi ndonjë pale të tretë për përdorim. AKEP rezervon të drejtën të kufizojë kërkimin automatik në sistemin e ccTLD .al nëpërmjet API nga Regjistrarët vetëm nga 1 ose 2 Ipv4 të para-deklaruara. Në rast të ndryshimit të IP-ve nga regjistrarët, këta të fundit duhet të njoftojnë njësinë e regjistrimit në AKEP minimumi 5 ditë pune përpara ndryshimit.

2. Në pikën 3 "Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit" të Aneksi 1 i Rregullores Nr 2 të ndryshuar, të shtohen masat administrative për mosplotësimin e pikave a) deri në f). Propozohet shtimi i dy pikave g) dhe h) si më poshtë:

g. Në rast të mos plotësimit të kërkesave të pikave a) deri në t) brenda afatit 30 ditor nga regjistruesi, AKEP për secilën nga pikat e sipër përmendura merr masa administrative me gjobë 5,000 Lekë për çdo kriter të paplotësuar.

h. Në rast të mos plotësimit të kërkesave të pikave a) deri në f) brenda afatit 60 ditor nga regjistruesi, AKEP për secilen nga pikat e sipër përmendura merr masa administrative me gjobë 10,000 Lekë për çdo kriter të paplotesuar.

Në pikën 3 "Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit" të Aneksit 1 të Rregullores Nr 2 të ndryshuar, pika g) e propozuar nga AKEP të riemërtohet pika i) dhe të riformulohet në:

i. Mospërmbushja e detyrimeve të mësipërme pika a) deri në f) brënda afatit 90 ditor nga data e regjistrimit në AKEP, çon në revokimin automatik të akreditimit nga AKEP dhe fshirjen e të dhënave të regjistruesit nga regjistri i regjistruesve në AKEP.

3. Në pikën 3 "Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit" të Aneksit 1 të Rregullores Nr 2 të ndryshuar, të shtohet një dispozitë kalimtare për regjistruesit e akredituar aktualë:

j. Regjistruesit aktualë të regjistruar në AKEP, duhet të plotësojnë kërkesat e pikave a) deri në f) brënda afatit 60 ditor nga miratimi i kësaj rregullore. Mosplotësimi i kërkesave të pikave a) deri në f) brënda këtij afati çon në revokimin automatik të akreditimit nga AKEP dhe fshirjen e të dhënave të regjistruesit nga regjistri i regjistruesve në AKEP.

Qëndrimi i AKEP për këto komente dhe porpozime:

Për propozimin 1: AKEP pranon propozimin duke riformuluar nën-pikën c) të pikës 3 të Aneksit 1 të Rregullores Nr 2 të ndryshuar:

c) Regjistruesi duhet të ofrojë mundësinë e kërimit për domain .al dhe nëndomaine, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP. Kërkimi do të jetë automatik në sistemin e ccTLD .al dhe realizohet teknikisht vetëm sipas udhëzimeve të AKEP. Kërkimi nuk do të ofrohet nga Regjistruesi ndonjë pale tjetër për përdorim.

AKEP rezervon të drejtën të kufizojë kërkimin automatik në sistemin e ccTLD .al nëpërmjet API nga Regjistruesi vetëm nga 1 (një) IP të paravekluar. Në rast të ndryshimit të IP-së nga regjistrarët, këta të fundit duhet të njoftojnë AKEP minimumi 5 ditë pune përpara ndryshimit.

Për propozimet 2 dhe 3:

AKEP nuk pranon propozimin për arsye se afatet 30 dhe 60 ditore lënë hapësira në mosplotësimin e pikave a deri f. Gjithashtu AKEP sqaron që masat administrative të propozuara nga komentuesit, nuk i ka të përcaktuara në Ligjin 9918 dhe si të tilla nuk mund të aplikojë.

Siç u sqarua më sipër, në pikën 3 "Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit" të Aneksit 1 të Rregullores Nr.2, të ndryshuar shtohet pika n) si më poshtë:

n) Regjistruesi do të mbajnë të publikuar në faqen e tyre web, linkun e faqes web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësive Intelektuale (DPPI) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që mundëson kërkimin për marka/patenta/dizenjo industriale të regjistruara dhe poshtë këtij linku të vendosin njoftimin: *"Përpara kërimit dhe regjistrimit të një domain ".al" duhet të bëni kërkim në faqen web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësive Intelektuale (DPPI) në mënyrë që emri i domainit që kërkoni, të mos jetë markë/patentë/dizenjo industriale e regjistruar nga kjo drejtori. Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkojnë saktësisht*

me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar.

AKEP do të publikojë listën e emrave të ndaluar dhe listën e emrave të rezervuar, e cila do të përditësohet vazhdimisht.

Lidhur me pretendimin për pikën 3.c të Aneksit 1, “Kërkimi nuk do ti ofrohet nga Regjistruesi ndonjë pale tjetër për përdorim”, AKEP sqaron se kjo pikë është e qartë nga vetë Rregullorja Nr. 2 e ndryshuar, e cila përcakton që çdo subjekt i interesuar për regjistrim domainesh nën “.al” duhet të regjistrohet në AKEP si Regjistrues, konform kërkesave të kësaj rregullore. Prej këtij rrjedh edhe kushti i përcaktuar nga AKEP në pikën 3.c .

Çështja e katërt: Verifikimi nëse Regjistruesit janë regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).

Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, detyron çdo subjekt tregtar, të regjistrohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).

Nga verifikimi në faqen ëeb www.idp.al dhe (<http://80.78.70.148/kmdpkerkim/form1.wgx>) të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) rezultoi:

Regjistruesi	Regjistrimi në KDIMDP
AKEP	PO
Albtelecom sh.a	PO
Shqiperiacom shpk	PO
Ëebhost shpk	JO
Keminet shpk	PO
Studio DRIAR (Fatos Dega – person fizik)	Regjistruar gjatë konsultimit publik
Digicom shpk	PO
EDER HOST (Ergentian Sota – person fizik)	JO

Vihet re që 3 (tre) Regjistrues, nuk janë regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), edhe pse është një detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Edhe Rregullorja Nr. 2/2008 e AKEP nuk e ka të përcaktuar këtë detyrim për Regjistruesit.

Gjithashtu nga verifikimi i Ekstrakteve Historike të secilit Regjistrues në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit) rezulton që disa Regjistrues nuk e kanë objekt të aktivitetit

regjistrim emri domainesh .al dhe nëndomainesh .al, ose ndonje emërtim që përfshin regjistrimin e domaineve:

AKEP kërkoi mendimin e regjistruësve për propozimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruësit” të Aneksit 1 të Rregullores Nr.2 të ndryshuar, të shtohen këto kritere për Regjistruësit:
 - a. Regjistruësi duhet të ketë objekt të aktivitetit të tij të regjistruar në QKB, edhe regjistrimin e domaineve .al dhe nëndomaineve ose emërtim që përfshin regjistrimin e domaineve.

Qëndrim 1:

Në kuptim të përcaktimeve të Ligjit për Komunikimet Elektronike, kompania jonë gjykon se regjistrimi i domaineve, shërbim i cili rregullohet nën veprimtarinë e këtij Ligji, përfshihet nën objektin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Ndaj dhe, kompania jonë beson se ky kriter ka vënd për rastet e subjekteve të cilët nuk kanë objekt kryesore të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Prandaj, kompania jonë sugjeron riformulimin si më poshtë:

"a) Regjistruësit që nuk kanë të regjistruar në QKB ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të kenë objekt të aktivitetit të tij të regjistruar në QKB, edhe regjistrimin e domaineve .al dhe nëndomaineve .al ose emërtim që përfshin regjistrimin e domaineve."

- b. Regjistruësit aktuale të regjistruar në AKEP, të cilët nuk kanë të regjistruar si aktivitet në QKB objekt të aktivitetit regjistrim emri domainesh .al dhe nëndomainesh .al ose emërtim që përfshin regjistrimin e domaineve, kanë afat 10 ditë nga hyrja në fuqi e ndryshimeve në Rregullore, për të kryer këtë veprim në QKB dhe dorëzimin e Ekstraktit Historik zyrtarisht në AKEP, brenda këtij afati.

Qëndrim nr. 1:

Ashtu sic theksuam edhe më lart, ky detyrim duhet të qëndroje për regjistruësit aktualë të cilët nuk kanë objekt të aktivitetit të tyre ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Gjithësesi, edhe afati i përcaktuar në propozimin e AKEP nuk është i përshtatshëm në çdo rast pasi sipas përcaktimeve të Ligjit për Shoqëritë tregtare, kompania duhet të respektojë disa afate proceduriale për thirrjen e Asamblesë, ndryshimin e Statutit të kompanisë dhe përditesimin e objektit të aktivitetit pranë QKB. Për pasojë, afati sipas kësaj pike nuk mund të jetë më pak se minimalisht 45 ditë

- c. Regjistruësit aktualë të regjistruar në AKEP, duhet të paraqesin në AKEP brenda 30 ditëve konfirmimin e Regjistrimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).

Qëndrim 2 dhe 3 (për pikat b dhe c):

Regjistruësi njofton se është regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) dhe ka bërë plotësimin në objektin e veprimtarisë së saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas rekomandimeve të drejta të AKEP.

Qëndrimi i AKEP për pikat a, b dhe c:

Në lidhje me qëndrimin dhe propozimin 1 në pikën a, AKEP sqaron që regjistrimi i domaineve .al mund të kryhet nga çdo subjekt i regjistruar në QKB dhe i regjistruar në AKEP por që plotëson kërkesat e Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, ndërsa për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike Ligji 9918 i ndryshuar, përcakton kushtet dhe detyrimet për këto shërbime dhe nuk ka pse një regjistruar domainesh të jetë edhe ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Regjistrimi i domaineve .al nuk është shërbim i komunikimeve elektronike sipas përcaktimeve të Ligjit 9918 i ndryshuar.

AKEP pranon propozimin 1 në pikën b, për zgjerimin e afatit nga 10 ditë në 45 ditë për regjistrimin në QKB të objektit “regjistrim domainesh” nga ana e subjekteve regjistruese të domaineve .al dhe paraqitjen në AKEP të Ekstraktit Historik që parashikon këtë veprim në QKB.

Pika b, bëhet si më poshtë:

b) Regjistruarit aktualë të regjistruar në AKEP, të cilët nuk kanë të regjistruar si aktivitet në QKB objekt të aktivitetit regjistrim emri domainesh .al dhe nëndomainesh .al ose emërtim që përfshin regjistrimin e domaineve, kanë afat 45 ditë nga hyrja në fuqi e ndryshimeve në Rregullore, për të kryer këtë veprim në QKB dhe dorëzimin e Ekstraktit Historik zyrtarisht në AKEP, brenda këtij afati.

Pikat a) dhe c) mbeten siç janë propozuar nga AKEP.

Po kështu në frymën e detyrimeve për transparencë duhet të përfshihet edhe detyrimi për publikim në faqet web të Regjistruarëve të tarifave tv veprimeve me domain nën “.al”, prandaj shtohet edhe pika d)

d. Regjistruarit janë të detyruar të publikojnë në faqet e tyre web (seksioni i regjistrimit të domain .al) tarifat e veprimeve me domain .al (si regjistrim, modifikim, transferim, mbyllje, etj) dhe këto tarifa duhet të jenë të ndara nga tarifa të tjera që mund të aplikojnë Regjistruarit (si psh webhosting, dizajnim faqesh web, etj).

AKEP përshëndet qëndrimin dhe regjistrimin e një Regjistruari pranë KMDPI dhe shtimin e objektit në QKB.

2. Në Rregulloren Nr. 2, nenin 1 “Përkufizime”, të shtohet pika 1.24 si më poshtë:

1.24: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP) është autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin Nr. 9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Qëndrim nr. 1:

Kompania jonë është dakort me propozimin e AKEP për shtimin e kriterëve për regjistruarit për të regjistruar aktivitetin e tyre në QKB si dhe të konfirmimit të regjistrimit të tyre pranë

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe i futjes së pikës 1.24 nenin 1 për përkufizimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si organi përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Për sa shprehur dhe në pikën 3 më sipër për propozimin e pikës (f) të pikës 3, Aneksi 1, në këtë mënyrë krijohen kushtet për të mbrojtur dhe ruajtur konfidencialitetin e të gjitha të dhënave të marra nga subjektet e ndryshme nga regjistruarit gjatë regjistrimit të domaineve të këtyre subjekteve, apo të procesit të transferimit të këtyre të dhënave nga njëri regjistruar në një regjistruar tjetër apo tek AKEP dhe anasjelltas. Gjithashtu dhe regjistrimi i tyre në QKB është i rëndësishëm në kontekstin e transparencës gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Qëndrim nr. 2, 3, 4, 5:

Mbrojtja e të dhënave është një proces shumë i rëndësishëm dhe delikat në kushtet kur, sulmet ndaj tyre dhe keq përdorimi i tyre sot janë një fenomen shqëtesues në mbarë botën. Në këtë kontekst ne mbështetim çdo iniciative dhe propozim të AKEP që ka si qëllim sigurinë e këtyre të dhënave në veçanti dhe të sistemit të administrimit të domaineve në përgjithësi.

Qëndrimi i AKEP:

Qëndrimet dhe komentet e paraqitura, janë të njëjta me propozimin e AKEP prandaj në Rregulloren Nr. 2, nenin 1 “Përkufizime”, të shtohet pika 1.24 si më poshtë:

1.24: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) është autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin Nr. 9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Cështja e pestë: Përditësimi i listës së emrave të ndaluar dhe listës së emrave të rezervuar duke rritur bashkëpunimin me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave, Organet e pushtetit vendor, Institucionet e sistemit gjyqësor, institucione të tjera të percaktuara me ligj ose akte nënligjore, si dhe çdo institucion ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë aderon.

Në pikën 19.7 të nenit 19 të Rregullores Nr. 2/2008 të ndryshuar citohet që: Autoriteti Përgjegjës (AKEP), lidhur me përcaktimin e listës së emrave të ndaluar dhe listës së emrave të rezervuar, bashkëpunon me Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Organet e pushtetit vendor, Institucionet e sistemit gjyqësor, institucione të tjera të percaktuara me ligj ose akte nënligjore, si dhe çdo institucion ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë aderon.

Sa më sipër, AKEP kërkoi mendimin e palëve të interesuara, për propozimin e mëposhtëm:

1. Në periudhën e konsultimit publik të ndryshimeve në Rregulloren Nr. 2 të ndryshuar, të ndërtohet komunikim dhe bashkëpunim me institucionet e sipërcituara për të përditësuar listat e emrave të ndaluar dhe emrave të rezervuar. Ky komunikim të jetë i vazhdueshëm edhe pas ndryshimeve në Rregulloren Nr. 2/2008, të ndryshuar.

Qëndrim nr. 1:

Në lidhje me propozimin e AKEP të një komunikimi të vazhdueshëm gjatë kësaj periudhe konsultimi midis AKEP dhe institucioneve të tjera siç parashikohet në pikën 19.7 të nenit 19, kompania jonë kërkon që të saktësohet nga AKEP që: "Lista e emrave të ndaluar dhe emrave të rezervuar, të jenë të përditësuara në kohë reale, ose në mënyrë të vazhdueshme duke saktësuar dhe datën, muajin, vitin e përditësimit të fundit të kryer nga ky institucion". Gjithashtu, kompania sugjeron që AKEP të përfshijë në rregullore dhe kriteret për përcaktimin e listës së emrave të ndaluar dhe të rezervuar.

Qëndrimet. 2, 3, 4, 5:

Pas më shumë se 8 vitesh hapje e domainit .al për këdo (ose botimit të rregullores në fjalë), mendojmë që lista e domaineve të rezervuara duhet të ishte e konsoliduar dhe e botuar.

Në përputhje me diskutimin dhe propozimin tonë për ndryshimet në pikë 4.2 të këtij dokumenti sugjerojmë që:

1. Lista e emrave të ndaluar, përveç publikimit online, të implementohet në sistemin e administrimit të domaineve të AKEP. Kjo do të përmiresonte më tej procesin e regjistrimit të domaineve pasi aktualisht klientët tanë njoftohen për mos disponueshmërinë e emrit të domainit vetëm pasi kanë berë pagesën dhe kanë dërguar kërkesën për regjistrim në AKEP. Kjo procedurë, përveç faktit që nuk është transparente krijon edhe kosto financiare shtesë për regjistruesit, pasi në rastin e refuzimit të emrit në jemi të detyruar ti kthejmë pagesën mbrapsht klientit.

2. Lista e emrave të ndaluar duhet të ketë një afat miratimi dhe publikimi. Sugjerojmë që në rregullore të përcaktohet afati përfundimtar i shpalljes së kësaj liste. Pas këtij afati nqs lista akoma nuk është shpalluar atëhere të mos ketë refuzim të regjistrimit të domaineve për shkak të emrave të ndaluar. Afatin për shpalljen e kësaj liste ta përcaktojë vetë AKEP në varësi të mundësive që ka dhe aktorëve që përfshihen. Megjithatë sugjerojmë që ky afat të mos jetë më shumë se 6-muaj nga hyrja në fuqi e rregullores së re.

3. Për arsyet të ndryshme mund të ndodhë që lista me emrat të ndaluar të ndryshojë duke shtuar emra të rinj. Jemi të mendimit që AKEP në rregullore duhet të përcaktojë edhe procedurat e përditësimit të listës, gjithmonë duke ndjekur parimin e mos prapaveprimit, dmth emri i nje domaini tashmë i regjistruar nuk mund të futet në listën e emrave të ndaluar për aq kohë sa ai domain është aktiv.

Në këtë kontekst ne propozojmë që:

1. Pika 19.3 e rregullores të ndryshojë si më poshtë:

Autoriteti Përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Rregullore, përgatit dhe publikon në faqen e Internetit www.akep.al, listen e emrave të ndaluar dhe të rezervuar brenda 6 muajve nga miratimi i kësaj rregullore. Pas publikimit AKEP njofton të gjithë regjistrarët e regjistruar pranë tij për publikimin e kësaj liste me emrat e ndaluar dhe të rezervuar.

2. Të hiqet nga pika 19.6 pjesa: Nuk përjashtohen rastet kur për shkaqet e mësipër cituara Autoriteti Përgjegjës, në përgjigje të një aplikimi për regjistrimin e një emri të tillë, të shprehë mosmiratimin e arsyetuar, pavarësisht mosprezencës së këtij emri në listën e publikuar.

3. Në pikën 19.6 të shtohet: Përditësimi i listës së emrave të ndaluar dhe të rezervuar miratohet me vendim të Këshillit Mbikqyres. Pas çdo përditësimi të listës së emrave të ndaluar

dhe rezervuar AKEP, brënda 5 ditëve kalendarike nga data e vendimit për përditësimin e listës, njofton rregjistruarit e regjistruar pranë tij për përditësimin e listës. Regjistruarit, nëse konstatojnë që emrat e përditësuar janë të regjistruar, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga AKEP për përditësimin e listës, njoftojnë regjistrantin mbi përfshirjen e emrit të domainit në listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar.

4. Të hiqet pika 19.9 pasi me ndryshimin e 19.6 nuk ka më kuptim dhe në vend të saj të shtohet një pikë e re me formulimin si më poshtë:

Autoriteti përgjegjës, brenda 1 muaji nga publikimi në faqen e tij të internetit të listës së emrave të ndaluar dhe të rezervuar e implementon këtë listë në sistemin e ccTLD .al duke ndaluar (në rastin e emrave të ndaluar) dhe mos lejuar regjistrimin automatik (në rastin e emrave të rezervuar) të emrave në listën e emrave të ndaluar dhe rezervuar.

5. Të shtohet pika 19.10 me këtë përmbajtje:

Regjistranti, të cilit i hiqet (ose bllokohet) nga Autoriteti Përgjegjës regjistrimi i emrit të domain-it, për shkak të përfshirjes së tij në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar (sipas ndryshimeve pikës së mësipërme 19.6), ka të drejtën e ankimit pranë këtij autoriteti duke parashtruar faktet, kundërshtimet dhe pretendimet e tij për përfshirjen e emrit të cilin zotëron në këtë listë brenda 45 ditëve kalendarike nga data publikimit të listës së përditësuar. Kërkesa, detyrimisht duhet të jetë e shoqëruar me arsyetimet përkatëse. Në rast momarrëveshje me Autoritetin përgjegjës, regjistranti mund të drejtohet gjykatës administrative.

Qëndrim nr. 6:

Lidhur me propozimin për ta bërë pak a shumë të detyrueshëm konsultimin me listat e emrave të ndaluar dhe të rezervuar para regjistrimit të një domeni, vëmë në dukje se aktualisht kontrolli (check) i domeneve nga regjistrantët dhe regjistruarit bëhet automatikisht nëpërmjet API-it (ndërfaqes regjistruar-Regjistrant) duke komunikuar me bazën e të dhënave të domeneve të regjistruara në Regjistrin .al (AKEP). Klientëve apo regjistruarëve nuk mund t'u imponohet të qëmtojnë lista pafund të domeneve të rezervuara apo të ndaluara sa herë që u duhet të regjistrojnë një domen, aq më keq ti marrin ato me mend kur listat mungojnë, si aktualisht. Kjo do ta bënte procesin e regjistrimit të gjatë, të lodhshëm e pa rendiment, gjë që është e papranueshme në ditët tona dhe në kundërshtim me prirjet e zhvillimeve të sotme që shkojnë drejt lehtësimit të punës përmes automatizimit të proceseve. Zgjidhja nuk mund të kërkojë vetëm duke publikuar listat e sipërpërmendura. Madje kjo, ndonëse mund të ishte e dëshirueshme për ndonjë studiues, nuk është përgjithësisht e nevojshme në procesin e regjistrimit të domeneve. Regjistri .al (AKEP), duhet të bllokojë emrat e ndaluar dhe të rezervuar nga sistemi i tij, në mënyrë që askush të mos ketë mundësi të regjistrojë domene të rezervuara ose të ndaluara, apo të detyrohet të kërkojë nëpër lista. Sidomos, të huajt nuk mund të qëmtojnë listat tona. Shkurtimisht, nëse dikush kërkon një domen dhe ky nga sistemi rezulton i lirë, ai nuk ka pse të kërkojë në ndonjë listë nëse domeni është i rezervuar apo i ndaluar. Ai duhet të vazhdojë procedurën e regjistrimit përderisa sistemi i Regjistrit nuk e ndalon. Nëse domeni i regjistruar është i rezervuar apo i ndaluar, përgjegjësia nuk është e regjistrantit, as e regjistruarit, por e Regjistrit - AKEP-it. Regjistri është në të drejtën dhe në detyrën e tij që automatikisht nga sistemi (dhe jo manualisht si deri më sot) të ushtrojë dhe të mbajë përgjegjësinë për këtë çështje.

Edhe në takimin e datës 11.04.2018, disa përfaqësues të Regjistruarëve të domeneve .al, kërkuar që AKEP të hartojë dhe miratojë një listë të emrave të domeneve të ndaluar dhe një listë të emrave të domeneve të rezervuar dhe ta implementojë direkt në API-n e saj.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP bën me dije se gjatë kohës së konsultimit publik ka punuar për krijimin e një liste të domaineve të ndaluar dhe një listë të domaineve të rezervuar. Këto lista do të miratohen së bashku më ndryshimet në Rregulloren Nr. 2, por këto lista do të përditësohen vazhdimisht dhe do të miratohen me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, si pjesë e Rregullores Nr. 2 për administrimin e domaineve .al. AKEP fton Regjistruesit të veprojnë me të njëjtin kujdes si deri sot, gjatë regjistrimit të emrave të domaineve, të cilët mund të jetë e logjikshme të jenë emra të rezervuar apo ndaluar, edhe nëse nuk gjenden në listën e emrave të rezervuar apo ndaluar të miratuar.

Nëse në këto lista do të gjenden emra domainesh të caktuara tashmë, atëherë do të veprohet sipas përcaktimeve të nenit 11, pikat 11.3 dhe 11.4 të Rregullores Nr. 2:

11.3 Poseduesi i emrit të domain-it, merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që lidhen me regjistrimin, përdorimin dhe kryerjen e veprimeve me një emër domain-i në përputhje me kushtet dhe detyrimet e parashikuara në këtë Rregullore.

11.4 Autoriteti Përgjegjës, ka të drejtë t'i heqë poseduesit të drejtat mbi emrin e domain-it, pa kompensim, kur emri përkatës pengon procesin e rinovimit të listës së “emrave bazë” (emra të ndaluar dhe të kufizuar).

Në një rast të tillë, “poseduesi” njoftohet paraprakisht, për heqjen e së drejtës mbi emrin e domain-it, për një periudhë 6 mujore, ose e reduktuar kjo në 3 muaj, në rastin e një emergjence/nevoje të vërtetuar. Kjo kohë, është e nevojshme për t'i dhënë mundësi poseduesit për zgjedhjen e një emri tjetër domain-i dhe sigurimin e një tranzicioni normal.

Për të përmbushur përcaktimet në pikën 19.3 të nenit 19 të ndryshuar, pika f), në pikën 19.2 të nenit 19 të Rregullores nr. 2, shtohet paragrafi:

Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkohë saktësisht me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar.

Për krijimin e listave të tilla AKEP do të vazhdojë konsultimin me institucionet e cituara në pikën 19.7 të nenit 19.

Lidhur me propozimet e mësipërme AKEP i pranon pjeserisht ato, si më poshtë:

Në nenin 19, në fund të pikes 19.6 shtohet paragrafi:

Lista e emrave të ndaluar dhe lista e emrave të rezervuar e domaineve nën “.al” miratohet me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, të paktën 1 herë në vit. Pas çdo miratimi të këtyre listave, AKEP publikon në faqen e tij web këto lista së bashku me datën e fundit të miratimit, si dhe njofton Regjistruesit për publikimin e listave të miratuara në faqet e tyre web. Regjistruesit (dhe AKEP), nëse konstatojnë që emrat e domaineve nën “.al” të listave të miratuara janë të regjistruar përpara vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga AKEP për miratimin e listave, njoftojnë poseduesin mbi përfshirjen e emrit të domainit nën “.al” në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar. Afatet për veprimet me domainin përkatës përcaktohen në pikën 11.4 të nenit 11 të Rregullores.

Në nenin 19, shtohet pika 19.10 me këtë përmbajtje:

19.10: Poseduesi i domainit nën “.al”, të cilit i mbyllet emri i domain-it nga Këshilli Drejtues, për shkak të përfshirjes së tij në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar, ka të drejtën e ankimit me shkrim në AKEP sipas afateve dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative. Kërkesa, detyrimisht duhet të jetë e shoqëruar me arsyetimet përkatëse. Pas marrjes së një ankimi me shkrim, Këshilli Drejtues shyrton ankimin në përputhje me afatet dhe përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe i kthen përgjigje ankimuesit. Në rast mospajtimi apo mosdakortësie me përgjigjen, ankimuesi mund ti drejtohet gjykatës kompetente.

Cështja e gjashtë: Parashikimi në Rregulloren nr. 02/2008 të një periudhe tjetër kalimtare (Sunrise period) për t’iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domaini nën .al, emra me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer , në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas të dhënave të ofruara nga DTIZHB në AKEP, rezultoi që Regjistruesit kanë regjistruar domaine për të tjerë por edhe kanë regjistruar domaine në pronësi të tyre.

Deri në datën 18.12.2017, domaine të regjistruara nga secili Regjistrues, rezultuan:

Regjistruesi	Numri totali i domaineve të regjistruara nga Regjistruesi
AKEP	3223
Albtelecom sh.a	74
Shqiperiacom shpk	8009
Ëebhost shpk	6232
Keminet shpk	1283
Studio DRIAR (Fatos Dega – person fizik)	682
Digicom shpk	0
EDER HOST (Ergentian Sota – person fizik)	639
TOTALI	20 142

Deri në datën 18.12.2017, domaine në posedim të secilit Regjistrues, rezultuan:

Regjistruesi	Numri totali i domaineve të regjistruara nga Regjistruesit në pronësi të tyre
AKEP	6
Albtelecom sh.a	6
Shqiperiacom shpk	3992
Ëebhost shpk	730

Keminet shpk	622
Studio DRIAR (Fatos Dega – person fizik)	239
Digicom shpk	1
EDER HOST (Ergentian Sota – person fizik)	72
TOTALI	5 668

Në Rregulloren Nr. 2 të ndryshuar, vërehet që në pikën 7.1 të nenit 7, përcaktohet:

“Posedues të një ose disa emra domainesh nën zonen .al: .com.al, org.al dhe .net.al, kanë të drejtë të jenë personat fizikë dhe juridikë publikë dhe privat dhe personat fizik tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotesojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e kësaj rregullore”.

Lidhur me sa më sipër, AKEP vërejtje qe:

Termi “një ose disa” domaine nuk e përcakton qartë sa është numri maksimal që një person fizik dhe juridik publik dhe privat apo person fizik tregtar mund të ketë në pronësi. Në zhvillimet teknologjike të sotme, një përdorues mund të regjistrojë disa domaine nën .al, por teknikisht smund ti përdorë të gjitha. Teknikisht dihet që ka një limit domainesh që përmbush kërkesat e një kompanie apo individ. Në gjykimin teknik, ky numër është një ose disa domaine .al por jo pa limit, pra mendohet të ketë një numër të fundëm. Tabela e mësipërme tregon si rast konkret që Albtelecom si një kompani e madhe dhe me fusha të shumta aplikimesh teknologjike dhe shërbimesh të komunikimeve elektronike, ka në posedim vetëm 6 domaine .al. Rast tjetër por Institucion, është vetë AKEP me 6 domaine .al në posedim.

Sa më sipër, AKEP shtron për diskutim nëse në Rregullore mund të përcaktohet një numër maksimal 5 deri 10 domaine për çdo individ apo shoqëri, duke përjashtuar Institucionet Shtetërore.

Siç vërehet nga tabela më lart, Regjistruesit kanë në pronësi 5 668 domaine ose afërsisht 28% të numrit total të domaineve .al.

Pasja në posedim të kaq shumë domaineve .al, si domaine të vetë Regjistruesve, përbën një lloj pengese në lirinë e subjekteve dhe individëve për të regjistruar një emër domaini, në veçanti të atyre që zotërojnë marka dhe patenta të regjistruara.

Në kushtet kur rreth 28% e domaineve janë në posedim të Regjistruesve, për tu ridhënë mundësinë subjekteve të kenë domainin .al të dëshiruar por që nuk e kanë marrë deri sot për shkak të zënies nga Regjistruesit, AKEP shtron për diskutim që nëse do të ishte një lloj zgjidhje që Regjistruesit të lirojnë posedimin e të gjitha domaineve dhe ti kalojnë “të lirë”, edhe për faktin se nuk mund ti përdorin kaq shumë domaine.

AKEP shtron për diskutim edhe propozimin për një periudhë kalimtare (Sunrise period) prej 4 muajsh, të mund të aplikohet për t’iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domaini nën .al, emra me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënie dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm.

Duke ditur nevojat e përdorimit të një domain në zhvillimet e sotme teknologjike, AKEP shtron për diskutim nëse domain duhet përdorur pasi të merret në posedim dhe jo të mbahet i papërdorur duke bllokuar atë emër domaini dhe duke penguar zhvillues të tjerë ta përdorin atë emër domaini. AKEP shtron për diskutim nëse një afat 3 deri 6 muaj është i mjaftueshëm për vendosjen në përdorim të domainit .al pas marrjes në posedim. Gjithashtu AKEP shtron për diskutim nëse një kompani apo individ për arsye teknike të justifikuar dhe provuara nuk ka arritur ta vendosë në përdorim domainin e tij .al, ti njihet e drejta për rinovim me të njëjtin afat por jo më shumë se 1 (një) herë, me kusht që ta vendosë në punë brenda afatit 3 deri 6 muaj pas rinovimit.

AKEP kërkoi mendimin e paleve te interesuara për propozimet e mëposhtme:

1. Në pikën 7.1 të nenit 7, të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, të shtohet edhe emërtimi “individ” si dhe te vendosen afatet, si më poshtë:

Pika 7.1 ishte:

“Posedues të një ose disa emra domainesh nën zonën .al: .com.al, org.al dhe .net.al, kanë të drejtë të jenë personat fizikë dhe juridikë publikë dhe privat dhe personat fizikë tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e kësaj rregullore”.

Pika 7.1 të bëhet:

- a. *“Posedues të një ose disa emra domainesh nën zonen .al: .com.al, org.al dhe .net.al, kanë të drejtë të jenë **individët**, personat fizikë dhe juridikë publikë dhe privat dhe personat fizikë tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e kësaj rregullore”.*
- b. Numri i lejuar maksimal i domaineve .al përfshirë nëndomainet, është 5 deri 10 domaine, me kushtin që të vendosen në përdorim brenda një afati 3 deri 6 mujor. Regjistruerit kanë detyrimin të kontrollojnë nëse domaini i regjistruar/modifikuar prej tyre, është vendosur në punë brenda këtij afati dhe në rast se përdoret gjatë kohës së vlefshmërisë. Nëse verifikohet që një domain qëndron pa përdorur në një afat prej 6 muajsh gjatë kohës së vlefshmërisë, Regjistruerit e kalon atë domain në gjendje të lirë.
- c. Në rast se një kompani/shoqëri për nevoja teknike dhe të arësyetuara, kërkon më shumë se 5/10 domaine .al (përfshirë nëndomainet .al), aplikimi për domainet shtesë bëhet vetëm në AKEP dhe AKEP mund të vendosë regjistrimin e më shumë emrave, por me kushtin që të vendosen në punë sipas afatit të mësipërm.
- d. Poseduesit aktualë të më shumë se 5 deri 10 domaine .al dhe nëndomaine .al, përfshirë Regjistruerit e akredituar, nga momenti i miratimit të ndryshimeve në këtë rregullore, i nënshtrohen afatit 3 deri 6 mujor për vendosjen në përdorim të domaineve.
- e. Institucionet shtetërore dhe çdo institucion ndërkombëtar ku Republika e Shqipërisë aderon, përjashtohen nga ky rregull.

Qëndrim nr. 1:

Së pari, kompania jonë gjykon se numri i lejuar maksimal për domainet të jetë: 1 deri në 5 domaine për individet dhe deri në 15 domaine për personat fizike dhe juridike publik dhe privat.

Ndërsa në lidhje me pikën që domaini duhet të vihet në punë brenda një periudhe të caktuar kohore, praktika ndërkombëtare tregon se shumë shoqëri tregtare për arsye komerciale dhe te konkurrencës regjistrojnë disa domaine, të ngjashem ose jo, për të njëjtin produkt apo shërbim prandaj ndodh që të ketë edhe domaine që nuk përdoren. Për më tepër kjo mundëson edhe shitblerjen e domaineve, që është gjithashtu praktikë e njohur ndërkombëtare prandaj, afat i përdorimit të domainit të jetë jo më pak se 1 vit dhe nëse subjekti nuk e ka vendosur asnjëherë në punë të mos të ketë më të drejtë për ta rinovuar apo për ta marrë këtë domain. Gjithashtu, afati për vënien në përdorim nuk mund të jetë evaziv apo me shtrirje kohore nga "X" kohe deri në "Y" kohë por duhet të jetë e përcaktuar me një periudhë kohore fikse, pasi duke e lenë periudhën të hapur në çdo rast periudha a vënies në përdorim do të ishte burim konfliktit ndërmjet përdoruesit dhe Regjistruesit, dhe gjithashtu me AKEP si organi rregullator dhe monitorues i ofrimit të këtij shërbimi. Ndërsa në lidhje me numrin e domaineve që vetë Regjistruesit kanë të regjistruar për veten e tyre, kompania jonë nuk sheh ndonjë arsye përse të vihet ky kufizim pasi Regjistruesi mund të jetë në kushtet e ofrimit të shërbimit të privatësisë kundrejt pagesës përkatëse, në mënyrë që query whois për një domain të kthejë informacionin e regjistrarit dhe jo të klientit. Kjo është një praktikë e njohur në botë, e cila në të njëjtën kohë nuk pengon autoritetet të bëjnë një kontroll të të dhënave të domainit, duke kontaktuar direkt me regjistrarin, prandaj nuk duhet të ketë kufizim për Regjistrarin për regjistrim të numrit të domaineve.

Kompania jonë mendon se për poseduesit aktualë të cilët disponojnë më shumë se 5 Domain dhe Regjistruesit të cilët disponojnë më shumë se 15 Domain duhet ti nënshtrohen afatit 6 muaj për vendosjen në punë të këtyre domaineve.

Qëndrim nr. 2:

Pika 7.c propozon që regjistrimi i më shumë se 5/10 domain-eve mund të kryhet tek AKEP. *Fillimisht dëshirojmë të themi se në mendimin tonë ky propozim përbën shkelje të barazisë së konkurrencës duke i dhënë AKEP avantazhe konkurruese në krahasim me rregjistruesit e tjerë.* Pasi si rrjedhojë regjistruesit mund të regjistrojnë vetem 5/10 emra për një subjekt dhe emrat e tjerë (domain-et) duhet me patjetër të regjistrohen tek AKEP. Ky propozim i mundëson AKEP përparësi absolute pasi i heq të gjitha regjistrimet regjistruesve të tjerë. Asnjë rregjistrant nuk ndjek 2 procedura të ndryshme për të regjistruar domain-et e tij. Rregjistrimi i 5 domain-eve tek një regjistrues dhe të vazhdojë rregjistrimin e 20-30 domain-eve të tjera tek një regjistrues tjetër (i cili në rastin konkret është i detyrueshëm të jetë AKEP) shkakton ç'organizim dhe humbje kohe për çdo aplikues të interesuar. Vlen të theksohet fakti që zotëruesit e markave dhe patentave ndërkombëtare nuk i drejtohen AKEP-it për regjistrim, por preferojnë regjistruesit e akredituar pasi ata ofrojnë thjeshtësi dhe u përshtaten procedurave të përcaktuara nga vetë ato (kompanitë ndërkombëtare) për menyrën e regjistrimit të domain-it.

Propozimi mbi kufizimin e numrit të domain-eve që mund të regjistrojë një regjistrant, krijon hapësirë për interpretim subjektiv (çfarë krijon mundësi për keq përdorim ose abuzim):

a. në përcaktimin e numrit maksimal (5,6,...apo 10) të domain-eve

b. në kriteret që do të përdoren në përcaktimin e nevojës për më shumë se 10 domain-e.

Procedura e propozuar i jep të drejtën AKEP në përcaktimin se cili subjekt mund të regjistrojë me shumë se 5 ose 10 domain-e pa përcaktuar kriteret mbi të cilat do të merret një vendim i tillë. Ka shumë subjekte brenda dhe jashtë Shqipërisë të cilët kanë një përfaqësim dhe prezantim të gjerë të produkteve dhe shërbimeve të tyre online. Kjo e bën të

domosdoshme që të kenë më shumë se 10 domaine. Kufizimet e propozuara për numrin e domain-eve që mund të regjistrojë një regjistrant bien ndesh edhe me interesat e regjistrarëve të mëdhenj botërore, të cilët shpesh zbatojnë praktikën Whois Proxy për shumë nga domain-et që regjistrojnë nëpërmjet nesh. Pra ata rregjistrimet e tyre i bëjnë me regjistrant administratorin e tyre. Vendosja e kufizimeve në numrin e domain-eve do të pengonte biznesin e tyre në zonën .al dhe për rrjedhojë do të sillte largimin e tyre. Kjo do të ishte një dëm i madh jo vetëm për ata dhe ne si partnerë të tyre, por edhe për vendin tonë, sepse ata mbajnë sot për sot një peshë të madhe të domeneve në zonën .al.

Një pjesë e madhe e domeneve të regjistruara deri sot në botë nuk përdoren për të publikuar ëbsite. Një pjesë e tyre përdoren për parkim, drejtojnë trafikun e visitorëve në ëbsitet kryesore të firmave ose nuk përdoren fare. Roli (funksioni) i domain-it varet nga strategjia e kompanisë, organizatës apo individit i cili ka në pronësi domain-in. Sikurse e përmendëm edhe më lart, domain-et mund të rregjistrohet edhe për mbrojtje: për të mos lejuar keq trajtimin e emrit apo markës së rregjistruesit dhe/ose mbrojtjen e markës nga emra të përfaqësuar, sikurse edhe për përdorim local (intranet) e jo publik.

Në vazhdim, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se teknikisht është e pamundur të përcaktohet me garanci 100% nëse një domain është aktiv apo jo. Edhe nëse një domain nuk ka një shërbim të një faqeje nën Rekordin A www, ai mundet të jetë i përdorur në një rekord të fshehur për intranet në një domain të nivelit të dytë; Nëse nuk ka rekorde të tipit A, një domain mund të jetë i përdorur për shërbimin e emailit apo shërbime të tjera.

Nëse rregulli i fshirjes së domeneve që nuk janë “të vendosur në punë” duke përfshirë parking të domeneve; do të aplikohet sot, rreth 70% e zonës .al do të duhej të fshiheshin nga zona .al.

Mbështetur në argumentat dhe diskutimin e mësipërm mendojmë që propozimet mbi kufizimin e numrit të domain-eve që mund të regjistrojë një regjistrant:

1) përbën një kufizim në kundërshtim me të drejtën kushtetuese për lirinë ekonomike, 2) i jep AKEP avantazhe konkurruese në tregun e domeneve jo duke u bazuar në parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme, 3) avantazhet e propozuara në rregullore, e cila do të miratohet vetëm nga AKEP, e vendosin AKEP në konflikt të pastër interesi.

Në përfundim, jemi të mendimit që:

1. pika 7.1 të ketë reformulimin e mëposhtëm.

“Posedues të një ose disa emra domainesh nën zonën .al: .com.al, org.al dhe .net.al, kanë të drejtë të jenë individët, personat fizikë dhe juridikë publikë dhe privat dhe personat fizikë tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e kësaj rregullore”.

2. pikat e tjera të propozuara nga AKEP jemi të mendimit të mos jenë pjesë e rregullores.

3. Pika 8.1 e rregullores të ndryshohet si më poshtë:

“Me paraqitjen e aplikimit për regjistrim, aplikuesi për të qenë posedues i një emri domain-i, përveç kushteve të tjera të parashikuara në Rregullore, mund duhet të përcaktojë dhe një “kontakt administrativ”. Rregjistruesit duhet të njoftojnë të paktën 1 herë në vit poseduesin e domain-it për të rinovuar të dhënat e “kontaktit administrativ”. Poseduesi, është i detyruar ta rinovojë “kontaktin administrativ” përgjatë gjithë periudhës së përdorimit të emrit të domain-it, çdo herë që ai pëson ndonjë ndryshim.”

4. Pika 10.1 të ndryshohet si më poshtë:

Poseduesi i emrit të domain-it, ka për detyrë që gjatë gjithë kohës së disponimit të tij, të rinovojë informacionin e dhënë gjatë regjistrimit apo transferimit të emrit të domainit brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, nëpërmjet formës përkatëse të parashikuar në

Rregullore. Rregjistruesisit duhet të njoftojnë të paktën 1 herë në vit poseduesin e domain-it për të përditësuar informacionin e dhënë gjatë transferimit ose transferimit të domain-it.

Qëndrim nr. 3:

Lidhur me propozimet për vendosjen e një numri maksimal të domeneve që subjektet e ndryshme, përfshirë regjistruesisit, mund të regjistrojnë në zonën .al dhe atributet që kërkon të marrë AKEP për rastet kur numri maksimal (i propozuar prej tij) është më i madh se 10, apo për kalimin e domeneve në gjendje të lirë, kur nuk plotësohet kushti i vënies në përdorim të tyre brenda një afati 3 deri 6 muaj, mendojmë se perbejnë kufizime të drejtave të njeriut dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike. Kufizime të tilla mund të vihen vetëm me ligj, pra nga Kuvendi. (çdo veprim tjetër është në kundërshtim me Kushtetuten, e cila në Nenin 11 thotë: "Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në Urinë e veprimtarisë ekonomike. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike".

Vendosja e numrit maksimal të domeneve që një subjekt, vendas apo i huaj, mund të regjistrojë në zonën .al, ose detyrimi që ai ta verë në punë një domen brenda 3-6 muaj, është kufizim i drejtave të njeriut dhe i lirisë së veprimtarisë ekonomike. Askush nuk mund të thotë se sa domene duhen për ta ushtruar këtë liri. Askush. gjithashtu, nuk mund ta detyrojë dikë ta përdorë një domen të regjistruar prej tij, ndryshe nga çfarë ai mendon se është më mirë për të si individ apo si subjekt tregtar i lirë në ushtrimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së vet. Aq më tepër, nuk mund të detyrohet që ai të nënshkruajë një deklaratë, se nëse nuk e vë domenin e regjistruar prej tij në punë për 6 muaj, pranon se është dakort që ai (domeni) të kalojë në gjendje të lirë!

Lidhur me këtë çështje vlen të shtojmë se:

a. Firmat, sidomos ato të mëdha, regjistrojnë jo vetëm të gjithë domenet me emrat e markave të tyre në .al, përfshirë edhe nën-domenet .com.al, .net.al, .org.al, por edhe emra që nuk janë identike, por përafrojnë shumë me markat e tyre dhe mund të jenë (jorientuese për konsumatorët, p.sh. soci.al mund të përafrohet shume nga soci.al, godaddy.al me godaddy.al etj. Ne nuk kemi të drejtë të kufizojmë përpjekjet e tyre për mbrojtje në cyberspace me numra si në një lojë kungulleshkash.

b. Kufizimet e vëna për numrin e domeneve që mund të regjistrojë një regjistrant bien ndesh me interesat e regjistrarëve të mëdhenj botërore, të cilët zbatojnë shpesh praktikën 'Whois Proxy' për shumë nga domenet që regjistrojnë tek ne, pra i kerkojnë ato me regjistrant administratorin e tyre, duke u shfaqur në Regjistrin tonë si subjekte me numër të madh domenesh të regjistruara. Vendosja e kufizimeve në numrin e domeneve që ata mund të regjistrojnë do të shkatërronte biznesin e tyre në zonën .al, do të sillte largimin e tyre, gjë që do të ishte dëm jo vetëm për ata dhe për regjistruesit, por edhe për vendin tone, sepse ata mbajnë sot për sot peshën më të madhe të domeneve në zonën .al. Për ne ka rëndësi që për çdo domen të ketë një adresë të saktë kontakti dhe domeni të përdoret konform kërkesave të Rregullores, gjë që në rastin e tyre plotësohet korrektësisht.

c. Një pjesë e madhe e domeneve të regjistruara deri sot në botë nuk përdoren për të publikuar website, siç kërkohet me detyrim në propozimet për ndryshimin e Rregullores. Një pjesë e tyre përdoren për parkim, puntotje në ëbsitet kryesore të firmave ose nuk përdoren fare.

Gjithshka varet nga strategjia e firmës apo e individit në regjistrim. Veç nevojës për publikim website, e-mailing etj., një domen mund të regjistrohet edhe për të mos lejuar nëpërkëmbje reputacioni të individit ose firmes, për mbrojtje marke nga emra domenesh të përafërt apo edhe për përdorim jo publik por lokal (intranet).

d. Kufizime të tilla nuk ka në asnjë gTLD dhe në asnjë ccTLD të ndonjë vendi me ekonomi tregu funksionale. Nuk ka arsye publike që ne të dallojmë nga të tjerët.

Qëndrim nr. 4:

Pika 7.C propozon që regjistrimi i më shumë se 5/10 domain-eve mund të kryhet tek AKEP. Fillimisht dëshirojmë të themi se në mendimin tonë ky propozimi përbën shkelje të barazisë së konkurrencës duke i dhënë AKEP avantazhe konkurruese në krahasim me regjistruarit e tjerë. Pasi si rrjedhojë regjistruarit mund të regjistrojnë vetëm 5/10 emra për një subjekt dhe emrat e tjerë (domain-et) duhet me patjetër të regjistrohen tek AKEP. Ky propozim i mundëson AKEP përparësi absolute pasi i heq të gjitha regjistrimet regjistruarve të tjerë. Asnjë regjistrant nuk ndjek 2 procedura të ndryshme për të regjistruar domain-et e tij. Rregjistrimi i 5 domain-eve tek një regjistruar dhe të vazhdojë rregjistrimin e 20- 30 domain-eve të tjera tek një regjistruar tjetër (i cili në rastin konkret është i detyrueshëm të jetë AKEP) shkakton ç'organizim dhe humbje kohe për çdo aplikues të interesuar. Vlen të theksohet fakti që zotëruesit e markave dhe patentave ndërkombëtare nuk i drejtohen AKEP-it për regjistrim, por preferojnë regjistruarit e akredituar pasi ata ofrojnë thjeshtësi dhe u përshtatën procedurave të përcaktuara nga vetë ato (kompanitë ndërkombëtare) për mënyrën e regjistrimit të domain-it.

5. Propozimi mbi kufizimin e numrit të domain-eve që mund të regjistrojë një regjistrant, krijon hapësirë për interpretim subjektiv (çfarë krijon mundësi për keq përdorim ose abuzim):

a. në përcaktimin e numrit maksimal (5,6,...apo 10) të domain-eve

b. në kriteret që do të përdoren në përcaktimin e nevojës për më shumë se 10 domain-e.

Procedura e propozuar i jep të drejtën AKEP në përcaktimin se cili subjekt mund të regjistrojë më shumë se 5 ose 10 domain-e pa përcaktuar kriteret mbi të cilat do të merret një vendim i tillë. Ka shumë subjekte brenda dhe jashtë Shqipërisë të cilët kanë një përfaqësim dhe prezantim të gjerë të produkteve dhe shërbimeve të tyre on-line. Kjo e bën të domosdoshme që të kenë më shumë se 10 domaine. Kufizimet e propozuara për numrin e domain-eve që mund të regjistrojë një regjistrant bien ndesh edhe me interesat e regjistrarëve të mëdhenj botërore, të cilët shpesh zbatojnë praktikën Whois Proxy për shumë nga domain-et që regjistrojnë nëpërmjet nesh. Pra ata rregjistrimet e tyre i bejnë me regjistrant administratorin e tyre. Vendosja e kufizimeve në numrin e domain-eve do të pengonte biznesin e tyre në zonen .al dhe për njëkohë do të sillte largimin e tyre. Kjo do të ishte një dëm i madh jo vetëm për ata dhe ne si partnerë të tyre, por edhe për vendin tonë, sepse ata mbajnë sot për sot një peshë të madhe të domeneve në zonën .al.

6. Një pjesë e madhe e domeneve të regjistruara deri sot në botë nuk përdoren për të publikuar ëbsite. Një pjesë e tyre përdoren për parkim, drejtojnë trafikun e vizitorëve në ëbsitet kryesore të firmave ose nuk përdoren fare. Roli (funksioni) i domain-it varet nga strategjia e kompanisë, organizatës apo individit i cili ka në pronësi domain-in. Sikurse e përmendëm edhe më lart, domain-et mund të regjistrohet edhe për mbrojtje: për të mos lejuar keq trajtimin e emrit apo markës së regjistruarit dhe/ose mbrojtjen e markës nga emra të përafërt, sikurse edhe për përdorim local (intranet) e jo publik. Në vazhdim, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se teknikisht është e pamundur të përcaktohet me garanci 100% nëse një domain është aktiv apo jo. Edhe nëse një domain nuk ka një shërbim të një faqeje nën Rekordin A www, ai mundet të jetë i përdorur në një rekord të fshehur për intranet në një domain të nivelit të dytë; Nëse nuk ka rekorde të tipit A, një domain mund të jetë i përdorur për shërbimin e emailit apo shërbime të tjera. Nëse rregulli i fshirjes së domeneve që nuk janë "të vendosur në punë" duke përfshirë parking të domeneve; do të aplikohet sot, rreth 70% e zonës .al do të duhej të fshiheshin nga zona .al.

Mbështetur në argumentat dhe diskutimin e mësipërm mendojmë që propozimet mbi kufizimin e numrit të domain-eve që mund të regjistrojë një regjistrant:

1) përbën një kufizim në kundërshtim me të drejtën kushtetuese për Urinë ekonomike,

2) i jep AKEP avantazhe konkurruese në tregun e domeneve jo duke u bazuar në parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme,

3) avantazhet e propozuara në rregulloren e cila do të miratohet vetëm nga AKEP, e vendosin AKEP në konflikt të pastër interesi

Në perfundim, jemi të mendimit që:

1. pika 7.1 të ketë riformulimin e mëposhtem.

"Posedues të një ose disa emra domainesh nën zonen .al: .com.al, org.al dhe .net.al, kanë të drejtë të jenë individët, personat fizike dhe juridikë publikë dhe privat dhe personat fizik tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e kësaj rregullore

2. pikat e tjera të propozuara nga AKEP jemi të mendimit të mos jenë pjesë e rregullores.

3. Pika 8.1 e rregullores të ndryshohet si më poshte:

"Me paraqitjen e aplikimit për regjistrim, aplikuesi për të qënë posedues i një emri domain-i, përveç kushteve të tjera të parashikuara në Rregullore, duhet të përcaktojë dhe një "kontakt administrativ". Regjistruesit duhet të njoftojnë të paktën 1 herë në vit poseduesin e domain-it për të rinovuar të dhënat e "kontaktit administrativ". Poseduesi, është i detyruar ta rinovojë "kontaktin administrativ" përgjatë gjithë periudhës së përdorimit të emrit të domain-it, cdo herë që ai peson ndonjë ndryshim. "

4. Pika 10.1 të ndryshohet si më poshtë:

Poseduesi i emrit të domain-it, ka për detyrë që gjatë gjithë kohës së disponimit të tij, të rinovojë informacionin e dhënë gjatë regjistrimit apo transferimit të emrit të domain-it brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, nëpërmjet formës përkatëse të parashikuar në Rregullore. Regjistruesit duhet të njoftojnë të paktën 1 herë në vit poseduesin e domain-it për të përditësuar informacionin e dhënë gjatë transferimit ose transferimit të domain-it.

Qëndrim nr. 5:

Së pari:

Në faqen 11, sa më sipër, AKEP shtron për diskutim nëse Rregullore mund të përcaktohet një numër maksimal 5 deri 10 domaine për çdo individ apo shoqëri, duke përjashtuar Institucionet Shtetërore.

Faqe 12 : pika b. Numri i lejuar maksimal i domaineve .al përfshirë nëndomainet, është 5 deri 10 domaine, me kushtin që vendosen në përdorim brenda një afati 3 deri 6 mujor. Regjistruesit kanë detyrimin kontrollojnë nëse domaini i regjistruar/modifikuar prej tyre, është vendosur në punë brenda këtij afati dhe në rast se përdoret gjatë kohës vlefshmërisë. Nëse verifikohet që një domain qëndron pa përdorur në një afat prej 6 muajsh gjatë kohës së vlefshmërisë, Regjistruesi e kalon atë domain në gjendje të lirë.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur se parimi I shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi I shtetit të së drejtës dhe I koherencës në sistemin ligjor (vendimet nr.2, datë 03.02.2010; nr.1, datë 12.01.2011; nr 23, datë 08.06.2011; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Neni 4/1 i Kushtetutës parashikon: "E drejta përben bazën dhe kufirin e veprimtarisë së shtetit". Më tej, neni 116 i Kushtetutës përcakton hierarkinë e burimeve të së drejtës si një prej vlerave themelore të shtetit të së drejtës, ku pushteti ligjvënës ka rol primar dhe parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në ushtrimin e funksioneve të organeve kushtetuese, të cilat ushtrohen nëpërmjet është mishërimi më i plotë i parimit të shtetit të së drejtës në një sistem Parlamenti, me pushtetin e veshur nga sovranin për krijim e drejtës autorizon nxjerrjen e akteve normative për materializimin konkret të vullnetit të tij. Ky autorizim duhet t'u përmbahet kritereve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës për të qënë në harmoni me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe në hierarkinë e akteve normative të

sanksionuara përkatesisht në nenin 7 dhe nenin 116 të Kushtetutes (vendimi nr.5, datë 5.2.2014 në Gjykatën Kushtetuese). Neni 118/1 i Kushtetutës sanksionon se "aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtete". Ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon: "ligji duhet autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të cilave nxirren këto akte." Këto dispozita ndihmojnë për t'i dhënë kuptimin kushtetues dhe doktrinar konceptit "rezervë ligjore", nëpërmjet të cilit kufizohet apo orientohet pushteti normativ I organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu permbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi I ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetueshmërisë.

Sipas nenit 171 të Kushtetutes, të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë, në mënyrën se si është formuluar, nuk i ka lënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit si organ përfaqësues. Qëllimi i këtij neni është që në rastin e kufizimeve, jo vetëm duhet të respektohen kriteret e tjera të caktuara në të, por në mënyrë që garancitë të jenë sa më të plota, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht, organi më i lartë ligjvënës.

Shprehja "vetëm me ligj" ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetute, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. përfshirë edhe Këshillin e Ministrave.

Gjykata Kushtetuese ka çmuar se rregullimi I parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë e referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cënon kompetencat e këtij organi. Çdo interpretim i kundërt është padyshim një zhvleftësim i garancisë që jep Kushtetuta për të drejtave dhe lirive të njeriut dhe do të cënonte efektivisht këto liri e të drejta. Në këtë përfundim arrihet edhe duke iu referuar fjalës "vetëm" që përmendin nenet 11/3 e 17 të Kushtetutes. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por ai është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit.

Duke përcaktuar një numër domeinesh të caktuara 5-10 domaine për subjekt kërkues, AKEP ka herë kufizim të të drejtave vecanërisht duke e ballafaquar këtë fakt me mundësinë e sotme të pakufizuar për ta. Kufizimi i të drejtave për një natyrë të tillë duhet behët vetëm me ligj, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe jo nëpërmjet Rregullores së AKEP, që është akt nënligjor. Nëse do të ndodhë një gjë e tillë AKEP ka marrë kompetencën ekskluzive të Kuvendit për të rregulluar në mënyrë normative një kufizim të tillë. Për pasojë, çdo akt që do të prodhojë AKEP në këtë drejtim është në pavlefshmëri absolute dhe për më tepër ngrihet në nivelin e kundërshtimit të një norme kushtetuese.

Shembull: organizata jonë ka më shumë se dhjetë domain (sub domain) në prapashtesën.al. Kufizimi i të drejtës për posedim (jo më shumë se 10) kufizon mundësinë tonë për të përdorur instrumente të komunikimit, informimit dhe shprehjes së lirë të cilat deri tani i kemi përdorur me ligjshmeri. Detyrimi për të mbyllur ndonjë nga domainet tona, si pasojë e një rregullimi kufizues si ky, do të përbënte një rast censure dhe cënimi i të drejtës për të ushtruar aktivitet sipas objektivave dhe misionit të një shoqate jo qeveritare. Po kështu ne kemi në proces aplikimi projekte ku kemi parashikuar që një fjalëformim të caktuar. duke përdorur prapashtesën.al ta sjellim në disa gjuhë zyrtare të BE (me shume se 10). Kjo nuk do të ishte e mundur në një situatë ku rregullorja e propozuar do të bënte të pamundur përdorimin e një web-i me versione në disa gjuhë dhe me domain apo subdomain të përshtatur sipas përmbajtjes.

Së dyti, pasja në posedim me kaq shumë domaineve .al, si domaine të vetë Regjistruesve përbën një lloj pengese në Urinë e subjekteve dhe individëve për të regjistruar një emër domain.al, në veçanti e atyre që zotëron një markë dhe patentë të regjistruara . Ky argument nuk është i bazuar në një fakt apo kërkim shkencor dhe empirik, Fjalori i Gjuhës Shqipe I vitit 2006, publikim I Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, sjell 48 000 fjalë shqipe (pa trajta lakimi dhe zgjedhimi) dhe pa terma teknik apo shkencor. Ndërkohë një domain edhe pse në prapashtesën.al mund të vijë edhe me fjalë në gjuhë të huaja apo akronime, shkurtime dhe iniciale. Edhe kjo është tepër e pa bazuar, kufizon në kohë qëllimin për të cilën dikush bëhet pronar. Mbrojtja e markave dhe patentave është një çështje që rregullohet më së miri juridikisht (edhe doktrina gjyqësore ka dhënë zgjidhje) dhe nuk ka arsye të krijohen kufizime thjesht numerike. Pasja në posedim e kaq shumë domaineve .al, si domaine vetë Regjistruesve, përbën një lloj pengese lirinë e subjekteve dhe individëve për të regjistruar një emër domaini, vecanti atyre që zotërojnë marka dhe patenta të regjistruara. Gjithashtu AKEP shtron për diskutim nëse një kompani apo individ për arsye teknike mirëjustifikuara dhe provuara nuk ka arritur ta vendosë përdorim domainin e tij .al, ti njihet e drejta për rinovim me të njejtin afat por jo shumë se 1(nje) herë, me kusht ta vendosë në punë brenda afatit 3 deri 6 muaj pas rinovimit. Argumentimi i mësipërm i parashtruar në Projekt vendim nuk qëndron Fillimisht që të konkludohet se 'përbën pengesë në lirinë e subjekteve dhe individëve për të regjistruar një emër domain fillimisht duhet të përcaktohet sesa është numri fundor i të gjithë mundësive që ka për prapashtesën.al. Pastaj ky numër fundor duhet të krahasohet me ekzistencën e këtyre domaineve të regjistruar në Posedimin aktual. Nëse krahasimi i numrave rezulton se shkel panmin e proporcionalitetit, atëherë legjitimohet që të ndërmerret një veprim i tillë prej organeve shtetërore. Projektvendimi nuk ka asnjë të dhënë në këtë drejtim për më tepër logjikisht numri i kombinacioneve të fjalëve që marrin prapashtesën.al në domaine është i pafund edhe sikur ti referohemi fjalorit të gjuhës shqipe. Për pasoje, nuk ka kuptim dhe arsye vendosja e këtij kufizimi. Po ashtu ky kufizim nuk mund të vendoset në akt nënligjor, por vetëm në ligj, sipas arsyetimit të mësipërm. Ndërkohë, AKEP përfiton të ardhura nga posedimi i këtyre domaineve ndaj është e pakuptimtë pse duhet të kufizohet një gjë e tillë. I vetmi kusht që palët kontarktuale duhet të respektojnë pagimi i tarifës përkatëse. Vetëm në rast të mospagimit të saj legjitimohet prej AKEP rimarrja e domain dhe lënia e lirë e tij. Shëmbull organizata Jonë për të vënë në punë katalogun e të dhënave të hapura të njohur si Open Data Albania opendata.al ka shpenzuar një vit për aplikim konfirmim fondi nga 6 deri 8 muaj për ndertim web dhe katalogu. Kjo është koha optimale e planifikimit deri në implementim për secilën nga databazat tona me të dhëna të hapura dhe transparente. Kufizimi i parashikuar do të ishte regresiv dhe i pabazuar. Së katërti, Në Aneksin 2, 'Lista e Emrave të Rezervuar' të shtohet si pikë e veçantë. Përbëjnë domaine të rezervuara, emra domainesh nën .al të cilët korrespondojnë saktësisht me emra të subjekteve të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, në zyra, Institucione, Autoritete, tilla si Qendër Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave pronësive industriale, apo emra të përveçëm. Përcaktimi i kriterit mbizotërues (edhe në rast se pranohet si tillë) nuk mund të jetë kriter i përcaktuar në akte nënligjore. Ky kriter dhe ndonjë kriter tjetër është i vlefshëm juridikisht vetëm nëse parashikohet në tekstin e aktit ligjor dhe jo në atë nënligjor.

Gjithashtu ligji, ose nëpërmjet delegimit të shprehur për t'u përcaktuar qartësisht në aktin nënligjor, duhet të përmbajë edhe rregullat të detajuara procedurale se cilat janë fazat dhe modalitetet e ankesës dhe të shqyrtimit të ankesave. Po ashtu, edhe mënyrën e marrjes dhe administrimit të provave apo konfirmimet që duhet të kërkojë në institucionet e tjera vetë AKEP. Legjislacioni shqiptar ka shumë praktika të cilat janë shteruese përse i përket anës procedurale sesi arrihet në një vendimmarrje konkrete nga ana e një organi administrativ. Nga ana tjetër, regjistrimi i një subjekti në një regjister publik psh në QKB nuk përbën absolutisht markë tregtare të këtij subjekti. Regjistri i markave tregtare është një regjister

tjetër që krijon të drejta. Regjistrimi në QKB nuk krijon të drejta por është thjesht efekt publikativ për të tretët Kjo do të thotë se përsa kohë ai ka thjesht dhe vetëm efekt publikues, nuk mund ti ofrohet mbrojtje tjetër dhe as cilësim tjetër ligjor në regjistrin e domaineve.al, sipas projektvendimit të paraqitur. Ky projekt barazon të gjithë regjistrat publike në të njejtin nivel, dhe nuk ben asnjë dallim nëse regjistrimi ka karakter deklarativ apo krijon të drejta të subjekteve. Për pasojë, nuk justifikohet ligjërisht se pse psh regjistrimi në QKB është mbizoterues dhe duhet të respektohet për detyrim nga çdo regjistrim tjetër, kur një status të ligji për QKB-në nuk e ka parashikuar por ka respektuar natyrën deklarative të tij.

Së pesti, projektvendimi duhet të hartohet dhe të zbatohet aktet shqiptare të zbatueshme për hartimin e akteve normative. Ministria e drejtësisë ka nxjerrë një manual të posaçëm për këtë gjë (Manual i Hartimit të Ligjeve). Ky Manual është një lloj i zbatueshëm edhe për hartimin e akteve nënligjore, siç është rasti në fjalë. Ndaj edhe teksti i propozuar duhet të ketë një strukturë të qartë ku të dallohen qartë ndryshimet dhe të pajiset me relacion se pse ky ndryshim është i nevojshëm, etj.

- Akti duhet të përmbajë edhe tabelën për zbatimin e Aquis Communautaire në këtë fushë. Për këtë gjë duhet të hartohet tabela përkatëse ku pasi të përcaktohet qartë direktiva e legjislacionit të BE-së (nëse ka) të jepet edhe përputhshmëria me tekstin e propozuar dhe arsyet përkatëse. Një vlerë e shtuar e aktit normativ të propozuar për diskutim do të ishte edhe krahasimi me eksperiencat e vendeve të tjera në rajon që kanë kaluar faza të tilla të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe siç janë përqasur këto vende çështjeve të tilla që përmban akti i propozuar.

Qëndrimi në mbledhjen e organizuar në AKEP:

Përfaqësues të disa regjistruesve, deklaruan që regjistrimi i shumë domaineve .al në emrin e tyre ka ardhur si pasojë e problemit të adresave të sakta zyrtare të kërkuesve të domaineve, por disa nga këta regjistrues tashmë kanë nisur një proces për kalimin e domaineve në emër të kërkuesve/poseduesve realë dhe ky proces vazhdon.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron që sipas propozimit të tij në konsultimin publik, nuk ka kufizim në numrin maksimal të domaineve .al që një individ/subjekt/etj, mund të regjistrojë por me propozimin e tij AKEP synon një mekanizëm fair play gjatë regjistrimit të domaineve .al, në mënyrë që regjistrimi i më shumë se disa domaineve .al të mos përdoret për raste abuzimi me çmimin/tarifën dhe në të njëjtën kohë të garantojë të drejtën e gjithkujt për të marrë emër domain .al të dëshiruar, pa ju mohuar kjo e drejtë nga rastet abuzive.

Lidhur me propozimin për këtë pikë, AKEP pranon pjesërisht disa nga propozimet, si dhe për të sqaruar më mirë këtë mekanizëm, pika 7.1 të nenit 7, të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, bëhet si më poshtë:

Pika 7.1:

- a. *“Posedues të një ose disa emra domainesh nën zonen .al: .com.al, org.al dhe .net.al, kanë të drejtë të jenë individët, personat fizikë dhe juridikë publikë dhe privat dhe personat fizikë tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e kësaj rregullore”.*
- b. Numri i lejuar i domaineve .al përfshirë nëndomainet, në posedim, është deri në 5 domaine për individët dhe deri 15 domaine për subjektet fizike dhe juridike private/tregtare (përfshirë Regjistruesit e domaineve .al), me kushtin që të vendosen në

përdorim brenda një afati 1 (një) vjeçar. Regjistruerit kanë detyrimin të kontrollojnë nëse domaini i regjistruar/modifikuar/transferuar prej tyre, është vendosur në përdorim brenda këtij afati, në të kundërt Regjistruesi njofton elektronikisht AKEP për ta kaluar atë domain në gjendje të lirë. Vendosja në përdorim e një domaini .al nënkupton paraqitjen e provave dhe fakteve siç janë, krijimi i një faqe web me atë domain, përdorimi i emailve me atë domain, krijimi i rrjeteve të hapura ose të mbyllura me atë domain, aksesimi i sistemeve apo databazeve në distancë, pointimi në faqe web të tjera por me përmbajtje të të njëjtit posedues domaini, përdorime teknike si DNS, FTP, SSH, HTTP/HTTPS, Peer to Peer, etj.

- c. Në rast se për nevoja teknike, tregtare, etj, por të arësytuar, kërkohet të regjistrohen më shumë domaine .al se numri i përcaktuar në pikën b, regjistrimi i domaineve shtesë bëhet vetëm me miratimin e AKEP, por me kushtin që të vendosen në punë sipas afatit të mësipërm. Të interesuarit mund ti drejtojnë këtë lloj kërkesë Regjistruesit të preferuar (ose AKEP nëse ka domaine të regjistruara nëpërmjet AKEP). Regjistruesi e përcjell elektronikisht këtë lloj kërkesë në AKEP brenda 3 ditë pune e cila shqyrtohet dhe i jepet përgjigje brenda afateve dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
- d. Poseduesit aktualë të më shumë domaineve .al (përfshirë nëndomainet .al) të përcaktuar në pikat a dhe b, përfshirë Regjistruesit e domaineve .al të regjistruar në AKEP, nga momenti i miratimit të ndryshimeve në këtë rregullore, i nënshtrohen afatit 1 vjeçar për vendosjen në përdorim të domaineve .al (dhe nëndomaineve .al) që posedojnë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në këtë Rregullore.
- e. Institucionet shtetërore dhe çdo institucion ndërkombëtar ku Republika e Shqipërisë aderon, ka marrvëshje, është antare apo vëzhguese, etj, përjashtohen nga rregullat e pikave b,c dhe d më lart.

Në lidhje me pikën 7.1 - b më sipër:

Në formularët e veprimeve me domainet .al shtohen “deklaratë” dhe “shënim”, si më poshtë:

Deklaratë: Deklaroj se në rast se nuk e vendos në përdorim domainin e sipërshtuar për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e regjistrimit/rinovimit, jam dakort që domaini i sipërshtuar të kalojë në gjendje të lirë.

Shënim: Institucionet shtetërore dhe çdo institucion ndërkombëtar ku Republika e Shqipërisë aderon, është antare apo vëzhguese, etj, përjashtohen nga kjo deklaratë dhe rregulli i vendosjes në përdorim të domain nën “.al” brenda periudhës 1 (një) vjeçare.

Lidhur me deklarinimin e disa regjistruerëve për procesin e nisur nga ata për saktësimin dhe vendosjen nën posedim të domaineve në emer të kerkuesve, AKEP mirepret këtë proces dhe sic përcaktohet në Rregulloren nr. 2, bashkë me ndryshimet, çdo kerkues domaini .al do të jete posedues i tij, sipas kërkesave të kësaj Rregullore.

2. Nga AKEP u propozua të shtohet një dispozitë kalimtare, si neni 38 në Rregullore me këtë përmbajtje:

Neni 38 “Dispozitë kalimtare”:

- a. Brenda një periudhe 4 mujore, subjektet kanë drejtë për të regjistruar emra domaini nën .al (që korrespondojnë në emërtim), emra me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm.
- b. Gjatë kësaj periudhe, me paraqitjen e aplikimeve, Regjistruesit kryejnë verifikime rigorozë rast pas rasti dhe pas miratimit nga AKEP, regjistrojnë domaine .al, sipas pikës 1 më lart.

Qëndrim nr. 1:

Mendojmë se periudha kalimtare është shumë e gjatë, kompania jonë gjykon se do të ishte më e pranueshme që kjo periudhe të ishte jo me shume se 60 dite.

Qëndrim nr. 2:

Propozimi për një periudhë tjetër kalimtare "sunrise", prej 4 muajsh do të vinte në pikëpyetje arrijtjet e deritanishme në tregun e domeneve .al. Procedurat e parashikuara në Rregulloren e tanishme dhe në anekset e saj janë në frymen e direktivave europiane dhe në pajtim me parimet themelore të përcaktuara në dokumentet e ICANN. Kur Rregullorja aktuale hyri në fuqi në vitin 2008, në Nenin 5, ishte përcaktuar edhe periudha "sunrise" dhe rregullat e veprimet që do të kryheshin gjatë kësaj periudhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e markave.

Kjo masë rregullatore ishte në frymën e rekomandimeve dhe të praktikave më të mira botërore dhe AKEP e aplikoi atë më së miri. Kjo masë u krijoi mundësi të gjithë zotëruesve të markave të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet Zyrës së Patentave dhe Markave të vendit tonë, ose nëpërmjet Sistemit të Madridit (të administruar nga WIPO) me Shqipërinë si "vend i përcaktuar", të kryejnë procedurat e regjistrimit të domeneve në mbrojtje të emrave tregtarë dhe të markave të tyre. Me mbarimin e kësaj periudhe. Si veprohet në të gjitha zonat e tjera gTLD apo ccTLD, zbatohet parimi "first come, first served" kush vjen i pari, shërbehet i pari".

Aktualisht, çdo subjekt ka të drejtë për regjistrimin e domeneve .al me emrin tregtar dhe të markave të tij. Në kushtet kur kjo e drejtë është në fuqi dhe çdo subjekt mund t'i drejtohet regjistruesve për regjistrim, nuk ka pse të përcaktohet një periudhe tjetër kalimtare. Edhe nëse në këtë proces ka pasur të vonuar, zgjidhja nuk është hapja e një periudhe tjetër kalimtare (me këte logjike, do të kërkohej që ajo të behej sa herë që ndonje i "rëndësishëm" do ta shihte veten të vonuar), por zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes negociimeve të drejtperdrejta ndërmjet palëve, arbitrazhit dhe gjykates, dhe jo përmes AKEP-it si Rregullator, Regjistër, Regjistrues apo Gjykatës.

Një periudhë e dytë "sunrise" do të sillte bllokimin, çregjistrimin, pezullimin apo transferimin e shumë domeneve, të regjistruara ligjërisht, duke nëpërkëmbur të drejtat e shumë regjistrantëve të ligjshëm dhe do të shoqërohej me kosto financiare të pallogaritshme për regjistruesit vendas e të huaj dhe vetë Regjistrin (AKEP), që do të ndjente fort peshën e gjyqeve jo të pakta kundër tij. Ajo do të jepte sinjalin e pasigurisë ligjore në tregun e domeneve .al, (ku periudhat "sunrise", të hapura sipas interesave të pak njerëzve apo subjekteve, mund të shfaqen papritur), dhe do të ulte shume regjistrimet në zonen .al. sidomos nga të huajt, që njohin mirë parimet e funksionimit të tregut të domeneve.

Vënia në zbatim e një periudhe të dytë "sunrise" përbën një veprim të dëmshëm dhe të rrezikshëm nga pikëpamja rregullatore dhe e interesave të shumicës së regjistruarëve, individëve e firma, dhe të regjistruarëve të domeneve në zonën .al dhe është në kundërshtim me rekomandimet e organizatave relevante ndërkombëtare për administrimin e ccTLD-ve. Nuk ka pse të bëhet nga AKEP një veprim i pakonceptueshëm dhe i palejueshëm në praktikën botërore, që rrit pasigurinë ligjore në tregun e domeneve .al dhe mund të sjellë për pasojë tkurrjen e madhe të tij. Eksperimente të tilla "sui generis", të papara ndonjëherë në botë, nuk duhen inkurajuar nga Rregullatori.

Qëndrim nr. 3:

Si pjesë e propozime për ndryshime në Rregulloren Nr.2 të ndryshuar, AKEP shtron për diskutim propozimin për aplikimin e një periudhë kalimtare (Sunrise period) prej 4 muajsh për t'iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domain-i nën .al, emrat me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm.

Jemi të mendimit se propozimi për një periudhë kalimtare (Sunrise period) prej 4 muajsh në rregulloren e re, është në kundërshtim me frymën e direktivave evropiane dhe parimet themelore të përcaktuara në dokumentet e ICANN. Miratimi i një periudhe të tillë, përveç se dëmton interesat e ligjshme të regjistruarëve dhe poseduesve të domain-eve (individë, persona juridikë apo fizikë) përbën një precedent të rrezikshëm nga pikëpamja rregullatore. Rregullorja nr. 2, me hyrjen në fuqi të saj në vitin 2008, në nenin 5 kishte përcaktuar periudhën "Sunrise" së bashku me rregullat për veprimet që do të kryheshin gjatë kësaj periudhe me qëllim regjistrimin dhe mbrojtjen e markave dhe patentave. Kjo masë rregullatore ishte në frymën e rekomandimeve dhe praktikave më të mira botërore dhe AKEP e aplikoi më së miri.

Aplikimi i periudhës "Sunrise" u krijoi mundësinë të gjitha markave të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, brand-eve ndërkombëtare të mbrojtura (EİPO), Autoriteteve dhe Institucioneve, kompanive dhe shoqatave që të kryejnë procedurat e regjistrimit të domain-eve dhe mbrojtjen e emrave të tyre.

Me përfundimin e kësaj periudhe, dhe me rregullat e përmirësuara të regjistrimit dhe administrimit të domain-eve, u kalua nga sistemi Registry – Registrant në sistemin Registry-Registrar - Registrant. Në treg, së bashku me AKEP, i cili përveç rolit të Regjistrimit ruajti edhe rolin e Regjistruarësit, do të operonin edhe Regjistruarësit e akredituar nga AKEP bazuar në rregullat e miratuara.

Aktualisht çdo subjekt e ka të drejtën, që nëpërmjet Regjistruarëve të akredituar nga AKEP, të regjistrojë në zonën .al emra domain-i me të cilin njihet për shkak të veprimtarisë dhe/ose për markat që ka në zotërim.

Bazuar në sa më sipër, përveç të tjerave, mendojmë që nuk ekzistojnë arsyet rregullatore për një periudhë të dytë "Sunrise" dhe propozimi i paraqitur nga AKEP në konsultën publike nuk jep të tilla.

Në vazhdim, do të dëshironim të sillnin në vëmendjen tuaj se një periudhë e dytë kalimtare "Sunrise" sipas propozimit të paraqitur në konsultimin publik nga AKEP:

1. Krijon hapërisë për abuzim dhe keq interpretim të procedurës së administrimit të domeneve. Për tepër do të krijonte precedentin për mos garantimin e sigurisë juridike nga Autoriteti Rregullator.

2. Do të zhvlerësonte të gjithë arritjet e deritanishme në tregun e regjistrimit dhe administrimit të domain-it .al dhe është në kundërshtim me të gjitha rekomandimet dhe

manualet e ITU, ICANN, të Parlamentit Evropian, Komisionit të Komunitetit Evropian, CENTR, etj për administrimin e ccTLD.

3. Ka një efekt të madh financiar jo vetëm AKEP si Regjistër apo Regjistrues por edhe Regjistruesit e autorizuar dhe zotëruesit e domain-eve. Bllokimi, çregjistrimi, pezullimi apo transferimi i emrave domain tashmë të regjistruar dhe që mund të jenë pjesë e një biznesi funksional prej vitesh do të implikonte detyrimisht edhe AKEP në procese gjyqësore në gjykatat administrative. Rrjedhimisht, ngarkesa dhe pasiguria ligjore për të ardhmen që do të shkaktonin procese të tilla do të ishin me efekte shumë negative për reputacionin e domain-in e zonës .al.

Në vazhdim të argumentimit mbi tejkalimin e periudhës kalimtare “Sunrise”, mungesën e nevojës dhe rreziqet që mbart një periudhë e dytë kalimtare “Sunrise” - për rrjedhojë edhe kundërshtimin e saj - më poshtë po sjellim referenca dhe rekomandime që të cilat gjithashtu kundërshtojnë që periudhë të dytë kalimtare.

7.2.2.1 Praktika e QKB

Ligji Nr. 8/2015 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9723, DATË 3.5.2007, "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", të ndryshuar, ka parashikuar se:

- *Verifikimi paraprak nëse një emër mund të regjistrohet ose jo, si dhe rezervimi paraprak i emrit nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e emrit të regjistruar duke hequr barrierat e procesin e regjistrimit dhe të rezervimit të emrit. Natyrisht kjo nuk i ndalon kontestimet e palëve të treta në gjykatë për emrin e regjistruar. E njëjta praktikë duhet të aplikohet edhe për domain-et. Nqs ka mosmarrëveshje midis palëve për pronësinë e domainit atyre duhet tu garantohet e drejta për një proces të ndershëm dhe të paanshëm gjykimi.*

Rregullorja Nr. 2 i ka përcaktuar 3 institucione/organizata të cilat japin të drejtën mbi pronësinë.

7.2.2.2 Periudha kalimtare (Sunrise period) është tejkaluar sipas përcaktimit të ICANN dhe EIPO

“Sunrise” sipas përcaktimit të ICANN dhe WIPO, ju krijon bartësve të markës tregtare një mundësi paraprake për të regjistruar emrat e domain që korrespondojnë me shenjat e tyre përpara se emrat domain të jenë në përgjithësi në dispozicion të publikut.

Kjo periudhë sigurisht që çënon parimin "first come, first served" - kush vjen i pari shërbehet i pari - por kjo është tejkaluar pikërisht për arsyen e mbrojtjes së markave. Me përfundimin e kësaj periudhe parimi "first come, first served" është baza e procesit të regjistrimit dhe ky parim bazuar në direktivën “Directive 2002/22/EC të Parlamentit Evropian të datës 7 Mars 2002 mbi Shërbimin Universal dhe të Drejtat e Përdoruesve në Lidhje me Rrjetet dhe shërbimet e Komunikimeve Elektronike (Universal Service Directive)” është në themel të çdo procesi autorizimi apo licensimi.

Sipas ICANN, WIPO dhe EU,

1. Mbajtësit e të drejtave të mëparshme të njohura ose të themeluara nga ligjet kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe organet publike kanë të drejtë për të aplikuar për të regjistruar emrat e domain gjatë një periudhe regjistrimi në fazën përpara fillimit të regjistrimit të përgjithshëm.

Sipas këtij përcaktimi në Shqipëri kjo periudhe është tejkaluar (neni 5 i Rregullores nr.2).

Bazuar në manulet dhe rekomandimet ndërkombëtare, një periudhë e dytë “sunrise” mund të niset vetëm përpara lancimit të një top level domain TLD të ri dhe kjo do t’iu lejonte mbajtësve të brandeve dhe markave të regjistrimit emrat e tyre. Shqipëria nuk ndodhte në këto kushte. Ndryshime e propozuara nuk janë pjesë e hapjes së një TLD të ri, prandaj çdo

periudhe e dytë sunrise është në kundërshtim me parimet themelore të proceduarve të regjistrimit të domain.

AKEP dhe Shqipëria si vend kandidat për në EU ka shembullin më të mirë të këtyre praktikave të aplikuara nga EU për implementimin e domain .eu. (përcaktuar në vendimet e Parlamentit dhe Komisionit Europian).

7.2.2.3 Rekomandime të Organizatave Ndërkombëtare ku AKEP është anëtar

Në nenin 7 te ligjit 9918, Objektivat rregullatorë, përcaktohet se AKEP-i ushtron funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Duke qenë anëtar i ITU, anëtar i ccNSO e CENTR si dhe Shqipëria është vend kandidat për BE, AKEP duhet të implementojë rekomandimet dhe manualet e tyre në trajtimin e këtyre çështjeve të cilat përcaktojnë se qeveritë apo autoritetet publike kanë përgjegjësinë për objektivat e politikave publike si:

- praktika transparente dhe jo diskriminuese
- zgjidhje të mëdha, çmime të ulëta dhe shërbime më të mira për të gjitha kategoritë e përdoruesve,
- respekt për privatësinë personale,
- mbrojtjen e interesave te konsumatorëve

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e tyre për të mbrojtur këto interesa, qeveritë ose autoritetet publike mbajnë autoritetin përfundimtar të politikave mbi ccTLD-të e tyre përkatëse dhe duhet të sigurojnë që ato të veprojnë në përputhje me objektivat e brendshme të politikës publike, ligjet dhe rregullorët, ligjin ndërkombëtar dhe konventat ndërkombëtare në fuqi.

Në shpjegimin e paraqitur në pikën 7.2.2.2, periudha kalimtare “Sunrise” pranohet si praktikë diskriminuese. Bazuar në rekomandimet e mësipërmeve, ky proces nuk duhet inkurajuar në vazhdim, përveç rastit të aplikimit gjatë procesit të hapjes fillestare të TLD -ve (ku lejohet pikërisht për arsyen e mbrojtjes së markave).

Në përfundim, jemi të mendimit se:

1. Neni i propozuar 38 të hiqet nga lista e ndryshime të propozuara dhe që do të paraqiten për miratim
2. Jemi të vetëdijshëm që pas periudhës “Sunrise” të 2008 mund të ketë pasur keqpërdorime të regjistrimit të emrave të marka-ve nga individë të ndryshëm, të cilat në shumicën e rasteve janë pasojë e mungesës së njohurive dhe ndërgjegjësimit nga vetë të dëmtuarit. Të nxitur nga qëllimi i mirë për të rritur përdorimin e domaineve në zonën .al sikurse për të ndihmuar kompanitë në regjistrimin e emrave me të cilët njihen ose markave që zotërojnë ne do të propozonim që:
 - a. AKEP brenda kuadrit të një fushate ndërgjegjësimiti për regjistrimin e domain-eve .al nga kompanitë, organizat dhe individët të shpallte një periudhë të veçantë konsultimi 1-2 muaj për të gjitha kompanitë që kanë pretendime mbi emrat e domaineve të regjistruar përpara miratimit të ndryshimeve në Rregulloren Nr.2.
 - b. Gjatë kësaj periudhe AKEP, në bashkëpunim me Regjistrarët e akredituar të verifikonte nëse procesi i regjistrimit dhe të dhënat e Regjistratit janë në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 2.
 - c. T’u mundësonte palëve në “konflikt” ti parashtronin njëri-tjetrit prentedimet e tyre dhe të inkurajonte zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
 - d. Në rast të mos zgjidhjes së konfliktit të udhëzonte palët mbi mekanizmat dhe instrumentat ligjorë që parashikon rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

7.2.3 Mbi vetdeklarimin dhe mbylljen e domaineve që nuk janë në përdorim AKEP, bazuar në ndryshimet e propozuara në pikën 7.1 të rregullores, parashtron nevojën për shtimin e një dekalrate dhe shënimi në formularët e veprimeve me domainet.

Duke ju referuar argumentave të paraqitura në diskutimin tonë mbi ndryshimet e propozuara për pikën 7.1 të Rregullores Nr.2, të parashtruara në pikën 7.2.1 të këtij dokumenti jemi të mendimit se kjo deklaratë nuk është e nevojshme. Nqs se AKEP dëshiron të implementojë ndonjë funksion në sistemin e regjistrimit të ccTLD .al, i cili i mundëson zotëruesit të domainit që të çrregjistrojë me dëshirën e tij domainin që zotëron përpara afatit të skadimit, ne nuk kemi ndonjë kundërshtim. Në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren Nr.2 dhe Anekset përkatëse ne do të implementonim në sistemin tonë të menaxhimit të domaineve një funksion të tillë për t'ia ofruar zotëruesit të domain-it.

Qëndrim nr. 4 (për pikat 1 dhe 2):

Këto ndryshime ndikojnë negativisht në tregun aktual të domaineve dhe procesin në vazhdim të regjistrimit dhe administrimit të domaineve. Këto sugjerime janë në kundërshtim me praktikën me të mira për rritjen dhe zhvillimin e tregut. Përfshirja e tyre në rregulloren e regjistrimit dhe administrimit të domain-eve do të ulte besueshmërinë e regjistrantëve tek domain .al duke përforcuar edhe më tej fenomenin tashmë të njohur në tregun shqiptar të përdorimit të domaineve .com ose TLD të tjera. Për më tepër, këto sugjerime janë në shumicën dërrmuese të tyre kufizime dhe përcaktime që nuk janë në përputhje me konceptin e ekonomisë së tregut.

Si pjesë e propozimeve për ndryshime në Rregulloren Nr.2 të ndryshuar, AKEP shtron për diskutim propozimin për aplikimin e një periudhe kalimtare (Sunrise period) prej 4 muajsh, për t'iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domain-i nën .al, emrat me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësive industriale, apo emra të përveçëm. Jemi të mendimit se propozimi për një periudhe kalimtare (Sunrise period) prej 4 muajsh në rregulloren e re, është në kundërshtim me frymën e direktivave evropiane dhe parimet themelore të përcaktuara në dokumentet e ICANN. Miratimi i një periudhe të tillë, përveçse dëmton interesat e ligjshme të regjistruesve dhe poseduesve të domain-eve (individë, persona juridike apo fizike) përben një precedent të rrezikshëm nga pikepamja rregullatore.

Komentet dhe qëndrimet e tjera janë të njëjta.

Qëndrim nr. 5:

Në lidhje me propozimin e AKEP për kufizimin e numrit të domaineve që një posedues mund të regjistrojë, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen e tij se praktikën e kufizimit të çfarëdo lloji bien ndesh me parimin e ekonomisë së tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike të përcaktuar si sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë në Kushtetutën e RSH, Neni 11-te i saj. Në këtë nen, në pike 3 të tij, përcaktohet se: "Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike". Në këtë kontekst, e gjejmë të pabazuar në ligj kufizimin që rregulloja e regjistrimit dhe administrimit të domain-eve kërkon të vendosë. Për më tepër në asnjë dokument të autoriteteve që administrojnë domain-e përfshi ccTLD apo çdo kategori tjetër, nuk aplikohet një kufizim i tillë. Përveç argumentave të sipërpermendur dëshirojmë të sjellim në vëmendjen e AKEP se një kufizim i tillë do të dëmtonte jo vetëm regjistruesit e domain-eve .al por edhe tregun e domainit .al sepse:

1. Rasti i AKEP dhe Albtelecom mendojmë që nuk janë rastet e përshtatshme për t'u marrë si raste përgjithësimi. AKEP është ent publik dhe, pavarësisht argumentave të ndryshme, burimet për të zhvilluar domaine të ndryshme i ka të kufizuara. Për rrjedhojë nevoja për domaine është nën kufizimin e burimeve për zhvillimin e tyre. Rasti i Albtelecom, ose kompanive të ngjashme me të, gjithashtu nuk është rasti i përshtatshëm për t'u marrë si rast përgjithësues. Albtelecom nuk është kompani që ka si biznes të saj zhvillimin e domaineve. Albtelecom, sikurse një pjesë e mirë e kompanive të tjera, domain-in e përdorimin si një alternative për të njohur klientët e tyre ose ata potencialë me produktet e tyre dhe/ose për të ofruar një ose disa shërbime online. Për më tepër, fakti që në këtë moment Albtelecom zotëron një numër të caktuar domainesh nuk do të thotë që në të ardhmen (me shtimin e produkteve apo shërbimeve) nuk i nevojiten më shumë. Më poshtë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj disa shembuj të tjerë kur një kompanie mund ti nevojiten më shumë domaine se parashikimi i propozuar nga AKEP:

Një agjenci imobiliare me shtrirje në gjithë territorin e Shqipërisë që të jetë sa më prezente me emrin e saj e ka të nevojshme që të ketë të paktën 1 domain për secilën zyrë përfaqësie në rrethin apo qendrën administrative ku ka zyrën p.sh: imobiliare-tirane.al, imobiliare-durrës.al, ... Kufizimi i subjektit në numrin e domain-eve që mund të përdorë është cenim direkt i të drejtë: për Urinë ekonomike në ushtimin e aktivitetit të tij. Një subjekt i cili operon në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ofrimin e produkteve software e ka të nevojshme të ketë domain për secilin produkt të tij. Sot ka me 10-tra subjekte, të cilët ofrojnë produktet e tyre në treg dhe për secilin produkt kanë domain-e e tyre. Një subjekt i cili vepron në fushën e reklamave dhe publikimeve ka të nevojshme që të reklamojë të gjithë produktet e tij në domain-e të ndryshëm që të jenë sa më të prekshëm nga përdoruesit. Subjekti ka të nevojshme të përdorë domain-et: pushime.al, pushimenëtirane.al, pushimëdurrës.al, udhëtime.al, udhëtimeturistike.al, udhëtimemeanije.al, etj. Po ashtu dhe domain-e për zyrat e saj në rrethe të ndryshme.

2. Kufizimi apo kuotizimi i domaineve bie ndesh me ICANN Defensive Registration.

ICANN njih termin "Defensive Registration" (https://icannwiki.org/Defensive_Registration) - si rregjistrimi mbrojtës i domaineve. Kjo praktikë u lejon kompanive që të rregjistrojnë disa domaine të ngjashme me markën e tyre. Shembuj: kohajone.al, koha-jone.al, gazetakoahajone.al, gazetakoahajone.al, kohajone.com.al, kohajone.net.al, koha-jone.com.al etj. Kompanite, sidomos ato të medha, rregjistrojnë jo vetëm të gjithë domain-et me emrat e markave të tyre në .al, por edhe në .com.al, .net.al, .org.al, por edhe emra që nuk janë identike, por përafrojnë shumë me to dhe mund të jenë çorientues për konsumatorët, p.sh. soci.al mund të përafrohet shumë nga soci.al etj. Kufizimin në numrin e domain-ev që një posedues mund të rregjistrojë e shohim si kufizim të të drejtës së tyre për të mbrojtur pronën dhe biznesin e tyre në hapësirën kibernetike.

3. Republika e Shqipërisë akoma nuk ka një sistem adresash të konsoliduar. Përpjekja më e fundit në këtë drejtim ka nisur vitin e kaluar me projektin e OSHEE, por edhe ai projekt në dijeninë tonë nuk ka përfunduar akoma. Për më tepër ndryshimi i kultures së identifikimit të adresës me përshkrime rrethore do të kërkojë një periudhë të caktuar edhe pasi të implementohet sistemi i adresave. Kështu që për të bërë një gjykim sa më të saktë, duhen marrë në konsideratë problematikat me të cilat rregjistruarit e domain-eve ndeshen çdo ditë. Praktikisht, nëse një aplikim përmban vetëm emër rrugë si adresë për një Institucion, p.sh; "Firma X, Rruga Reshit Çollaku", AKEP bën refuzimin e aplikimit me arsyetimin; "Të dhëna jo të plota" pasi mungon një numër objekti. Për më tepër, vetë AKEP ka adresën Rruga Reshit Çollaku, pa numër objekti. Rikujtojmë në Rregulloren Nr 2 e ndryshuar, Neni 8, pika 2 përcakton:

8.2 Poseduesi i emrit të domain-it i ka të drejtë të zgjedhë si "kontakt administrativ", veten e tij ose një person juridik privat ose person fizik tregtar/jo tregtar, pavarësisht nëse ai ka ose jo marrëdhënie të drejtpërdrejtë me të.

Më tej Neni 9 pika 2

9.1 Është domosdoshmeri, që Autoriteti Përgjegjës të ketë mundësi të kontaktojë "poseduesin" e emrit të domain-it ose "kontaktin administrativ", në çdo kohë sipas rastit dhe nevojës së paraqitur.

Siç shihet, edhe në rregulloren aktuale, AKEP thekson nevojën e pranisë së një kontakti administrativ që do të mund të krijojë kontakt me poseduesin e një domaini në çdo rast. Shumë nga aplikimet për domaine që vijnë nga individë apo dhe kompani në territorin e Shqipërisë, kanë adresa që nuk pranohet nga stafi i AKEP (si p.sh Rruga Reshit Çollaku; por pranohen nga QKB dhe ente të tjera). Për këtë arsye, jemi të detyruar që për shumë nga klientët tanë në vend të adresës jo të plotë të regjistrantit, të vendosim adresën tonë si kontakt administrativ (duke u siguruar se kemi një identifikim të klientit nëpërmjet ID apo NIPT). Kjo është një praktikë e njohur edhe në botë; në një pjesë të mirë bëhet jo nga nevoja, si në rastin e shpjeguar më sipër, por si një strategji tregu për mbrojtjen e privatësisë së regjistrantit. Kur pronari i një domeni - kompani apo individ, nuk do që për hir të reputacionit të shënjestrohet dhe sulmohet nga hackerat etj., ai kërkon që domain-i i tij të mos ekspozohet me emrin e tij të vërtetë, përfshirë kontaktin teknik dhe billing. Kjo praktika njihet ndryshe si Whois Proxy! Aktualisht në botë janë mbi 10 milionë domain-e janë sipas kësaj praktike. Theksojmë që ne si regjistrar nuk kemi në posedim real shifrat e përmendura në statistikën e paraqitur në dokumentin e këshillimit publik.

Qëndrim nr. 6:

Lidhur me sa shtruar për diskutim në këtë këshillim publik nga ana e AKEP për futjen e një periudhe kalimtare 4 mujore për regjistrimin e emrave të domaineve të emrave me të cilat ata njihen në ushtrimin e aktivitetit të tyre, kompania jonë vlerëson se në shumë raste, planifikimi bëhet edhe për periudha më afatgjata. Psh. nëse ka plan të futet ndërkombëtarisht një produkt me emrin xxxx kompania mëmë mund të bëjë regjistrimin lose 2 vite para. Kompania jonë sugjeron të përfshihet një dispozitë për rastet kur një markë regjistrohet, edhe domain-i të futet njësoj me vlefshmërinë e regjistrimit të markës. Gjithashtu, periudha kalimtare prej 4 muajsh përfshin vetëm domainet nën posedim nga regjistrarët apo dhe raste të tjera të domaineve që përdoren nga subjekte të ndryshme?

- Në lidhje me propozimin e AKEP në pikën 7.1 të nenit 7 pika (b) për numrin maksimal të domaineve nën .al (përfshirë nëndomainet) nga 5-10 të tillë, referuar Rregullores së KE-së Nr.874/2004, në nenin 2 "Eligibility and general principles for registration" citohet si më poshtë vijon: "An eligible party, as listed in Anide 4(2)(b) of Regulation (EC) No 733/2002, may register one or more domain names under.eu TLD.

Gjithashtu dhe në nenin 7, pika 5 të Vendimit të Autoritetit rregullator të Greqisë mbi Rregulloren "Për administrimin dhe caktimin e emrave të domaineve .gr", citohet se:

"No restriction shall exist as to the number of [.gr] Domain Names that can be assigned to one Single person."

Gjithashtu, një situatë e tillë është e parashikuar dhe në Rregulloren aktuale në fuqi, neni 7, pika 7.1 të saj, në të cilën nuk kemi një kufizim të numrit të domaineve nën .al nga posedues të ndryshëm publike apo privatë, Pra, kjo pikë është në linjë me sa parashikohet në normativën e BE-së sipas Rregullores së KE-së Nr.874/2004, apo dhe asaj të një vendi tjetër anëtar i BE-së si Greqia. Por duke qënë se në propozimin e tij AKEP, në paragrafin (c) të kësaj pike parashikon mundësinë për më shumë se 5/10 domaine nga një subjekt për regjistrim i cili do të kryhet vetëm tek AKEP sipas një afati 3-6 muaj, kompania jonë gjykon që ky propozim merr në konsideratë dhe kuadrin rregullator të BE-së si dhe nevojën e kompanive/shoqerive për të pasur një numër më të madh domainesh, dhe në një kontekst të tillë kompania shprehet dakort me këtë propozim të AKEP për një numër më të madh domainesh.

Lidhur me nevojat që lindin për kompaninë, marka si "_____" mund të kenë nevojë përdorimi për më shumë se 10 domaine. Në këtë mënyrë kërkojmë specifikime të mëtejshme

nga AKEP që të përcaktojë në Rregulloren e re se cilat do të jenë kushtet për dhënien e domaineve shtesë dhe afatet brenda të cilit do të jepet miratimi. Një pyetje që lind në këtë pikë është se çfarë ndodh me blerjen e domaineve nga kompania mëmë. Psh. Domain-i _____ .al është blerë nga agjensia e _____. Ndërsa për afatin 3-6 muaj për vënien në përdorim të domaineve, kompania jonë kërkon që të përkufizohet çfarë do të thotë vënie në përdorim lidhur me afatin 3/6 mujor për domainet. Për shëmbull çfarë ndodh nëse nën-brandet ridrejtohen tek faqja kryesore. Një rast i tillë quhet në përdorim? Një shëmbull: www.____.al është prej 2 vjetësh në pronësinë e _____ dhe ridrejtohet tek faqja e _____, dhe nuk ka përmbajtje për-se. Në këtë rast është e domosdoshme që _____ ta mbajë në përdorim, por nuk ka kuptim të krijohet përmbajtje vetëm për atë. Përkufizimi i “vendosjes në përdorim” është i domosdoshëm edhe për të eliminuar abuzimet nga krahu tjetër. Është relativisht e thjeshtë të krijohet një landing page nominale për të justifikuar bllokimin e një domain të caktuar.

Lidhur me shtimin e dispozites kalimtare (Neni 38), kompania e vlerëson të nevojshme propozimin e AKEP për regjistrimin e emrave domainesh nën .al që kanë të njëjtin emërtim me emrat me të cilën një subjekt njihet për shkak të aktivitetit që kryen. Një praktikë e tillë është ndjekur dhe në Bashkimin Europian, dhe më specifikisht, në Rregulloren e KE-së Nr.874/2004, në nenin 10 pikat 1 dhe 2 u njihet kjo e drejtë subjekteve për regjistrimin e emrit tregtar si emër domaini, siç citohet dhe më poshtë:

Article 10: Eligible parties and the names they can register:

Holders of prior rights recognized or established by national and/or Community law and public bodies shall be eligible to apply to register domain names during a period of phased registration before general registration of eu domain starts.

'Prior rights' shall be understood to include, inter alia, registered national and community trademarks, geographic indications or designations of origin, and, in as far as they are protected under national law in the Member-State where they are held: unregistered trademarks, trade names, business identifiers, company names, family names, and distinctive titles of protected literary and artistic works.

'Public bodies' shall include: institutions and bodies of the Community, national and local governments, governmental bodies, authorities, organizations and bodies governed by public law, and international and intergovernmental organizations.

2. The registration on the basis of a prior right shall consist of the registration of the complete name for which the prior right exists, as written in the documentation which proves that such a right exists.

Gjithashtu, në nenin 12, pika 2 në Rregulloren e KE-së Nr.874/2004 është përcaktuar dhe një periudhë prej 4 muajsh duke i dhënë prioritet regjistrimit të emrave tregtar si emër domainesh për këto subjekte brenda kësaj periudhe. Ndaj dhe në këtë këndvështrim është i mirëpritur nga ana jonë propozimi i një pike të veçante (Aneksi 2 "Lista e Emrave të rezervuar") për krijimin e një liste me domainet e rezervuar të emrave të domaineve që korrespondon me emrin tregtar të subjektit, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Gjithashtu nga ana jonë për këtë çështje lind pyetja se çfarë do të ndodhë me domainet e regjistruara tashmë nga palë të treta, megjithëse prekin të drejtat e markave të regjistruara, edhe nëse janë vendosur në përdorim. Këtu sjellim si shëmbull rastin e domain-it _____ .al që është i bllokuar prej vitesh.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP vëren se të gjitha komentet dhe qëndrimet janë paraqitur vetëm nga Regjistruesit e domaineve .al dhe nuk ka komente nga institucione, individë, biznese, etj, të interesuara në këtë proces. Shumica e pretendimeve dhe komenteve të Regjistruesve nuk justifikojnë faktin

pse kanë kaq shumë domaine në pronësi të tyre si dhe nuk mundet që me komentet e tyre ata të përfaqësojnë të gjitha palët e interesuara për posedimin domainesh .al.

Bazuar në faktet që:

- Rreth 28 % e domaineve .al janë në posedim nga vetë Regjistruesit e domainit .al dhe në shumë pretendime të Regjistruesve, ata kryesisht mbrojnë veten e tyre pasi janë posedues të shumë domaineve .al;
- Shumë ankesa të paraqitura në AKEP kanë paraqitur shqetësimin që nuk marrin dot një emër domain .al për shkak se pas kërkimit ju rezulton i zënë dhe nuk kanë dijeni nga kush është zënë domain i kërkuar dhe kur mund të jetë i lirë;
- Shumë subjekte nuk kanë pasur dijeni në momentin e regjistrimit në QKB, DPPI, etj, që mundeshin të merrnin emrin e domainit .al të njëjtë me emrin e subjektit/markës/patentës etj;
- Janë paraqitur në AKEP edhe raste të domaineve me të cilat është tentuar të kryhet “tregti” pra kalimi në posedim nga një posedues tek një tjetër, në shifra shumë të larta dhe të palogjikshme, praktika të cilat i mbajnë të bllokuara emrat e domaineve .al të cilat korrespondojnë me emra subjektësh/markash/patentash të regjistruara;
- Rregullorja Nr. 2 dhe ndryshimet e saj janë kryer deri në vitin 2014 dhe nga kjo kohë shumë subjekte/marka/patenta të regjistruara pas këtij viti nuk e kanë pasur të mundur të kenë një domain .al .al të njëjtë me emrin e subjektit/markës/patentës etj;

Të gjitha faktet më sipër, AKEP i ka trajtuar me ndërhyrjet e duhura në Rregulloren nr. 2 të trajtuara dhe të sqaruara në këtë dokument.

Gjithashtu:

Regjistrimi i emrave të domaineve që kanë të njëjtin emërtim me emrat me të cilën një subjekt njihet për shkak të aktivitetit që kryen, është një praktikë e ndjekur edhe në Bashkimin Europian, dhe më specifikisht, në Rregulloren e KE-së Nr.874/2004, në nenin 10, pikat 1 dhe 2 u njihet kjo e drejtë subjekteve për regjistrimin e emrit tregtar si emër domaini.

Pjesë e Vendimit të miratimit të ndryshimeve në Rregulloren Nr.2, kishte propozuar në konsultimin publik, që AKEP mund të aplikojë një periudhë kalimtare prej 4 muajsh si “*sunrise period*” për t’iu mundësuar subjekteve të drejtën për të regjistruar si emra domaini nën .al, emra me të cilët njihen për shkak të veprimtarisë që ushtrojnë sipas regjistrimit të kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi në zyra, Institucione, Autoritete, të tilla si në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), apo regjistrimeve të kryera për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, apo emra të përveçëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar periudhës nga momenti i publikimit të dokumentit të konsultimit publik, konsultimeve me palët, takimeve me palët e interesuara, etj, AKEP e quan të ezauruar afatin e propozuar për periudhën kalimtare prandaj nuk do të vendosë një periudhë tjetër kalimtare (Sunrise Period) në Rregulloren nr. 2.

3. Neni 38 “Dispozitë përfundimtare”, riformulohet:

Kjo Rregullore hyn në fuqi sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP që miratojnë këtë rregullore dhe ndryshimet e saj.

Komentet dhe kërkesat e regjistruarve të domaineve .al, janë që lista e domaineve të rezervuar të hartohet dhe publikohet nga AKEP.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP shprehet do të miratojë dhe publikojë listën e emrave të rezervuar, të paktën 1 (një) herë në vit.

Çështja e shtatë: Shqyrtimi i mundësisë për trajtimin nga AKEP të mosmarrveshjeve që lindin në lidhje me regjistrimin, kalimin e posedimit, cregjistrimin/mbylljen, etj, të domaineve .al.

Nisur nga ankesat dhe problematikat e sjella në AKEP nga kërkues apo posedues të domaineve .al dhe nëndomaineve, AKEP mendon se është i nevojshëm përpilimi i një Aneksi të veçantë në Rregulloren Nr.2, ose zgjerimi i nenit 27 aktual të Rregullores Nr. 2, për zgjidhjen e mosmarrveshjeve duke sqaruar se AKEP ka të drejtë të zgjidhë mosmarrveshje kur këto kanë të bëjnë me rregullat e nxjerra nga AKEP, ndërsa mosmarrveshjet për çështje të tjera palët mund t'i drejtohen organeve të tjera kompetente.

Sa më sipër, meqënëse:

- në Ligjin 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nuk ka përcaktime për rastin e mosmarrveshjeve që lindin në lidhje domainet .al;
- Në procesin e mosmarrveshjeve duhet të përfshihen edhe përcaktime të Ligjit Nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar;
- Në procesin e mosmarrveshjeve duhet të përfshihen edhe përcaktime të Ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”;
- Në procesin e mosmarrveshjeve duhet të përfshihen edhe përcaktime të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar;
- Në procesin e mosmarrveshjeve duhet të përfshihen edhe përcaktime të Ligjit Nr. 119/2017 “Për të drejtën e informimit”,
- Në procesin e mosmarrveshjeve duhet të përfshihen edhe përcaktime të pronësisë industriale siç janë: Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar; Ligji Nr. 8993, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” - hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Qershor 1992 . Konventa e Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale”, e miratuar në Paris më 20 Mars 1883-hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995. Ligje të tjera aderimesh në konventa të ndryshme ndërkombëtare, etj. Referenca www.dppm.gov.al.
- Ligje të tjera referuese,

Qëndrim 1:

Lidhur me mundësinë e zgjerimit të nenit 27 të Rregullores për zgjidhjen e mosmarrveshjeve, duke përfshirë në këtë proces dhe përcaktime të ligjeve të tjera sic

propozohet nga AKEP kompania jonë shpreh dakortësinë për mundësinë e zgjerimit të këtij neni për të adresuar në mënyrë sa më të saktë këtë proces, duke rritur në këtë mënyrë dhe sigurinë juridike në mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që mund të jenë palë në mosmarrëveshje në lidhje me regjistrimin, kalimin e posedimit, çregjistrimin/mbylljen, etj, të domaineve .al. Në këtë kontekst, përveç zgjerimit dhe përfshirjes së kuadrit ligjor vendas, kompania jonë sugjeron që të reflektohet në këtë propozim dhe Rregullorja e Komisionit Europian Nr.874/2004, Kapitulli VI "Revokimi dhe zgjidhja e konflikteve", nenet 20, 21 dhe 22 të saj në lidhje me trajtimin e mosmarrëveshjeve për shkak të rrethanave të ndryshme siç janë: pagesat e pashlyera që bëhen shkak për revokim të domaineve, apo mospërbushja e kriteve për regjistrim domain (neni 20 i EU Regulation No.874/2004), apo regjistrimeve abusive dhe spekulative (Neni 21 i EU Regulation No.874/2004), si dhe mekanizmi për zgjidhjen e këtyre problematike (Neni 22 "Procedura Alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve").

Qëndrim nr. 2, 3, 4 dhe 5:

Në lidhje me propozimin e paraqitur në konsultimin publik për mundësinë e trajtimit nga AKEP të mosmarrëveshjeve që lindin në lidhje me regjistrimin, kalimin e posedimit, çregjistrimin/mbylljen, etj, të domaineve .al. jemi të mendimit se:

1. Pothuaj të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me domainet janë të lidhura me të drejtën e pronësisë duke iu referuar të drejtave që kanë palët mbi markat e rregjistruara, pronësinë intelektuale ose emrin me të cilin është rregjistruar ose njihet biznesi i tyre.

Në këtë kontekst zgjidhja e këtyre mos marrëveshjeve kërkon njohuri të zgjeruara të jurisprudence mbi legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar që rregullon të disa aspekte të së drejtës si psh. Të drejtën mbi pronësinë intelektuale, mbrojtjen e konsumatorit, procedurat e administrative etj...Për më tepër gjykimi i të drejtës është një proces që përveç eksperiencës duhet të mundësojë edhe mekanizmat e ankimit ndaj vendimit në shkallë të tjera gjykimi (prandaj edhe sistemi gjyqësor ka disa shkallë gjykimi)

2. Kushtetuta e RSH: Në nenin 41 pika 1 dhe 2 të saj përcakton se:

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyre tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

Në nenin 42 pika 1 përcakton se

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Në këtë kontekst, domain-i përfaqëson një pronë private të pëfituar me blerje dhe nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Në RSH ky proces zhvillohet vetëm në gjykatat e përacktura me ligj. AKEP nuk mund të marrë me rregullore të miratuar nga vetë AKEP të drejta që Kushtetuta ia njeh të tjera organizatave.

3. Internet Engineering Task Force (IETF) është trupa e parë e standardeve të Internetit e cila zhvillon standardet Requests for Comments (RFC) - një seri dokumentash teknike që përmbajnë të dhëna e rekomandime për Intemetin - nëpërmjet proceseve të hapura.

Në RFC 1591, Domain Name System Structure and Delegation - të pranuar nga ICANN dhe WIPO - në pikën 4, Emrat dhe Markat tregtare, thonë:

4- Në rast mosmarrëveshjeje midis regjistruesve të emrave të domain-it sa i përket të drejtave të një emri të caktuar, autoriteti i regjistrimit nuk do të ketë rol ose përgjegjësi tjetër përveçse për të siguruar informacionin e kontaktit për të dyja palët.

Regjistrimi i një emri domain nuk ka ndonjë status të markës tregtare. Është në dorën e kërkuesit të jetë i sigurtë se ai nuk po shkel Marken e tjetrit. Në RFC 3071, Reflections on the DNS and RFC 1591, pika 5, Roli i qeverive, përcaktohet se:

5- Nëse është e mundur, mos u përfshini kurrë në mosmarrëveshje brenda vendit.

Përkundrazi, më shumë nxitni palët e brendshme që të zgjidhin problemet midis tyre. Për më tepër, miratoni një rol si ndërmjetës dhe edukator, në vend që të gjykoni, nëse abuzimet nuk janë shumë të qarta dhe në mënyre të qartë nuk do të zgjidhet nga ndonjë mekanizëm i brendshëm.

4. Rregullorja Nr. 02 datë 21.02.2008 PËR" Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al", e ndryshuar, në Nenin 27-të ka të përcaktuar qartë mënyrën se si veprohet në rast mosmarrëveshje ose konflikti të lindur midis një poseduesi dhe çdo pale tjetër të interesuar direkt ose indirekt, që lidhet me regjistrimin e një emri domeni. Sipas Rregullores, për zgjidhjen e tyre, pala kërkuese do të veprojë duke iu drejtuar njerës prej zgjidhjeve alternative të parashikuara në legjislacionin shqiptar në fuqi:

- a) Çdo gjykatë e rrethit gjyqësor sipas ligjit "Për organizimin e sistemit gjyqësor ose;
- b) (çdo formë Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi të rregulluar me ligj në Republikën e Shqipërisë
- c) World Intellectual Property Organization -WIPO- (Arbitration and Mediation Center).

Bazuar në argumentat e parashtruar mësipër si dhe duke ju referuar dokumentave të mëposhtem,

Internet Corporation for Assigned Names and Numbers Authority:

- Internet Domain Name System Structure and Delegation (ccTLD Administration and Delegation)

- User Documentation on Delegating and Redelegating a Country-Code Top-Level Domain (ccTLD)

2. Internet Engineering Task Force (IETF)

- RFC 1591, Domain Name System Structure and Delegation RFC 3071, Reflections on the DNS and RFC 1591

3. Directive 2002/22/EC of the European Parliament and of the Council of 7 March 2002 on universal service and users rights relating to electronic communications networks and services (Universal Service Directive)

4. COM(2000) 421 final COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL INTERNET DOMAIN NAME SYSTEM CREATING THE .EU TOP LEVEL DOMAIN CELEX_52000DC0421_EN_TXT

5. REGULATION (EC) No 733/2002 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 22 April 2002 on the implementation of the .eu Top Level Domain CELEX_32002R0733_EN_TXT

6. COMMISSION REGULATION (EC) No 874/2004 of 28 April 2004 laying down public policy rules concerning the implementation and functions of the .eu Top Level Domain and the principles governing registration: CELEX_32004R0874_EN_TXT

7. European Commission: Public consultation on the evaluation and revision of the .eu top-level domain regulations, 12 May 2017 - 4 August 2017.

8. ITU- Policy, Business, Technical and Operational Considerations for the Management of a country code Top Level Domain (ccTLD)

9. CENTR position on the use of country and territory names as TLDs, Brussels, Belgium 6 October 2017

10. CENTER VZW Internal Procedural Rules 20171009 Centr policy position development rules-20150303

11. WIPO Guide to the Uniform Domain Name Dispute Resolution Policy (UDRP)

12. WIPO-Dispute Policies and Procedural Rules for ccTLDs

Jemi të mendimit se:

1. Rregullorja Nr. 02 datë 21.02.2008 PËR" Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al", e ndryshuar, në Nenin 27-të ka të përcaktuar qartë mënyrën se si veprohet në rast

mosmarrëveshje ose konflikti të lindur midis një poseduesi dhe çdo pale tjetër të interesuar direkt ose indirekt, që lidhet me regjistrimin e një emri domeni.

2. I vetmi rast në të cilin AKEP, mund të përfshihej, do të ishte nëse konflikti do të bazohej mbi pasaktesinë/mangësinë e sistemit të regjistrimit ccTLD .al të AKEP. Deri më sot nuk është identifikuar ndonjë rast i tillë. Për rrjedhojë, nuk ekziston bazë e arsyshme për ngritjen e Grupit të Punës të zgjeruar me përberje nga stafi i AKEP, nga Institucionet që preken nga legjislacioni i mësipërm, etj, për të adresuar dhe përcaktuar sa më saktë ndërhyrjet e nevojshme në Rregulloren, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes kërkuarit të një domaini .al dhe Regjistruesit si dhe poseduesit të një domaini .al dhe Regjistruesit.

Qëndrim nr. 6

Lidhur me propozimet për mundësinë e trajtimit nga AKEP të mosmarrëveshjeve që lindin në lidhje me regjistrimin, ndryshimin e posedimit, regjistrimin apo mbylljen, etj, e domeneve .al, theksojmë se për keto çështje EİPO dhe ICANN kanë rekomandime të qarta. Ato janë pasqyruar drejt në Rregulloren aktuale, e cila përcakton qartë se si veprohet në rast mosmarrëveshjeje ose konflikti të lindur midis një poseduesi dhe çdo pale tjetër të interesuar drejtpërdrejt ose tërthorazi, lidhur me regjistrimin e një emri domeni. Sipas Rregullores, për zgjidhjen e tyre, pala kërkuar duhet të veprojë duke iu drejtuar njëris prej zgjidhjeve alternative të parashikuara në legjislacionin shqiptar në fuqi:

- a. Çdo formë Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi të rregulluar me ligj në Republikën e Shqipërisë.
- b. Politikës së Njesuar të Zgjidhjes së Kërkesave të Diskutueshme për Emra Domenesh (Uniform Domain Name Dispute Resolution Policy - UDRP) të World Intellectual Property Organization - WIPO (Arbitration and Mediation Center).
- c. Çdo gjykatë rrethi gjyqësor sipas ligjit "Për organizimin e sistemit gjyqësor". Mendojmë se marrja përsiper nga AKEP (Rregullator, Regjister, Regjistrues dhe Gjykatës) e zgjidhjes në rrugë administrative të mosmarrëveshjeve, rrit pasigurinë ligjore dhe frenon zhvillimin dhe shtrirjen e tregut të domeneve .al.

Meqënëse zgjidhjet gjyqësore janë të shtrenjta dhe kërkojnë shumë kohë, mbështetur edhe në eksperiencën botërore, Rregullorja duhet të tërheqë vëmendjen dhe të nxisë përdorimin me përparësi të negociimit, ndërmjetësimit dhe arbitrazhit. Organizimi nga AKEP i veprimtarive periodike të ndërgjegjësimit dhe të edukimit lidhur me to është i mirëpritur. Nëse është e nevojshme. AKEP duhet të nxisë propozojë, së bashku me organet përkatëse shtetërore, ndryshime ligjore që (çojnë edhe në krijimin e një institucioni arbitrazhi të specializuar për çështjet e qeverisjes së Internetit, që përfshin natyrshëm edhe problemet e DNS në zonën .al. Publikimi në faqen e AKEP i listës së arbitrave dhe/ose i adresës së institucionit të tyre, mund të ishte një ndihmë për subjektet në nevojë.

Ndoshta, i vetmi vendim i Regjistrorit (AKEP) mbi bazën e një gjykimi administrativ mund të ishte rasti kur konstatohet se dikush ka regjistruar/mban/përdor një domen me emrin e plotë (emër e mbiemër) të një individi tjetër, dhe kur veprimi për bllokimin e domenit duhet të jetë i menjëhershëm, derisa, brenda një kohe të arsyeshme (që duhet gjykuar), i dëmtuari të mund të nisë një nga rrugët e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të cituara më lart, ose të jetë marrë një vendim përfundimtar në lidhje me çështjen.

Qëndrim 7:

Pika 7 faqe 13-14 Nisur nga ankesat dhe problematikat e sjella në AKEP nga kërkuar apo posedues domaineve .al dhe nëndomaineve, AKEP mendon se është i nevojshëm përpilimi i një Aneksi të veçantë në Rregulloren Nr.2, ose zgjerimi i nenit 27 aktual të Rregullores Nr 2, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke sqaruar se AKEP ka të drejtë të zgjidhe mosmarrëveshje kur këto kanë të bëjnë me rregullat e nxjerra nga AKEP, ndërsa

mosmarrëveshjet për çështje të tjera pa mund ti drejtohen organeve të tjera kompetente. Në bazë të Kodit të Procedurave Administrative AKEP nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë. Kjo kompetencë mund të ushtrohet nga një organ epror i AKEP nuk ekziston dhe për pasojë në rast e ka mosmarrëveshje për akte të nxjerra nga AKEP atëhere kompetente është gjykata administrative. Nga ana tjetër edhe vetë ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", në nenin 8 e tij që përcakton kompetencat e AKEP nuk e ka të parashikuar një kompetencë të tillë. Ndarja që bëhet në mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me rregullat e AKEP dhe mosmarrëveshje për çështje të tjera është një ndarje artificiale e cila është gjithashtu e pazbatueshme në praktikë. Është vështirë të kuptohen fjalët rregullat e nxjerra nga AKEP. përse kohë parashikohet që edhe vendimmarrjet e AKEP do të bazohen gjithnjë në dokumente të nxjerra nga institucione të tjera.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP mirëpret komentet dhe sugjerimet e paraqitura, dhe do të aplikojë rregullimet e mëposhtme në disa nene të Rregullores Nr. 2:

Neni 2 Objekti (Ndryshon dhe bëhet)

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për regjistrimin, përdorimin, shqyrtimin e ankesave dhe administrimin nga AKEP si autoriteti përgjegjës, i emrave të domain cc.TLD.al, nëndomain-et .gov, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, .net.al si dhe DNS (Domain Name System).

Neni 11 Të drejtat mbi emrin e domain-it (Pika 11.4 ndryshon dhe bëhet)

11.4 AKEP, me vendim të Këshillit Drejtues, ka të drejtë t'i heqi poseduesit të drejtat mbi emrin e domain-it, pa kompesim, kur:

- a) Mbi bazën e një procedure administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, të filluar me kërkesën e një pale të interesuar ose kryesisht nga vetë AKEP, vërtetohet cënimi i mirëbesimit të dhënë mbi bazën e parimit të "Vetëdeklarimit" lidhur me vërtetësinë, saktësinë, autenticitetin dhe ligjshmërinë e të dhënave të paraqitura nga aplikuesi në formularët përkatës;
- b) Vërtetohet përdorimi i emrit të domain, në kundërshtim me qëllimin dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore;
- c) Emri përkatës pengon procesin e rinovimit të listës së "emrave bazë" (emra të ndaluar dhe të kufizuar).

Në rastet sipa germës c), për heqjen e së drejtës mbi emrin e domain-it, poseduesi njoftohet paraprakisht jo më pak se 3 tre muaj përpara. Kjo kohë është e nevojshme për t'i dhënë mundësi poseduesit për zgjedhjen enjë emri tjetër domain-i dhe sigurimin e një tranzicioni normal.

Neni 24 Pezullimi i veprimeve (Pika 24.1 ndryshon dhe bëhet)

24.1 Pezullimi, vendoset mbi veprimet (psh modifikimi, transferimi, etj) e Autoritetit Përgjegjës për një emër domain-i sipas rasteve të përcaktuara më poshtë, por pa u kufizuar në to:

- a) Në rastin e procedurës administrative, të filluar nga AKEP sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë rregullore ose të një vendimi të Këshillit Drejtues të AKEP në përfundim të shqyrtimi të një ankimi administrativ;
- b) Në rastin e një urdhëri lëshuar nga gjykata për pezullimin e veprimeve, mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me autoritetin e vendimit përfundimtar siç është parashikuar në nenin që lidhet me transferimin e detyruar, ose transferimin e të drejtës së pronësisë;
- c) Në pritje të vendimit të arbitrazhit mbi konfliktin përkatës, nëse kërkuesi i është drejtuar kësaj alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 25

Bllokimi i një emri domain-i

(Pas germës d) të pikës 25.1 shtohet germa dh) me këtë përmbajtje)

- dh) Në rastin e një vendimi të arsyetuar të Këshillit Drejtues të AKEP, në përfundim të një procedure administrative ose shqyrtimi të një ankimi administrative, sipas pikës 11.4 a) dhe 11.4) të kësaj rregulloreje.

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

(Ndryshon dhe bëhet)

27.1 Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes/ve së lindur midis një poseduesi dhe çdo pale tjetër të interesuar mbi ushtrimin e të drejtave të fituara sipas kësaj rregullore për regjistrimin dhe përdorimin e një emri domain-i, për çështje që nuk përbëjnë objekt ankimi administrativ në AKEP, palët kanë të drejtë të veprojnë duke iu drejtuar njerës prej zgjidhjeve alternative të parashikuara në legjislacionin shqiptar në fuqi:

- a) shqyrtimit gjyqësor nga gjykata kompetente;
- b) çdo forme Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi vendor ose ndërkombëtar si WIPO – World Intellectual Property Organization (Arbitration and Mediation Center).

27.2 Në rastet e investimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes/ve sipas pikës 27.1, pala paditëse/kërkuese njofton me shkrim AKEP për fillim e procesit si dhe objektin e padisë/kërkimit.

Neni 27/1

Ankimi administrativ

(Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje)

27/1.1 Kur një palë e interesuar, pretendon se nga një posedues ose regjistruar sipas kësaj rregulloreje, i është cënuar e drejta e regjistrimit dhe posedimit të një emri domain-i, ka të drejtë të paraqesi ankimi administrativ në Këshillin Drejtues të AKEP sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.

27/1.2 Përbëjnë objekt ankimi administrativ në Këshillin Drejtues të AKEP, rastet kur pretendohet:

- a) cënimi i mirëbesimit të dhënë mbi bazën e parimit të “Vetëdeklarimit” lidhur me vërtetësinë, saktësinë, autenticitetin dhe ligjshmërinë e të dhënave të paraqitura nga poseduesi në formularin përkatës të aplikimit;

- b) përdorimi i emrit të domain, në kundërshtim me qëllimin dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.

27/13 Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP mbi ankimin administrativ është i ankimueshëm në rrugë gjyqësore sipas ligjit nr. 49/2012 për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative (i ndryshuar).

Çështja e tetë: Shyrtimi i afateve për regjistrimin e domaineve .al, nga AKEP dhe nga Regjistruesit, shqyrtimi i afatit të përdorimit të domaineve si dhe afatit të vendosjes në punë/përdorim të një domaini .al dhe nëndomaineve.

AKEP gjykon se është shumë e rëndësishme vendosja e afateve për veprimet me domainet nën .al të tilla si regjistrimi, modifikimi, transferimi, mbyllja, etj.

Sa më sipër, AKEP kërkon mendimin tuaj për propozimet e mëposhtme:

1. Propozohet që në Rregulloren Nr. 2/2008 të ndryshuar, të shtohet Neni 4/1 me përmbajtje:

Neni 4/1 “Afatet e veprimeve me domainet .al”:

- a. Afati për regjistrimin e domain .al dhe nëndomaineve, nga AKEP dhe Regjistruesit, është 2 ditë pune nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit. Paraqitja e një formulari jo të plotësuar saktë, nuk ja heq të drejtën për emrin e domainit aplikuesit si dhe asnjë aplikues tjetër nuk ka të drejtë të marrë këtë domain gjatë kohës që aplikuesi i parë riplotëson/korrigjon të dhënat në formularin e parë. Koha për riplotësimin/korrigjimin e formularit është 2 ditë pune dhe lejohet riplotësim/korrigjim, vetëm 1 (një herë). Me kalimin e këtij afati të dytë, në rast mos riplotësimi/korrigjimi nga aplikuesi i parë, aplikues të tjerë mund të aplikojnë për atë emër domaini, me të njëjtën procedurë.

Qëndrim nr. 1:

Nëse afati për regjistrimin e domain.al dhe nëndomaineve do të jetë 2 ditë pune, atëhere procesi do të konvertohet plotësisht në manual pasi implikon më së shumti procesin e pagesave nga ana e klientit. Nëse klienti futet në sistem, kryen pagesën dhe merr shërbimin mbas dy ditësh, ky nuk është më proces automatik provizionimi. Nëse AKEP kërkon dy ditë kohë për aktivizimin e një domain të ri atëhere ne si regjistrues do kemi implikime serioze në lidhje me procesimin e pagesës së klientit. Ky element merr rëndësi të madhe veçanërisht në rastin kur AKEP do të refuzojë aplikimin dhe regjistruesi do duhet t'i kthejë pagesën klientit.

Qëndrimi i AKEP:

Kur kërkohet të regjistrohet një domain .al, kërkuesi në fillim bën kërkim me anën e motorit të kërkimit në faqen web të AKEP ose regjistruesve, nëse domaini i kërkuar prej tij është i lirë dhe nëse po, vazhdon aplikimin. Për analogji me ndryshimet në pikën 7.1 të nenit 7, të Rregullores Nr. 2 si dhe për t’ju përgjigjur shqetësimit për afatin e pagesës, AKEP ndryshon afatin e propozuar në konsultim, nga “2 ditë pune” në “deri 3 ditë pune”.

Shtohet Neni 4/1 “Afatet e veprimeve me domainet .al” dhe pika a) bëhet si më poshtë:

a) Afati për regjistrimin e domain .al (dhe nëndomaineve), nga AKEP dhe Regjistruesit, është *deri 3 ditë pune* nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit. Paraqitja e një formulari jo të plotësuar saktë, nuk ja heq të drejtën për emrin e domainit aplikuesit si dhe asnjë aplikues tjetër nuk ka të drejtë të marrë këtë domain gjatë kohës që aplikuesi i parë riplotëson/korrigjon të dhënat në formularin e parë. Koha për riplotësimin/korrigjimin e formularit është deri 3 ditë pune dhe lejohet riplotësim/korrigjim, vetëm 1 (një) herë. Në rast se brenda këtij afati aplikuesi i parë, nuk riplotëson/korrigjon të dhënat, domaini i kërkuar konsiderohet i lirë dhe aplikues të tjerë mund të aplikojnë për atë emër domaini, me të njëjtën procedurë.

Për analogji me qëllim që të kemi afat të qartë edhe në rastet e modifikimeve/transferimeve/mbylljeve të domaineve nën .al dhe nëndomaineve, shtohet në nenin 4/1 edhe pika b) si më poshtë:

b) Afati për modifikimin/transferimin/mbylljen e domainit .al (dhe nëndomaineve), nga AKEP dhe Regjistruesit, është 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit.

Afati i vendosjes në punë është sqaruar me ndrvrhyrjet në pikën 7.1 b) të nenit 7 të Rregullores Nr. 2.

Qëndrim nr. 1:

Afati 6 mujor bie në kundërshtim me afatin 3 deri në 6 muaj të referuar me përcaktime të tjera të draft rregullores. Gjithsesi regjistruesi mbetet i mendimit se afati për vënien në punë të një domaini duhet të jetë 1 vit nga data e regjistrimit apo nga data e rinovimit. Ndërkohë, regjistruesi kërkon të plotësohet dhe të qartësohet ky përcaktim në lidhje me afatin 5 vjeçar nga data e rinovimit të afatit të vlefshmërisë pasi konfuzon procesin, pra nëse afati i vlefshmërisë së domainit do të jetë 1 vit (sa çështe afati i kreditit) apo 5 vjet.

Qëndrim nr. 2:

Për sa i përket propozimit të AKEP lidhur me shtimin e nenit 4/1 "Afatet e veprimeve me domainet.al", kompania jonë është dakort në parim, si dhe me pagesat që kryhen nga Regjistruesit në AKEP për emra domainesh në posedim të tyre, apo të pagesës për rinovim të afatit të vlefshmërisë për domain joaktiv. Gjithashtu, lidhur me pikën (e) të nenit 4/1 "Vënia në përdorim e domainit nën .al, nënkupton rastet kur domain përdoret për ëbsite aktive, emaile aktive,..." kompania jonë kërkon edhe për këtë pikë që të përkufizohet më qartë se çfarë do të thotë venie në përdorim e domainit nën .al.

Qëndrim nr. 3:

Lidhur me propozimet për "afatet e veprimeve me domenet .al" (Neni 4/1), nuk mund të mos na tërheqë vëmendjen fakti. që në vënd që të synohet në regjistrimin e menjëhershëm të domeneve nga Regjistri .al (AKEP), ndonëse janë të gjitha mundësite teknike për ta arritur këtë dhe kjo është praktikë e të gjitha ccTLD-ve të vëndeve me ekonomi tregu funksionale, Regjistrin tonë i duhen prapë 2 ditë (dhe në fundjavë edhe më shumë) për të bërë regjistrimin. Kjo mund të justifikohet me idenë se duhen kontrolluar listat me emrat e rezervuar e të ndaluar. Për, siç parashtrua më lart, nëse në sistemin e Regjistrin .al vihet kontrolli

automatik i emrave të rezervuara e të ndaluara, nuk ka mundësi të regjistrohet ndonjë domen i tillë, për rrjedhojë, nuk ekziston as nevoja për kohëzgjatjen e kërkuar për regjistrim. Regjistrimi i domaneve duhet të jetë i menjëhershëm.

Qëndrimi i AKEP:

Meqënëse në qëndrimet e AKEP më sipër, pika 7.1 të nenit 7, të Rregullores Nr. 2 pësoi disa ndryshime ku përfshihet pranimi nga AKEP i ndryshimit të afatit të propozuar në konsultimin publik për vendosjen në punë të një domaini .al nga 6 muaj në 1 (një) vit, AKEP gjykon se përshkrimi në pikën c) të propozuar, është ezauruar në pikën 7.1 të nenit 7 të Rregullores nr. 2 të ndryshuar, prandaj nuk ka nevojë të jetë e shkruar dy herë në Rregulloren nr. 2.

Pikat a) dhe b) mbeten sipas propozimit të AKEP më sipër.

Gjithashtu, siç është shprehur më lart, AKEP do të publikojë listën e emrave të ndaluar dhe listen e emrave të rezervuar.

- c) Regjistruesit nuk kanë të drejtë të përdorin kreditet e tyre për emra domainesh në posedim të tyre. PAGESA për Regjistruesit (përfshijë AKEP) për emra në posedim të tyre është 5000 lekë/5 vjet. Regjistruesit (përfshijë AKEP) i nënshtrohen të njëjtave rregulla të pikave 1, 2 dhe 3 më sipër.

Qëndrim nr. 1:

Kjo pikë është penalizuese për regjistruesit dhe nuk ofron fleksibilitet. Megjithëse kjo është një mënyrë për të ndarë objektet e shërbimit, mbetet penalizuese për Regjistruesit të cilët nuk abuzojnë me faktin që i kanë parablerë 1000 kreditë domain-esh. Regjistrues 1 mendon se në këtë rast mund të shprehet se Rregjistruesi ka të drejtë të përdori deri në 15 kredite për qëllimet e veta. Në asnjë rast, Regjistrues 1 nuk pranon që Regjistruesit të kryejnë pagesa 5000 leke/5 vjet për domainet e regjistruara nga vetë këta të fundit pasi Regjistruesit tashmë paguajnë si për kreditet ashtu edhe për pagesën vjetore të Regjistrarit.

Qëndrimi i AKEP:

Në pikën 7.1 b) të nenit 7 më sipër, AKEP përcaktoi dhe rregulloi çështjen e numrit të domaneve për individë dhe subjekte/shoqëri/etj dhe ky numër është i njëjtë edhe për Regjistruesit, prandaj AKEP nuk do ta aplikojë pikën d) më lart të propozuar.

- d) Vendosje në punë/përdorim të domainit nën .al, nënkupton rastet kur domaini përdoret për website aktive, emaile aktive ose për qëllime teknike aktive si DNS, HTTP/HTTPS, FTP, SSH (Secure Shell), Peer to Peer, etj.

Meqënëse kjo pikë u ezaurua në pikën 7.1 të nenit 7 të Rregullores nr.2, AKEP heq pikën e) të propozuar për të mos pasur dublim në Rregullore.

- e) Shkelje e afateve të mësipërme nga Regjistruesit çon në revokimin e regjistrimit të tyre në AKEP.

Në takimin e organizuar në AKEP, pati mendime që AKEP të mos kryejë menjëherë çregjistrimin e regjistruesit, por të vendosë masa administrative gjoba për shkelje afatesh.

Qëndrimi i AKEP:

Meqenëse AKEP nuk ka reference ligjore për aplikimin e masave administrative në raste shkeljesh afatesh regjistrimi domaini .al nga regjistruesit, AKEP vendos në rregullore pikën f) të propozuar duke pranuar që nuk ka bazë ligjore për gjoba ndaj Regjistruesve për shkelje afatesh regjistrimi/modifikimi,/transferimi, etj, prandaj AKEP e riformulon pikën f), si më poshtë:

f) Shkeljet e përsëritura të afateve të mësipërme nga Regjistruesit, përbëjnë shkak për revokimin e regjistrimit në AKEP.

Në rast se do të ketë ndryshime ligjore që prekin dhe ccTLD .al, AKEP do të referojë në institucionet përkatëse, nevojën e përcaktimeve të tarifave apo gjobave që kanë të bëjnë me ccTLD .al.

Çështja e nëntë: Në lidhje me pagesat:

Në Rregulloren Nr.2, të ndryshuar, ne Aneksin Nr. 1, Tabela nr.3 përcaktohen:

Pagesat për regjistrimin e domain cc. TLD pranë AKEP:

- a. Vlera e regjistrimit, për çdo subjekt që kërkon të veprojë si regjistrues 20 000 Lekë (pagesë e cila kryhet vetëm një herë të vetme);
- b. Pagesa vjetore, që çdo subjekt i regjistruar duhet të depozitojë për AKEP në mënyrë që të veprojë si Regjistrues 100 000 Lekë;
- c. Çmimi i 1 (një) krediti për Regjistruesit është 300 lekë;
- d. Pagesa e rregjistrimit të domain pranë AKEP është 5000 lekë për 5 (pesë) vjet.

AKEP kërkoi mendime për propozimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3 f) të Aneksit 1 të Rregullores Nr. 2 përcaktohet që *“Regjistrimi dhe rinovimi i një domaini për një periudhë 1 (një) vjeçare do të ketë vlerën e 1 (një) krediti”*.

Sipas këtij përcaktimi, për çdo domain të regjistruar apo domain që rinovohet në afat, çdo vit Regjistruesit i zbritet një kredit nga kreditet e parablera në AKEP.

Sa më sipër, meqenëse krediti ka një çmim dhe një afat, AKEP shprehet për sqarimin e pikës c) të Tabelës Nr. 3 që përcakton pagesat.

Ishte:

Çmimi i 1 (një) krediti për Regjistruesit është 300 lekë.

të bëhet:

Çmimi i 1 (një) krediti për Regjistruesit është 300 lekë. Për çdo domain që regjistrohet dhe domain që rinovohet në afat, afati i vlefshmërisë së një krediti do të jetë 1 vit nga data e regjistrimit/rinovimit.

Qëndrim nr. 1:

Eshte e paqarte marredhenia ndermjet krediteve te cilat zbriten per cdo vit dhe vlefshmerise se domainit qe rinovohet cdo 5 vjet. AKEP duhet te qartesoje paraprakisht kete percaktim jo vetem ne pergjigje te komenteve te paleve por edhe ne riformulimin e ketij pecaktimi.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron qe domainet qe regjistrohen apo rinovohen direkt ne AKEP, kanë afat vlefshmërie 5 vjet, ndërsa propozimi i mësipërm është për sqarimin e çmimit të një krediti për regjistrim dhe rinovim domaini .al nga Regjistruesit e regjistruar në AKEP që regjistrojne domaine .al. Gjithashtu AKEP i qëndron propozimit me qëllim që të sqarojë më shumë pikën c) të Tabelës Nr. 3, si më poshtë:

Çmimi i 1 (një) krediti për Regjistruesit është 300 lekë. Për çdo domain .al që regjistrohet dhe domain .al që rinovohet në afat, nga Regjistruesit, afati i vlefshmërisë së një krediti do të jetë 1 vit nga data e regjistrimit/rinovimit.

Çështja 10: Lidhur me shqetësimet e paraqitura në AKEP për tarifatat/çmimet e aplikuara nga Regjistruesit, apo tarifa/çmime nga individë që kanë marrë në posedim domaine të ndryshme .al, AKEP shtroi për konsultim publik diskutimin për mundësinë e vendosjes nga AKEP te çmimeve tavan për regjistrimin dhe veprimet e tjera me një domain nën '.al'. Ekzistojnë praktika të tilla edhe në vende të tjera ku domaini administrohet nga Autoritetet Rregullatore si përshembull Greqia, ku domain .gr administrohet nga Komisioni i Telekomunikacioneve dhe Postave të Greqisë (EETT) dhe në Rregulloren e EETT përcaktohen çmime tavan dhe tarifatat që përfiton EETT për çdo domain.

Qëndrim 1:

Kompania jonë gjykon se çmimet duhet të përcaktohen komercialisht nga vetë Regjistruesit. AKEP duhet të kujdeset që Regjistruesit të mos ofrojnë regjistrimin e domaineve me vlerë shërbimi më të ulët se tarifa e kreditit që paguajnë në AKEP për çdo domain të regjistruar.

Qëndrim 2:

Referuar normativës përkatëse të kuadrit rregullator europian, në nenin 4, pika 2, gërma c, të Rregullores së KE-së Nr.733/2002" përcaktohet qartë që autoriteti përkatës vendos tarifatat në përputhje me kostot që manifeston subjekti. Po ashtu në nenin 4 të Rregullores së BE-së Nr. 874/2004, në nenin 4 "Akreditimi i regjistrareve", citohet se: The Registry may ask registrars for advance payment of registration fees, to be set annually by Registry based on a reasonable market estimate"

Ndaj dhe pagesa e një krediti për regjistruesit prej 300 lekësh (siç është dhe aktualisht) duhet të ketë një referim apo një evidencë të kostove që manifeston regjistruesi në mënyrë që të shërbejë si bazë për llogaritjen e vlerës për pagesën e një krediti, siç parashikohet dhe në rregulloren e BE-së Nr. 874/2004 neni 4: The Registry may ask registrars for advance payment of registration fees, to be set annually by Registry based on a reasonable market estimate" kompania jonë shprehet dakort me propozimin e AKEP për përcaktimin e çmimeve tavan nga AKEP për regjistrimin dhe veprimet e tjera me domainet, pasi në këtë mënyrë evitohen abuzimet në lidhje me tarifatat e aplikuara nga Regjistruesit dhe adresohen

shqetësimet e paraqitura për keto tarifa në AKEP. Siç është evidentuar dhe në këtë dokument nga AKEP praktika të tilla janë ndjekur dhe në vende të tjera si në Greqi, ku autoriteti rregullator EETT në Rregulloren përkatëse për administrimin e domaineve, në një aneks të veçantë përcakton dhe çmimet maksimale që aplikuesit e ndryshëm duhet t'u paguajë Regjistrueve për veprimet me domainet.

Qëndrim 3, 4, 5:

1. Ndryshimi i propozuar nga AKEP për sqarimin e pikës c) të Tabelës Nr. 3 që përcakton pagesat, siç sqarohet edhe në materialin e paraqitur për këshillim publik, është në funksion të ruajtjes së konsistencës së shprehjes përgjatë të gjithë Rregullores Nr.2 dhe Anekseve përkatëse.

2. Lidhur me propozimin e paraqitur nga AKEP për konsultim publik mbi shqyrtimin e mundësisë për vendosjen e çmimeve tavan jemi të mendimit se:

Rregjistrimi i Domaineve i Referuar 'Ëikipedia': "Çmimi tavan është një kontroll ose kufizim i çmimeve vendoset nga qeveria që përcakton kufirin e sipërm të çmimit që mund të vendoset për një produkt. Qeveritë përdorin çmimet tavan për të mbrojtur konsumatorët nga kushtet që mund t'i bëjnë mallrat të shumë të shtrenjta. Kushte të tilla mund të ndodhin gjatë periudhave të inflacionit të lartë, në rast të një flluske investimi ose në rast të pronësisë monopol të një produkti, të gjitha këto mund të shkaktojnë probleme nëse vendosen për një periudhë të gjatë pa racionime të kontrolluara, duke çuar në mungesa. Probleme të mëtejshme mund të ndodhin nëse qeveria vendos çmime tavan joreale, duke shkaktuar dështime të biznesit, rënie të aksioneve, madje edhe kriza ekonomike. Ekziston një literaturë e konsiderueshme shkencore e cila tregon se në disa rrethana vendosja e çmimeve tavan, paradoksalisht çon në çmime më të larta.

Referuar Investopedia: "Kontrolli i çmimeve janë detyrime ligjore të vendosur nga qeveria mbi çmimin minimal ose maksimal për mallra të caktuara, që zakonisht përdoret si një mjet për ndërhyrje të drejtpërdrejtë në ekonomi për të siguruar përballueshmërinë e mallrave të caktuara. Qeveritë më së shpeshti zbatojnë kontrollet e çmimeve në prodhime dhe artikuj thelbësorë si ushqimi ose produktet e energjisë. Si një masë rregullatore e qeverisë, kontrolli i çmimeve mund të miratohen me qëllime të mira, por në praktikë ato nuk japin rezultat. Asnjë përpjekje për kontrollin e çmimeve nuk mund të kapërcejë forcat themelore të ekonomisë: kërkesën dhe ofertën, për një kohe të konsiderueshme.

iii. Referuar literatures mbi ekuilibrin e çmimeve: "Ekulibri është gjendja në të cilën kërkesa dhe oferta në treg balancojnë njëra tjetrën dhe për pasojë çmimet janë të qëndrueshme. "Sipas Adam Smith". Tregu i lirë ka tendencë drejt ekulibrit. Për më tepër, çmimet e aplikuara nga Regjistruesit përgjatë 10 viteve të liberalizimit pothuaj kanë mbetuar të pandryshuara në vlerë nominale, çfarë për shkak të inflacionit dhe zhvillimeve të tjera në vlerë reale kanë pësuar rënie. iv. Rregjistrimi i domaineve, është vetëm një pjesë e biznesit në tregun e shërbimeve on-line. Janë të pakta rastet kur rregjistrimi i domain-it është transaksion unitar (dmth që bëhet vetëm rregjistrim domain-i). Zakonisht rregjistrimi i domain-it është pjesë e një pakete më të gjërë produktesh dhe shërbimesh që ofrohen nga Regjistruesit ose rishitësat e tyre. Nuk janë të pakta rastet kur vetë transaksioni i rregjistrimit të domain-it i ofrohet falas klientit si pjesë e produktit apo shërbimit që blen.

v. Mjeti më i mirë që njeh ekonomia e tregut të lire për rregullimin e çmimeve është liberalizimi duke lejuar çmimet të përcaktohen nga forcat kryesore të tregut: kërkesa dhe oferta.

i. Domain-i është një mall e pronësia mbi të cilin premtohet nga zotëruesi i tij nëpërmjet blerjes. Për rrjedhojë domain-i përfaqëson një pronë private të zotëruesit.

ii. Transferimi i domain-eve nga një zotërues tek një tjetër në shumicën e rasteve nuk përfaqëson vetëm kalimin e të drejtës së pronësisë mbi rekordin e rregjistrimit të domain-it. Ky transferim, nënkupton transferimin e të gjithë biznesit që është ngritur mbi domain-in që transferohet (ky biznes në rastin më të keq përfaqëson trafikun online që mund të sjellë ai domain ose rankimin që merr në motorët e kërkimit).

iii. Transferimi i domain-eve (kur nuk ka konflikt mbi pronësinë e domain-it) përfaqëson një transaksion tregtar midis dy subjekteve, të cilat kanë rënë dakort mbi vlerën e transaksionit dhe janë jashtë ndikimit apo kontrollit të Regjistruesve.

iv. Shembulli i sjellë është rasti i Greqisë. Është e vërtetë që në zonën .gr aplikohet një çmim tavan prej 44€. Pas interesimit tonë pranë partnerëve tanë (Regjistrues i Akredituar) në zonën .gr opinioni që na u percoll është se .gr nuk është Regjistri më i mirë për tu marrë shembull. Për më tepër, pavaresisht çmimit të aplikuar për rregjistrarët, çmimi i tregut për një domain .gr nuk është i kufizuar nga çmimi tavan. Një kërkim në scdo.com (faqe e specializuar në shit/blerjen e domaineve) tregon rezultatet e mëposhtme:

Domain çmimi:

greecehotels .gr € 35,000

greece24 .gr € 15,000

grazia .gr € 8,000

greenmarket .gr € 6,000

greenmap .gr € 3,000

greekcruises .gr € 2,350

grsektv .gr € 2,350

grecetoday .gr € 2,250

greececruises .gr € 1,750

Referuar argumentave të parashtruara në diskutimin e mësipërm jemi të mendimit se vendosja e çmimeve tavan në lidhje me transaksionet financiare mbi domain-et:

1. Nuk justifikohet nga gjendja e çmimeve apo kushtet e përgjithshme të tregut. Nuk është rasti që tregu ka kërkesë të lartë për regjistrim të domain-eve dhe çmimet që aplikohen nga Regjistruesit janë aq të larta sa nuk ju mundësojnë aplikanteve të rregjistrojnë domain-e. Sjellim në vëmendje se (çmimi mesatar për regjistrimin e një domain-i .al është pothuaj i njëjtë me çmimin e rregjistrimit të një domain-i .com).

2. Çmimi i transaksioni mbi domain-in (regjistrimi/transferimi) në pjesën më të madhe përveç çmimit të transaksionit në Regjister, reflekton një sërë produktesh apo shërbimesh të tjera që regjistruesi/rishitësi ose zotëruesi i domain-it i bashkangjit domain-it. Janë pikërisht sasia dhe cilësia e këtyre produkteve dhe shërbimeve shtesë të cilat dallojnë aktorët e tregut nga njëri-tjetri dhe sjellin në treg oferta të ndryshme çmimesh që plotësojnë nevojat e segmenteve të ndryshme të konsumatorëve.

3. Nuk është e mundur të aplikohet mbi transaksionet e transferimit të domain-eve. Praktika e paraqitur për zonën .gr është rasti më i mirë për të treguar se aplikimi i çmimeve tavan mbi transaksionet e transferimit të domaineve është një kufizim që nuk funksionon.

4. Tregu i regjistruesve të domain-eve .al është një treg i liberalizuar. Për rrjedhojë, ne vetë tregu i ka të gjitha mekanizmat dhe mundësitë për të vetë-rregulluar nivelin e çmimeve duke tentuar ekuilibrin e tyre.

5. AKEP nuk mund të përfshihet në një proces për vendosjen e çmimeve tavan, për sa kohë vetë AKEP është Regjistrues i domain-ve .al, pasi metodologjia për përcaktimin e këtij çmimi do të ishte e paragjykur që në nisje për shkak të konfliktit të interesit të AKEP.

Në përfundim, sugjerojmë që:

1. Të realizohet ndryshimi propozuar nga AKEP në për sqarimin e pikës c) të Tabelës Nr. 3 që përcakton pagesat.

2. Shqyrtimi i mundësisë për vendosjen e çmimeve tavan nga AKEP është i panevojshëm dhe për pasojë nuk duhet të merret në konsideratë.
3. AKEP duhet të shqyrtojë plotësimin e rregullores për pjesën që rregullon:
 - a. Falimentimin e Regjistruesve - çfarë ndodh me domain-et e regjistruara nga ky regjistrues? Si mbrohen konsumatorët në këtë rast?
 - b. Shkriren e Regjistruesve - Dy Regjistrues shkrijnë biznesin e tyre në një tatimpagues të vetëm? Cilat janë procedurat? Cilat janë tarifatat e transferimit të domain-eve nga Regjistruesi që shkrihet tek Regjistruesi që bën përthithjen?
 - c. Procedurat që ndiqen kur një Regjistrues e shet biznesin e regjistrimit të domain-eve.
4. AKEP duhet të rishikojë tarifën e akreditimit për regjistruesit e cila paguhet vetëm një herë. Jemi të mendimit që kjo tarifë duke qënë se mbulon kostot e proceseve shtesë për akreditimin fillestar të regjistruesit duhet të jetë më e lartë se tarifa vjetore që Regjistruesit e Akredituar paguajnë për të drejtën e Akreditimit. Për vitin e parë të regjistrimit të Regjistruesit të Akredituar tarifa e regjistrimit mund të përfshijë të dy tarifatat; Tarifën e regjistrimit fillestar-Tarifën e të drejtës për të vepruar si Regjistrues.
5. AKEP duhet të shikojë mundësinë se si një Regjistrues mund të rimbursohet për kreditin e harxhuar në regjistrimin e një domain-i në rast se klienti nuk bën pagesën. Duke qënë se një pjesë e mirë e transaksioneve për realizimin e pagesës nga subjektet aplikuese realizohen online, nuk është i rrallë rasti kur klienti bën pagesën, domain regjistrohet dhe pas një periudhe e cila mund të shkojë nga disa ditë në disa javë klienti e tërheq pagesën. Në këto raste Regjistruesi përveç kostove të tërheqjes së pagesës duhet të mbajë edhe kostot e regjistrimit të një domain-i të cilin nuk e ka shitur realisht.

Qëndrim 6:

Vendosja e propozuar e çmimeve tavan për domenet nga AKEP është kufizim i lirisë së veprimtarisë ekonomike të regjistruesve dhe cënim i konkurrencës së lirë në tregun e domeneve .al, gjë që është në kundërshtim me Nenin 11 të sipërcituar të Kushtetutës. Kjo përjasje nuk merr parasysh se:

- a. Kostot për domen të regjistruesve janë shumë të ndryshme, për rrjedhojë, normalisht, çmimet nuk mund të jenë të njëjta.
- b. Është tregu ai që përcakton çmimet.
- c. Janë konsumatorët ata që reagojnë (në treg) për çmimet. Shumë prej tyre mund të preferonin regjistruesin me çmimin më të lirë të një domeni, por ka mjaft edhe nga ata, veçanërisht firmat e huaja të specializuara në tregun e domeneve, që shohin e vlerësojnë shumë edhe reputacionin e regjistruesit, standardet etike, kulturore e profesionale të tij, shërbimet e kombinuara që ofron (p.sh. regjistrim markë + domen, ose hostim + regjistrim domeni etj.), konfidencialitetin, sigurinë etj. dhe për këtë janë gati të paguajnë më shumë, pa u joshur nga çmimi më i ulët. (çdo regjistrues në vendosjen e çmimit/ ve kostos që përbën pikënisjen, orientohet edhe nga fasha e tregut që synon. Pikërisht pse kostot, reputacioni dhe strategjitë e marketingut të regjistruesve janë të ndryshme, ata nuk kanë të njejtin çmim dhe sukses në treg. Por, është tregu ai që mund t'i lërë në treg ose t'i nxjerrë prej tij, jo Rregullatori ose Regjistri.
- d. Regjistruesit nuk mund të përballojnë ndryshimet e shpejta teknologjike në fushën e administrimit të domeneve, dhe konkurrencën e madhe në të, nëse nuk kanë mundësi për një akumulim kapitali relativisht të shpejtë për të investuar në modernizimin e sistemeve të tyre (veçanërisht te softëare-ve të menaxhimit, mbrojtjes etj.).

Vec kësaj:

- e. Duket sikur çmimet e domeneve janë të larta, por le të kujtojmë se më i larti i aplikuar nga regjistruesit, sipas materialit të AKEP për konsultim publik, është 30 Euro/vit (DIGICOM), ose 2.5 Euro/muaj, ose tre kafe/muaj, ose një kafe/10 dite. Zhurma që bëhet për këtë është e pabazë dhe mesa duket, kërkon të justifikojë e t'i hapë rrugë vendosjes arbitrare të çmimeve

në tregun e domeneve, gjë që do ta cënonte rëndë konkurrencën e ndershme në të dhe do t'i jepte AKEP-it (njëkohesisht Rregullator, Regjister, Regjistruer dhe Gjykatës) atributet e një fuqie absolute, objektivisht arbitrare.

f. Nuk parashtrohet kurrëfare metodologjie, qoftë edhe në vija të trasha, se si do të vendoseshin çmimet tavan, gjë që le hapur rrugën për veprime të pamatura e arbitrare. Përderisa bëhet fjalë për kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike të regjistruerëve, me pasojë cënimin e konkurrencës së lirë në tregun e domeneve .al, vetë kjo metodologji duhej të ishte objekt i një ligji të Kuvendit.

g. Argumenti se çmime tavan të domeneve ka edhe Greqia, injoron faktin se kjo përbën në vetëvete rastin e vetëm ndër të gjitha ccTLD-te e vendeve me ekonomi tregu funksionale, dhe logjikshëm të çon te pyetja: pse shkohet pas një rasti anormal?

h. Analogjia që mund të bëhej, me kufizimet e çmimeve të energjisë elektrike do të ishte pa vend, sepse behet palë për natyra të ndryshme mallrash. Energjia elektrike është mall fizik/material, i kufizuar në sasi, jetik për njerëzit dhe me peshë në buxhetin e familjeve, veçanërisht të varfra. Politika rregullatore lidhur me të ka tani për tani një përmasë të theksuar sociale, ndonëse logjika e tregut edhe aty po përparon me shpejtësi. Domenet janë mall jofizik/jomaterial (intangibile), pa kufizime sasiore (kombinimet e shkronjave e numrave, apo të palëve janë praktikisht të pafundme) dhe për shumicën e njerëzve dhe bizneseve nuk përbejnë mall jetik. Në këto kushte, kufizimet e çmimeve në tregun e domeneve janë të pakuptimta, cënojnë konkurrencën e lirë dhe demtojnë këtë treg.

Për të gjitha këto arsye, nuk e shohim me vend vendosjen e çmimeve tavan, sepse kjo do ta cçnonte konkurrencën e lire dhe, në terma afatmesëm e afatgjatë, do të sillte dëm të madh në tregun e domeneve .al.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP falenderon qëndrimet e paraqitura dhe gjykon se çështja e vendosjes së një çmimi tavan për regjistrimin e një domain .al, mund të rinxirret për konsultim publik në një moment tjetër në mënyrë që fillimisht të shikohet efekti i ndryshimeve në Rregulloren nr. 2 si dhe për të pasur kohën e nevojshme për të formuluar, përshtatur dhe implementuar një metodologji të përcaktimit të çmimit të një domain .al, në mënyrë që të arësyetohet më tej nëse duhet të kemi një çmim tavan apo jo.

Çështje të tjera në konsultimin publik:

Duke pasur parasysh që:

- Regjistruerët janë subjekte të cilave AKEP ju ka dhënë të drejtën për veprime me domainet nën .al sipas kushteve dhe përcaktimeve në Rregulloren Nr. 2 të ndryshuar, prandaj Regjistruerët duhet të monitorohen nga AKEP gjatë veprimeve me domainet nën .al.
- Regjistruerët mund të kenë mosmarrveshje me aplikuesit apo me poseduesit e domain .al, në lidhje me emra domainesh, posedime, tranferime, çregjistrime, etj, AKEP gjykon se Regjistruerët duhet të monitorohen nga AKEP për të pasur informacion të saktë për këto lloj problematikash.

Sa më sipër, AKEP shtroi për konsultim publik:

Në pikën 3 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit” të Aneksit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, të shtohen si detyrime monitorimi në distancë dhe inspektimi i Regjistruesve, me kriteret e mëposhtme:

A. Monitorimi në distancë i Regjistruesve:

1. Çdo 3 muaj, duke filluar nga muaji Mars i çdo viti, Regjistruesit duhet të dorëzojnë në AKEP në formë elektronike ose të printuar, të gjithë formularët e veprimeve me domainet nën .al. Regjistruesit, çdo veprim me domainet nën .al do ta kryejnë nëpërmjet Formularëve përkatës të kësaj Rregulloreje. Regjistruesit do të ruajnë në formë elektronike ose të printuar, çdo formular të veprimeve me domainet nën .al, të nënshkruar nga kërkuesi i veprimit me domainin, ose të shoqëruar me dokumentacion që provon kërkuesin e veprimit me domainin.
2. Çdo 3 muaj, duke filluar nga muaji Mars i çdo viti, Regjistruesit duhet të dorëzojnë me shkrim në AKEP, një raport për problematikat e hasura me domainet nën .al, shoqëruar me dokumentacion nëse është i nevojshëm për sqarime.
3. AKEP do të ruajë në formë elektronike të gjithë formularët e sjellë nga Regjistruesit dhe brenda 15 ditëve do të kontrollojë emrat e domaineve të formularëve, me emrat e regjistruar në sistemin qendror nga secili Regjistrues. Në fund të procesit, AKEP njofton elektronikisht Regjistruesin për rezultatet e verifikimeve.
4. Në rast konstatimi problematikash, AKEP dhe Regjistruesi ndjekin procedurat e komunikimit zyrtar.
5. Në fund të afatit 15 ditor, AKEP përpilon një Raport me rezultatet e verifikimeve, të cilin e administron dhe qarkullon sipas rregullores së brendshme të AKEP.
6. Në fund të çdo viti, AKEP përpilon një Raport përmbledhës për veprimet me domainet, problematikat dhe zgjidhjet. Raporti do të përmbajë detyrimisht edhe numrin total të domaineve nën .al, numrin e domaineve të rinj të regjistruar çdo vit, numrin e domaineve të regjistruar nga secili Regjistrues çdo vit, numrin e veprimeve të tjera me domainet të specifikuar për çdo veprim, numrin total të domaineve të regjistruara nga vetë AKEP dhe numrin e domaineve të regjistruara nga vetë AKEP çdo vit, informacion në lidhje me respektimin e Rregullores nga Regjistruesit në veçanti zbatimin e afateve për veprimet me domainet dhe afateve të tjera të Rregullores. Ky Raport arshivohet në AKEP.
7. Ruatja e të dhënave personale të formularëve të veprimeve me domainet nën .al do të bëhet nga Regjistruesit dhe AKEP në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Qëndrim 1:

Ky paragraf është i panevojshëm, sepse në vetvete AKEP është oëner i procesit dhe kontrollues i tij. Pra, AKEP ka mundësitë dhe mekanizmat për ta ushtruar në çdo rast këtë lloj kontrolli. Veprimet operacionale të regjistruesit për dorëzimin e formularëve vetëm sa i shtojnë burokraci dhe punë administrative Regjistruesit por nuk i shërbejnë qëllimit të AKEP për monitorimin e tyre. Ndërkohë, lidhur me veprimet e brëndshme të institucionit të AKEP nuk ka nevojë të përshkruhen në Rregullore pasi AKEP ka mekanizmat e tij të garantuar nga kompetencat e caktuara nga Ligji për ushtrimin e kontrollit dhe verifikimeve.

Qëndrim 2:

1. Liberalizimi i tregut të regjistrimit të domain-eve .al në vitin 2008 u shoqërua me implementimin e një sistemi regjistrimi të domaineve nga AKEP, i cili sistem u mundësonte

Regjistruuesve të Akredituar të dërgonin online formularët e veprimeve me domainet. Për të shmangur të gjitha pasojat negative që mund të sjellë keqpërdorimi i rregjistrimit online, AKEP në rregulloren Nr. 2, në nenin 4 të saj ka përcaktuar parimet mbi të cilat bazohet dërgimi, marrja dhe saktësia e të dhënave të subjektit aplikues dhe përgjegjësitë e palëve në rast të deklarimeve jo të sakta. Ky nen, në mendimin tonë përfaqëson më së miri kushtet në të cilat zhvillohet biznesi i rregjistrimit të domain-eve sot pothuaj në të gjithë botën.

2. Në propozimin e paraqitur për ndryshimet në monitorimin e Regjistruuesve AKEP kërkon që Regjistruesit të paraqesin çdo 3 muaj formularët e veprimeve me domainet në formë elektronike ose të printuar, ndërkohe që në një nga pikat e këtij propozimi thuhet që AKEP do ti ruajë këto formularë vetëm në formë elektronike.

3. Sjellim në vëmendjen tuaj se të gjitha veprimet që kryhen me domain-et realizohen duke dërguar në AKEP (nëpërmjet API të sistemit të rregjistrimit të ccTLD .al) të dhënat e nevojshme sipas formularëve të veprimeve me domain-et. Në këtë kuptim, formularët në AKEP nga regjistruesit dërgohen në kohë reale dhe AKEP sipas procedurave aktuale bën verifikimin e tyre përpara se të miratojë veprimin me domain-in.

4. Pjesa më e madhe e veprimeve me domain-et ndodh online dhe aplikuesit mund të mos kenë edhe mundësi fizike për tu paraqitur pranë zyrave të Regjistruuesve ose Rishitëseve për të firmosur formularët.

5. Neni 4 i Rregullores Nr. 2, përcakton vetëdeklarimin si parimin bazë të mbledhjes së të dhënave. Ky parim bie ndesh me propozimin e paraqitur nga AKEP për mbledhjen nga Regjistruesit të dokumentacionit shtesë që provon kërkuesin e veprimit me domain-in.

6. AKEP propozon, që brenda 15 ditëve nga dorezimi i formulareve me veprimet e domaineve do të verifikojë ato dhe do të njoftojë Regjistruesit mbi rezultatet. Aktualisht janë 20,000 domain-e të regjistruara në zonën .al. Me një mestare të thjeshtë (çdo tre muaj AKEP duhet të verifikojë veprimet e 5000 domain-eve. Jashtë çdo paragykimi për aftësite përpunuese të AKEP, përveç se mendojmë që një proces i tillë nuk sjell ndonjë vlerë të shtuar, na duket edhe i pamundur sidomos nëse duhet të shoqerohet me dokumentacion shtesë apo formularë të firmosur.

7. Raportimi i problemeve në lidhje me domain-et është një (çështje që sikur edhe rregjistrimi i domaineve duhet të ndodhë në afatet më të vogla të mundshme, mundësisht në kohë reale, në mënyre që të garantohen sa më mirë të drejtat e konsumatorit. Në këtë kuptim, detyrimi për raporte 3 mujore nuk është në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron që Formularët e veprimeve me domainet .al, kanë qënë dhe janë pjesë e rregullores Nr. 2 dhe si të tillë duhet të plotësohen si gjatë veprimeve me një domain nga AKEP ashtu edhe gjatë veprimeve me një domain .al nga regjistruesit.

AKEP do të vazhdojë të mbikqyrë procesin e administrimit të formulareve, raporteve, problematikave, etj, në mënyre që ta bëjë procesin më të saktë, më të besueshëm dhe më transparent.

Qëndrim 3:

Lidhur me propozimet për monitorimin në distancë të Regjistruuesve, theksojmë se prej vitesh sistemi i rregjistrimit të domeneve .al është tërësisht automatik. Formularët përdoren vetëm nga AKEP-i si Regjistrues, ndërkohë që regjistruesit e tjerë, që janë operatore ekonomike private, operojnë nëpërmjet API dhe të gjitha veprimet e tyre janë automatike. Letra nuk përdoret, sepse nuk është e nevojshme. Sugjerimet e propozuara kërkojnë kthim disa vite

prapa - te formularët e shtypur. Kjo ndodh kur në të gjitha këto vite veprimtari, pas liberalizimit të tregut të domeneve .al në vitin 2008, nuk ka pasur asnjë ankesë apo problem në procesin e punës së regjistruësve me klientët, apo ndërmjet regjistruësve.

Me ndryshimet e propozuara, regjistruësve u imponohet një ngarkesë burokratike e paparashikuar, që kërkon punë e shpenzime shtesë për ta, dhe çka është më e rëndësishmja, është krejtësisht e panevojshme. Për çfarë vlejnë letrat e raportet që kërkohen? Nëse sistemi i komunikimit të Regjistrisë (AKEP) ruan normalisht logs elektronike të të gjitha veprimeve Regjistruës-Regjister apo Regjistruës-Regjister-Regjistruës do të thotë së Regjistri (AKEP) ka të gjithë bazën e nevojshme për monitorimin e çdo veprimi të regjistruësve. Në rast ankesash, Regjistri mund të kërkojë shpjegime për ndonjë gjë që s'ka ecur mirë te regjistruësit bazuar te logs elektronike të sistemit. Periudha e ruajtjes së këtyre logs mund të jetë aq sa ta gjykojë të arësyeshme Regjistri.

Propozimet për monitorimin e regjistruësve, lënë përshtypjen se raporti i AKEP me regjistruësit nuk kuptohet drejt. Regjistruësit nuk janë dhe as duhen parë si zgjatime të aparatit të AKEP, ose si zyrtarë në "bazë" të tij që duhet t'i raportojnë "qëndrës" çdo 3 muaj. Ata janë operatorë privatë, që investojnë e punojnë të lirë në punën e tyre për të dhënë në tregun e domeneve një shërbim, për kualitetin teknik të të cilit janë akredituar nga Regjistri .al. Nëse ata plotësojnë kërkesat e Rregullores me klientët, klientët nuk kanë ankesa dhe Regjistri ka logs elektronike të çdo veprimi teknik të tyre, përse kërkohet prej tyre të çojnë në Regjister (AKEP) vandake me letra apo të transferojnë atje me mijëra dokumente elektronike, kur praktikisht ato nuk është e mundur as të shihen, e jo më të studjohen nga Regjistri (AKEP)? Kjo është njësoj sikur të gjithë operatoreve të tjerë ekonomike në vendin tonë t'u kërkohej të dërgonin dokumentet e tyre me klientët dhe raporte periodike mbi punën e tyre, ministrive apo bashkive, vetëm e vetëm se ato u kanë dhënë atyre licencën si operatorë tregu në njërën apo në tjetrën fushe! Sistemin e mësipërm te centralizmit burokratik që e kemi lënë shumë vite më parë, nuk është mirë ta evokojmë, qoftë edhe pa dashur!

Qëndrimi i AKEP:

Sqarojmë që konfirmimi/veprimi teknik final për regjistrimin e një domaini bëhet nga AKEP edhe në rastin kur një domain regjistrohet nga regjistruësit. Formularët e veprimeve me domain .al kanë qenë dhe do të jenë pjesë e Rregullores Nr.2 dhe do të vazhdojnë të aplikohen nga AKEP dhe Regjistruësit, për të pasur informacion të plotë mbi poseduesin e domainit .al, për të garantuar që ai i njeh të drejtat, detyrimet dhe "pasojat" që përcakton Rregullorja Nr. 2. Theksimi i zbatimit të detyrimit për regjistrim domainesh .al me anën e formulareve, nuk është kthim pas, përkundrazi është edhe përmbushje e kërkesave të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Prandaj dhe AKEP në propozimet më sipër, në zbatim edhe të ligjit 9887 i ndryshuar, propozoi që Regjistruësit të jenë të Regjistruar në KMDPI, në mënyrë që të njohin dhe zbatojnë detyrimet këtij ligji edhe në rastin e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave personale për kërkuesit/poseduesit e domain .al.

Sa më sipër, AKEP pikën 3 "Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruësit" të Aneksit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, të shtohen si detyrime monitorimi në distancë, me kriteret e mëposhtme:

Monitorimi në distancë i Regjistruësve:

1. Çdo 6 muaj, Regjistruësit duhet të dorëzojnë me shkrim në AKEP:

- a) një raport për problematikat e hasura me domainet nën .al, shoqëruar me dokumentacion nëse është i nevojshëm për sqarime.
 - b) tarifat e aplikuara për regjistrimin/modifikimin/tranferimin, mbylljen, etj të domaineve .al, të cilat duhet të jenë të ndara nga tarifa të tjera që mund të aplikojnë regjistruesit.
2. Në fund të çdo viti, struktura përkatëse në AKEP përpilon një raport përmbledhës për veprimet me domainet. Raporti do të përmbajë detyrimisht edhe numrin total të domaineve nën .al, numrin e domaineve të rinj të regjistruar çdo vit, numrin e domaineve të regjistruar/modifikuar/tranferuar/mbyllur, etj nga secili Regjistrues, numrin e domaineve të regjistruara nga vetë AKEP çdo vit, informacion në lidhje me respektimin e Rregullores nga Regjistruesit në veçanti zbatimin e afateve për veprimet me domainet. Ky Raport i dërgohet Këshillit Drejtues dhe arshivohet në AKEP.
 3. Ruajtja e të dhënave personale të formularëve të veprimeve me domainet nën .al do të bëhet nga Regjistruesit dhe AKEP në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

B. Inspektimi i Regjistruesve:

1. Regjistruesit janë të detyruar të lejojnë AKEP për të kryer inspektim të tyre në lidhje me përmbushjen e kërkesave dhe përcaktimeve të kësaj Rregullore.
2. Regjistruesit duhet të jenë në dispozicion të AKEP:
 - a. çdo informacion të nevojshëm që ka të bëjë me funksionimin teknik të tyre si Regjistrues,
 - b. çdo informacion të nevojshëm për veprimet me domainet nën .al,
 - c. çdo informacion statistikor dhe historik për veprimet me domainet nën .al.

Moslejimi i AKEP për inspektim apo mospranimi i inspektimit nga Regjistruesit, përbën shkak për revokimin e regjistrimit në AKEP, sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.

Qëndrim 1:

Kompania jonë mbështet propozimin e AKEP për monitorimin dhe inspektimin e veprimtarisë së Regjistruesve dhe nuk ka ndonjë koment tjetër lidhur me këtë çështje.

Qëndrim 2:

AKEP duke qenë Autoriteti që akrediton Regjistruesit, e drejta e akreditimit mbart brënda saj edhe të drejtën e kontrollit apo inspektimit.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP gjykon se procesi i inspektimeve të Regjistruesve vjen si nevojë e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të regjistruesve ndaj Rregullores nr. 2 të AKEP, në ato raste kur është i nevojshëm inspektimi në vend i regjistruesve.

Sa më sipër, AKEP do të vendosë propozimin e mësipërm, në pikën 3 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit” të Aneksit 1 të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar.

C. Lidhur me kalimin e një domaini nën .al, nga një Regjistruer tek një Regjistruer tjetër:

AKEP shtroi për konsultim publik çështjen e kalimit të një domaini nën .al, nga një Regjistruer tek një Regjistruer tjetër, si e drejtë e çdo poseduesi domaini dhe si detyrim i çdo Regjistruerit të akredituar nga AKEP për t'ju përgjigjur një kërkesë të tillë nga poseduesi i domainit .al. Nga pikëpamja teknike kjo është plotësisht e realizueshme.

Sa më sipër, AKEP shtroi për konsultim:

1. Në nenin 29 të Rregullores Nr. 2 të shtohet pika 29.3 si më poshtë:

29.3: Poseduesi i domainit nën .al, ka të drejtë ta transferojë atë nga një Regjistruer tek një tjetër Regjistruer, pas verifikimit nga AKEP. Afati i transferimit do të jetë brenda 5 ditë pune ose në afat me të gjatë nëse kërkohet nga poseduesi i domainit. Si rregull transferimi i domainit nën “.al” do të bëhet pasi të jenë shlyer detyrimet financiare për domainin që transferohet.

Formulari i transferimit i dorëzohet nga poseduesi Regjistruerit marrës, i cili pasi plotëson pjesën e tij të formularit, e dërgon në formë elektronike në AKEP. AKEP kontrollon nëse formulari është plotësuar saktë dhe nëse po, i komunikon në formë elektronike Regjistruerit transferimin ndërsa Regjistruerit marrës njofton menjëherë poseduesin për kryerjen e transferimit. Përpara dërgimit të formularit të transferimit, një komunikim mes Regjistruerit marrës, Regjistruerit dhënës dhe kërkuesit, mund të jetë i nevojshëm të kryhet për të sqaruar nëse janë shlyer detyrimet financiare të mëparshme nga poseduesi i domainit.

Transferimi i domaineve .gov.al dhe .mil.al, lejohet nga AKEP vetëm në rastin e arësytimit nga të dy institucionet për transferim domaini .gov.al dhe nga strukturat përkatëse ushtarake për domainin .mil.al.

Në Aneksin 1, të shtohet pika 8.1 si më poshtë:

8.1 Transferimi i domainit nga një Regjistruer tek një Regjistruer tjetër.

Në rast se poseduesi i domainit nën .al dëshiron të transferojë domainin nga një Regjistruer tek një tjetër Regjistruer, Regjistruerit marrës duhet të plotësojë formularin përkatës të aplikimit së bashku me poseduesin e domainit. Veprimet kryhen sipas përcaktimeve të nenit 29.3 të Rregullores.

Në referencë me afatin e përcaktuar për veprimet e mësipërme, nevojitet edhe rregullimi i afateve të Nenit 31 të Rregullores, ku afatet nga 30 ditë të bëhen 5 ditë pune.

Qëndrim 1:

Kompania jonë shprehet e mendimit se përcaktimet nga AKEP në draft rregulloren e re se transferimi duhet të shoqërohet nga deklaratat përkatëse nga poseduesi i domainit dhe regjistri marrës, e kthen procesin në manual dhe humbje kohe. Aktualisht transferimi i domainit nga njëri regjistrar tek tjetri bëhet përmes kodit EPP të cilin mund ta aksesojnë qoftë regjistri ashtu edhe poseduesi i domainit përmes portalit të administrimit të domainit, pra është një proces transparent për poseduesin e domainit dhe nuk pengohet nga regjistri për

transferimin e domainit të tij (të paktën kjo është mënyra si ofrohet ky shërbim nga kompania jonë).

Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron që rregullimi i mësipërm i propozuar nga AKEP, plotëson pjesën administrative të procesit të transferimit të një domaini njëloj si në rastin e regjistrimit/modifikimit të një domaini .al. Transferimi i një domaini .al (apo nëndomaini) nga një regjistrues tek një regjistrues tjetër nëpërmjet një procesi të zyrtarizuar, siç propozohet nga AKEP, është një garanci më tepër për poseduesin e domainit që do të transferohet, si dhe ndihmon palët të mos kenë mosmarveshje mes tyre ose të mund ti minimizojnë ato, në rast transferimesh domainesh .al nga një Regjistrues tek një tjetër Regjistrues.

Qëndrim 2:

Kompania jonë mbështet në parim transferimin e një domaini nga një Regjistrues tek një Regjistrues tjetër, dhe sugjeron që AKEP të hartojë në mënyrë me të detajuar në këtë nën procedural lidhur me garancinë që duhet të japi një Regjistrues për mosruajtjen e të dhënave konfidenciale të aplikuesve të domaineve gjatë transferimit të një domaini nga një Regjistrues tek një Regjistrues tjetër.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron që administrimi i të dhënave personale, jo vetëm në rast transferimi domaini nga një regjistrues tek një tjetër regjistrues, por edhe në çdo rast tjetër regjistrimi domaini .al, modifikimi, etj, bëhet në përputhje me percaktimet e Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Qëndrim 3:

1. Me ngritjen e sistemit të regjistrimit dhe administrimit të domain-eve .al pjesa dërrmuese e transferimeve të domaineve nga një Regjistrues tek një Regjistrues tjetër kryhet duke përdorur mekanizma bashkëkohor siç është përdorimi i kodit EPP. Natyrisht që kontrolli për shlyerjen e detyrimeve financiare është një gjë pozitive, por përdorimi i këtyre metodave moderne mundëson që për shumicën e rasteve ky kontroll të jetë formal ose jo i domosdoshëm. Në këto raste afati i propozuar prej 5 ditësh për transferimin e domain-it është shumë i gjatë.

Qëndrim 4:

Duke vlerësuar shqetësimin e AKEP për të ndaluar transferimet në rast të mosshlyerjes të detyrimeve financiare nga zotëruesi i domain-it, vlerësojmë se në këtë propozim duhet të bëhet dallimi midis transferimit manual (me formularë të printuar) dhe transferimit automatik (nëpërmjet kodit EPP). Afatet e propozuara nga AKEP për transferimin e domain-eve nga një Regjistrar tek një tjetër mendojmë që nuk janë në përputhje me kërkesat e tregut dhe mundësitë teknike që ofron infrastruktura teknologjike e AKEP dhe Regjistruesve nëq aplikohet transferimi nëpërmjet kodit EPP.

Qëndrimi i AKEP për 4 dhe 5:

AKEP vlerëson këto qëndrime dhe gjykon se fillimisht duhet një fare kohe për të provuar që ky ndryshim në rregullore do të funksionojë siç duhet, dhe më tej të shkurtohet si afat ose të kalohet në përdorimin e kodeve të aplikueshme.

Sa më sipër, në nenin 29 të Rregullores Nr. 2, shtohet pika 29.3 si më poshtë:

29.3: Poseduesi i domainit nën .al, ka të drejtë ta transferojë atë nga një Regjistruer tek një tjetër Regjistruer, pas verifikimit nga AKEP. Afati i transferimit do të jetë brenda 5 ditë pune ose në afat më të gjatë nëse kërkohet nga poseduesi i domainit. Si rregull transferimi i domainit nën “.al” do të bëhet pasi të jenë shlyer detyrimet financiare për domainin që transferohet.

Formulari i transferimit i dorëzohet nga poseduesi Regjistruerit marrës, i cili pasi plotëson pjesën e tij të formularit, e dërgon në formë elektronike në AKEP. AKEP kontrollon nëse formulari është plotësuar saktë dhe nëse po, i komunikon në formë elektronike Regjistruerit transferimin ndërsa Regjistrueri marrës njofton menjëherë poseduesin për kryerjen e transferimit. Përpara dërgimit të formularit të transferimit, një komunikim mes Regjistruerit marrës, Regjistruerit dhënës dhe kërkuesit, mund të jetë i nevojshëm të kryhet për të sqaruar nëse janë shlyer detyrimet financiare të mëparshme nga poseduesi i domainit.

